



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Përputhshmërie)

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE KORÇË

Tiranë, janar 2022

Nr.	Përmbajtje	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4-16
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....</i>	<i>4</i>
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....</i>	<i>4-13</i>
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....</i>	<i>13-16</i>
II.	HYRJA.....	17-21
1.	<i>Objekti i auditimit.....</i>	<i>17</i>
2.	<i>Qëllimi i auditimit.....</i>	<i>17</i>
3.	<i>Identifikimi i çështjes.....</i>	<i>17-18</i>
4.	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	<i>18</i>
5.	<i>Përgjegjësitë e audituesve.....</i>	<i>18</i>
6.	<i>Kriteret e vlerësimit.....</i>	<i>18-19</i>
7.	<i>Standardet e auditimit.....</i>	<i>19</i>
8.	<i>Metodat e auditimit.....</i>	<i>20</i>
9.	<i>Dokumentimi i auditimit.....</i>	<i>21</i>
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	21-196
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	21
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit	22-196
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2020 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar.....	22-26
2.2	Vlerësimi i përmbushjes së misionit për realizimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore për periudhën 01.01.2019 deri në 30.09.2021 në përputhje me ligjet vjetore të buxhetit dhe akteve normative në ndryshim të tyre. Ecuria sipas zërave kryesore të të ardhurave dhe grup-tatimpaguesve sipas sektorëve të industrisë.....	26-32
2.3	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.....	32-150
2.4	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.....	150-160
2.5	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.....	161-165
2.6	Auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.....	166-196
2.6.1	Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në kryerjen e shpenzimeve korente: pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për udhëtime e dieta, si dhe shpenzime të tjera personeli, etj.....	166-191
2.6.2	Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë për realizimin e procedurave të prokurimit, përfshirë: planifikimin e nevojave, prokurimin, marrja në dorëzim dhe zbatimin e kontratave për punime mallra.shërbime nga subjekti në auditim, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9463 datë 20.11.2016 òPër Prokurimin Publiko dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publiko, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.	191-196

2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme dhe probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....	196-207
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	207-220

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. 1. Përshkrim i Shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154.2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 947/1 prot., datë 14.09.2021 i ndryshuar me nr. 947/2 prot., datë 09.11.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.09.2021 deri më datë 19.11.2021, është kryer auditimi në subjektin Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë për periudhën nga 01.01.2019 ó 30.09.2021, me objekt: Auditim Përputhshmërie.

Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Korçë është institucion publik, buxhetor, në varësi të drejtëpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Misioni i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve është mbledhja e detyrimeve tatimore, ofrimi i shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrolli i deklaratave dhe pagesave, kontrolli i tatimpaguesve si dhe mbledhja e borxhit tatimor.

Objektivat e përgjithshme të DRT-së:

- Të sigurojnë ndërmarrjen e të gjithë veprimeve në aktivitetin e tyre të cilat cojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore qëndrore;
- Të mbledhin të ardhurat tatimore në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi me koston më të ulët të mundshme, nëpërmjet nxitjes dhe vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore;
- Të bashkëpunojnë me drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e planit operacional në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Të përcaktojnë plane operationale vjetore me shkrim për çdo funksion;
- Të bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për trajnimin e punonjësve;
- Të hartojnë dhe zbatojnë programe në mënyrë që përgjegjësit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre;
- Të ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
1	Janë evaduar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në total 37 praktika rimbursimi të TVSH-së nëpërmjet procedurës së kontrollit nga zyra jo në përputhje me afatet që përcaktohen sipas legjislacionit tatimor. Njoftimet e kontrollit të shoqëruar me Programet e kontrollit për Rimbursimin e TVSH-së nga Kontrolli nga Zyra që ju dërgohen tatimpaguesve nuk u përmbahen kërkesave ligjore sipas nenit 81, pika 2, germa òfë e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar duke mos	32-150	E lartë	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa për të unifikuar praktikën e rimbursimit të TVSH-së nga sektori i monitorimit nga zyra.

	<p>përcaktuar datën, orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të kontrollit nga të dhënat e analizës së riskut.</p> <p>Gjithashtu, rezulton se nga ana e përgjegjësit të sektorit të procedurave të kontrollit dhe monitorimit kemi veprime të cilat nuk respektojmë afateve të rimbursimit të TVSH sipas nenit 75/1 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, duke i hequr në këtë mënyrë tatimpaguesit të drejtën e kundërshtimit të rezultateve të kontrollit brenda 5 ditëve kalendarike.</p>			
2	<p>Realizimi i të ardhurave për vitin 2019 rezulton me një diferencë prej 4%, e cila përfaqëson shumën 221,087 mijë lekë dhe për vitin 2020 mosrealizimi prej 3.6%, në vlerën 194,180 mijë lekë, fakt i cili tregon për performancën e dobët të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçw në përmbushje të misionit të stafit drejtues dhe nëpunësve zyrtarë të kësaj Drejtorie.</p> <p>Në periudhën 01.01.2021 deri më datë 30.08.2021 konstatohet një realizim i të ardhurave tatimore në nivelin prej 102%, por me një rezultat të të ardhurave neto të arkëtuara më të vogël se ai i realizuar në vitin 2019 dhe 2020, si pasojë e rishikimit të planit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.</p>	34-42	E lartë	<p>Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të përmirësojë metodologjinë e punës të strukturave në tërësi dhe në veçanti të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, e cila kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në monitorimin dhe kontrollin e të ardhurave tatimore, bazuar në profilet e riskut, të monitorimit dhe të kontrollit për llojet e tatimeve dhe kategoritë e subjekteve tatimpagues që kryejnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të kësaj Drejtorie.</p>
3	<p>Nëpunësit e njësisë përgjegjëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk kanë respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin e fushës në lidhje me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ të njoftim kontrollit, në lidhje me afatet e evadimit të aktit administrative, të raportit paraprak të kontrollit, të raportit përfundimtar të kontrollit si dhe të njoftim vlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 <i>“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i> duke krijuar risk të lartë për të mbartur në vijim efekte administrative me pasoja në pavlefshmërinë ligjore të akteve të nxjerra nga kjo njësi.</p>	32-150	E lartë	<p>Drejtuesit e njësisë përgjegjëse dhe nëpunësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë gjatë procedurave administrative të nxjerrjes dhe evadimit të akteve administrative, të respektojnë afatet ligjore të nxjerrjes së akteve me qëllim eliminimin e riskut në mosvlefshmërinë ligjore të akteve administrative të nxjerra nga kjo njësi përgjegjëse.</p>
4	<p>DRT Korçë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit në qarkullimin sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruar në deklaratat e TTH-së, TVSH-së në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore.</p> <p>Rezultojnë 295 subjekte të vegjël për vitin 2019 me qarkullim sipas kasës me vlerë</p>	32-150	E lartë	<p>Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për verifikimin e mospërputhjeve midis deklaratës së qarkullimit sipas kasës dhe deklaratës së të ardhurave sipas TTHF.</p>

	68,662,195 lekë tepër sesa të ardhurat e deklaruar në TTHF dhe 430 subjekte për vitin 2020 me vlerë 85,310,226 lekë më të lartë sesa të ardhurat e deklaruar në TTHF, gjithsej parregullsi në të ardhurat e deklaruar për vitin 2019-2020 për 725 subjekte në vlerën 153,972,421 lekë.			
5	Nga auditimi u konstatua se nga drejtuesit e njësisë përgjegjëse të Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë janë kryer veprimet procedurale për njoftime pagese detyrimesh tatimore, urdhër bllokim llogarie bankare, njoftime masë sigurie për barrë hipotekore dhe barrë siguroese, urdhër sekuestrim pasurie dhe urdhër bllokim në doganë konform legjislacionit tatimor në fuqi si dhe nëpërmjet një personi juridik publik, i cili përfiton komision mbi shumën e mbledhur ndonëse në fund të vitit 2019 ka pasur 7695 raste debitorë në shumën 2,364,166 mijë lekë, dhe në fund të periudhës 31.07.2021 (<i>periudhë në të cilën mbledhja e borxhit tatimor ka kaluar në Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit në DPT</i>) ka pasur 8,122 raste në shumën 2,489,601 mijë lekë për të cilët ka kaluar më shumë se një vit nga lindja e pagesës së detyrimeve tatimore.	32-150	E lartë	Drejtorja Rajonale Tatimore Korçë gjatë procedurave administrative të ndjekjes së arkëtimit të borxhit tatimor të bashkëpunojë dhe të marrin në konsideratë kryerjen e të gjitha veprimeve administrative në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit tatimor për maksimizimin e veprimeve procedurale, me qëllim mbledhjen e të ardhurave tatimore nga borxhi i paarkëtuar, si dhe uljen e numrit të subjekteve tatimpagues debitorë.
6	Nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës si në vijim: - Ky Sektor nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme, duke mos vepruar në përputhje me kërkesat Manualit të Kontrollit nga Zyra pika 5, 8 dhe 9; - Në lidhje me ndarjen e NIPT-eve, në organizimin dhe monitorimin e Inspektorëve nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, pika 5, 8 dhe 9 - Konstatohen tepricat të larta kreditore të TVSH-s, TF dhe TTHF, pasi rezultojnë 50 subjekte me tepricë kreditore të pandryshuara ose në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim, të cilat rrisin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këta subjekte mbajnë peshën dhe teprica kreditore e tyre ka pasur tendencë rritëse nga viti 2019 në vitin 2021, si dhe nga ana e Inspektorit përkatës nuk është	32-150	E lartë	Drejtori rajonal të analizoje situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi të marrë masa për vlerësimin e problematikave të tepricave të larta të TVSH-së, TF dhe TTHF; të vlerësimin subjekteve të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit dhe biznese me TFTH me humbje tatimore mbi 500,000 lekë, si dhe monitorimin efektiv të xhiros së subjekteve me qëllim ndërrimin e përgjegjësisë së tatimpaguesve kur kalohen kufijtë e parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

	<p>kërkuar informacion apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Duke qenë se ky numër subjektsh (në raport me totalin e tatimpaguesve të DRT Korçë) ka 47% të tepicës kreditore të TVSH-së në shkallë rajoni nuk kanë qenë objekt monitorimi dhe verifikimi në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, <i>pika 5, pika 9.</i></p> <p>-Konstatohen subjekte të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit dhe biznese me Tatim të Thjeshtuar me Humbje Tatimore më të madhe se 500,000 lekë, disa prej të cilëve janë dhe me humbje në 3 vite me radhë, si dhe ka rezultuar se disa prej tyre janë dhe debitorë. Humbja tatimore për top 50 subjekte e vitit 2018 dhe për vitin 2020 është në vlerën gjithsej 341,989,787 lekë. Nga top 50 subjektet që rezultojnë me humbje, 12 prej tyre janë dhe debitorë kundrejt DRT Korçë në vlerën 32,718,023 lekë. Nga administrata tatimore Korçë nuk janë marr masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to.</p> <p>Nga Biznesi i vogël, janë konstatuar gjithsej 98 Biznese me Humbje Tatimore mbi vlerën 500,000 lekë, në vlerën gjithsej 250.129.032 lekë. Për asnjë biznes të madh nuk konstatohet që nga ana e DRT Korçë të jenë shpallur procedurat e falimentimit sipas përcaktimeve ligjore në nenin 16 <i>oKërkesat e kreditorit</i>, ligji nr.110/2016 datë 27.10.2016 <i>oPër falimentimin</i>.</p> <p>- Konstatohen subjekte që kanë ndryshuar me vonesë përgjegjësinë tatimore për të kaluar në Biznes i Madh, si rezultat i një monitorimi jo efektiv i deklaratave mujore të qarkullimit sipas TVSH-së,. Kjo evidentohet nga kryqëzimi i të dhënave të qarkullimit sipas deklaratave mujore të TVSH-së, me datat e ndërrimit të përgjegjësisë dhe gjithashtu me deklarimin vjetor të të ardhurave në deklaratën e TTHF dhe TF.</p>			
7	<p>Nga auditimi u konstatua se gjatë zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë oK.Gö SHPK dhe oM.Bö SHPK në periudha të ndryshme kohore janë kryer kreditime nga llogaria e ortakut për llogari të këtyre shoqërive me qëllim rritjen e aktivitetit tregtar. Këto pagesa konfirmohen në raportet e kontrollit tatimor si pagesa të kryera nëpërmjet</p>	32-150	E lartë	<p>Drejtorja Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin veprime administrative me qëllim përcaktimin e një metodologjie të llogaritjes së detyrimeve totale tatimore të trajtuara sa më sipër për subjektet oK.Gö shpk dhe oM.Bö</p>

<p>sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Gjatë auditimit u konstatua se për këto hua ose shuma në vlera monetare të dhëna nga llogaria e ortakut në favor të shoqërive ðK.Gö SHPK dhe ðM.Bö SHPK nuk rezultonin llogaritje të interesave vjetore në pasqyrat e performancës së këtyre shoqërive, duke sjellë pasojë efekte tatimore të rillogaritura si rikarakterizim të ardhurash dhe me detyrime tatimore në shumën 3,221,952 lekë për TVSH dhe 3,221,952 lekë gjobë 100% TVSH për periudhën 2014-2017, si dhe në shumën 2,416,464 lekë për tatim fitimin dhe 2,416,464 lekë gjobë 100% tatim fitimi për periudhën 2014 deri 2017 për subjektin ðK.Gö SHPK. Për subjektin ðM.B rezultuan detyrime tatimore nga rikarakterizimi në shumën 715,000 lekë për TVSH dhe 715,000 lekë gjobë 100% TVSH për periudhën 2014-2017, si dhe shumën 536,250 lekë për tatim fitimin dhe 536,250 lekë gjobë 100% tatim fitimi për periudhën 2014-2017. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë me anë të observacioneve ka kundërshtuar rillogaritjen e detyrimeve tatimore për këto raste si një praktikë dhe metodologji që nuk trajtohej nga legjislacioni tatimor i fushës dhe në praktikën e përditshme të raport kontrolleve tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 <i>ðPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare</i>ö. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si ðPalë të lidhuraö, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në ligjin nr. 42/2014 <i>ðPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”</i>, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.16, datë 18.6.2014 <i>ðPër transferimin e çmimitö</i>, gjë që sjell se, çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t�u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (�Arm� Length�). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë, referuar Kodit Civil i miratuar me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, neni</p>		<p>shpk. Gjithashtu Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të përcaktojnë një metodologji të qartë dhe të saktë ligjore dhe një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontrolleve tatimore, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë ku ata janë ortakë për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga kundërshtitë ligjore që parashikon kodi i procedurave civile.</p>
--	--	--

	1050 <i>ËPër Huanë</i> cilësohet se huamarrësi duhet të paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.			
8	Nga auditimi i sektorit të kontrollit nga zyra për vitet 2019 e 2020, si dhe analizimi i të dhënave të sektorit të informatikës mbi mospërputhjet në deklarin të situatës financiare me të ardhurat në pasqyrat financiare u konstatua se, ka tatimpagues (aktiv, që kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe pasiv) të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019, nuk kanë kryer pagesën e këtij tatim fitimi në vlerën gjithsej <i>11,465,102 lekë (detyrim principali 8,180,176 lekë, interesa 3,072,540 lekë dhe gjoba 212,386 lekë)</i> . Gjithashtu ka tatimpagues (aktiv, që kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe pasiv) të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019, por nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi fitimi që kap vlerën <i>23,009,998 lekë (detyrim principali 18,772,356 lekë, interesa 3,882,100 lekë dhe gjoba 355,542 lekë) duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total në vlerën 34,475,100 lekë</i> . Ky detyrim duhet të ishte arkëtuar për TF e vitit 2019 brenda datës 31.03.2020 dhe për TF e 2020 brenda datës 31.03.2021.	32-150	E lartë	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi, duke nxjerrë përgjegjësitë në çdo rast sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të marrë masa të menjëhershme, duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit në vlerën <i>34,475,100 lekë</i> për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi në afatet e përcaktuara.
9	Nga auditimi janë konstatuar 12 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit për vitin 2019 në vlerën - <i>775,795 lekë</i> . Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë. Nga auditimi janë konstatuar 4 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit për vitin 2020 në vlerën - <i>1,131,649 lekë</i> . Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë. <i>Këto diferenca sjellin një vlerë të munguar të të ardhurave në zërin Tatim Fitimi në total prej 2,423,258 lekë. (Të ardhura të munguara nga TVSH: 692,359 lekë + Gjorbë në masën 100% 692,359 lekë & Të ardhura të munguara nga TF 519,270 lekë + Gjorbë në masën 100% 519,270 lekë).</i>	32-150	E lartë	DRT Korçë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH <i>në shumën 2,423,258 lekë</i> duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse sipas anekseve dhe tabelave përkatëse pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të bëjë propozimet përkatëse sektorit të kontrollit operacional në DRT për kryerjen e kontrollit të thelluar në vend për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.
10	Nga auditimi i raport kontrolleve të plota dhe rimbursimit të TVSH-së, u konstatuan	32-150	E lartë	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë të gjitha veprimet e

<p>parregullësi në veprimet e inspektorëve të kontrollit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Është identifikuar një rast ku nuk është aplikuar <i>δ</i>Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së për subjektet me aktivitet të përzier veprim në kundërshtim me nenin 72 pika 2 të ligjit nr. 92/2014 <i>δ</i>Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë; nenin 56 pika 3 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 <i>δ</i>Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë me efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 456,019 lekë; - Janë konstatuar 3 raste të cilat kanë pasur gabim në llogaritjen e kostos së mallrave të shitur veprime këto në kundërshtim me nenin 115 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 <i>δ</i>Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë sjellë një efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 386,394 lekë; - Në një rast është konstatuar kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për ndërtim hidrocentrali sepse punimet janë zhvilluar në tejkalim të afatit të lejes kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit Nr.6 <i>δ</i>Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me efekte financiare në arkëtimin e të ardhurave në shumën 42,150,598 lekë; - Në 11 raste janë konstatuar mos kryerja e veprimeve të duhura në lidhje me njohjen e shpenzimeve të amortizimit në pasqyrën e performancës veprime në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 <i>δ</i>Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, me efekt financiar mungesën e të ardhurave buxhetore në total prej 115,135,079 lekë; - Në një rast është konstatuar shitje nën kosto të produkteve, veprime në kundërshtim me nenin 115, pika 1 të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008 <i>δ</i>Për procedurat tatimore; - Në një rast ka dyshime të arsyeshme për evazion fiskal sipas përcaktimeve të nenit 116 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 <i>δ</i>Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me efekte financiare në mungesën e të ardhurave në vlerën 16,158,369 lekë; - Nga auditimi u konstatua në një rast diferencë midis njoftim vlerësimit të gjeneruar nga sistemi c@ts dhe detyrimeve sipas raport kontrollit duke shkaktuar të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit në total në shumën 139,458 lekë. 		<p>duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogarituaara për subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve tatimore sipas aneksit 5.1 në shumën 174,316,112 lekë.</p>
--	--	---

11	<p>Nga auditimi u konstatua se nga analiza e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor në bazë të programit nr. 17344/4 prot., datë 19.02.2020 duke nxjerrë peshën dhe sasinë e <i>ogranulatit</i> që është futur në proces prodhimi për të prodhuar produktin <i>o</i>Ambalazhë të llojeve të ndryshme nga subjekti <i>o</i>P.P. SHPK me NIPT nuk është kryer pagesa e plotë për sasinë e mallit të prodhuar ambalazh plastik në sasinë prej 12 031 kg për detyrimin tatimor gjithsej prej 2,406,200 lekë penalitet bazuar dhe në nenin 5 <i>o</i>Agjentët e taksave të ligjit nr. 178/2013 <i>o</i>Për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare. Gjithashtu konstatohet se për një periudhë kohore 5 mujore (qershor-tetor) të vitit 2017, aktiviteti subjekti <i>o</i>P.P” SHPK sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka prodhuar një sasi prej 12 031 kg ambalazh plastik fakt i cili nuk është kontestuar në asnjë rast nga Drejtoria Tatimore Korçë, ndërsa për një periudhë kohore prej 12 mujore (janar-dhjetor) të vitit 2017, aktiviteti i këtij subjekti ka prodhuar dhe shitur një sasi prej 13,265 kg ambalazh plastik, fakt i vënë në dispozicion gjatë fazës audituese të Projekt-Raportit të Auditimit. Nuk rezulton një analizë e plotë e bilancit material për sasinë e prodhuara dhe të shitura për vitin ushtrimor 2017 për aktivitetin e subjektit <i>o</i>P.P. SHPK mbështetur në treguesit e importit, eksportit, kartës teknologjike, firove, humbjeve me qëllim dokumentimin e provës se vërtetësisë se pagesës plotë të taksës TAM për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, nisur edhe nga analiza korrekte e kryer nga grupi auditues për një periudhë të pjesshme kohore prej 40% periudhës së aktivitetit të këtij subjekti tatimpagues.</p>	32-150	E lartë	<p>Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të marrë në shqyrtim të plotë mos pagesat e Taksës Kombëtare TAM dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të kërkoje kontroll të thelluar tatimor për deklarimet e kryera nga subjekti <i>o</i> SHPK në lidhje me sasinë e prodhuar te ambalazhit plastik dhe pagesën e kryer dhe të papaguar në shumën 2,406,200 lekë për taksën kombëtare të ambalazhit TAM për vitin 2017 që <i>o</i>përbën të ardhur të munguar në Buxhetin e Shtetit dhe në vijim për detyrime tatimore që do të rezultojnë bazuar në legjislacionin tatimor sipas nenit nr. 85 “Ri kontrolli Tatimor sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 <i>o</i>Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Në përfundim të kontrollit të kryer të vihet në dijeni Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me rezultatet e arritura nga administrata tatimore në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues <i>o</i>P.P. SHPK me nipt për mospagesat e taksës së ambalazhit plastik për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2022.</p>
----	---	--------	---------	--

3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet:

a) verifikimit të përgjegjësive financiare të subjektit nën auditim, i cili përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare, si dhe shprehjen e mendimeve për to;
c) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
ç) auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik;

d) auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, dhe

e) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Opinion i kualifikuar¹:

Për mendimin tonë, ne kemi marrë siguri të arsyeshme, se në veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjektit të audituar për periudhën 01.01.2019 ó 31.08.2021, rezultojnë raste të mospërputhshmërisë me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative në fuqi, pasi gabimet dhe shkeljet e evidentuara janë materiale por jo të përhapura në të gjitha drejtimet e auditimit, duke shërbyer kështu si bazë për dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899).

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënien e këtij opinionit.

Opinionit i auditimit mbështetet me prova që justifikojnë përfundimet e arritura, si dhe me siguri të arsyeshme shprehemi që opinionit dhe gjetjet janë shprehur saktë në raport dhe pa lënë vend për keqkuptime.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, ka rezultuar se, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit që burojnë nga kuadri legjislativ dhe rregullativ në fuqi lidhur me aktivitetin e subjektit nën auditim. Si rezultat i veprimeve të kryera në kundërshtim ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare i ndryshuar; ligjin nr. 92/2014 datë 24.7.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; UMF nr. 24 datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pasi janë konstatuar efekte negative në grumbullimin e të ardhurave buxhetore, duke shkaktuar mungesën e evidentimit dhe të kërkimit për arkëtim të shumës prej 224,300,798 lekë, nga të cilat shuma prej 180,159,608 lekë nga auditimi i dosjeve të kontrollit dhe rimbursimit të sektorit të kontrollit në vend, shuma prej 44,141,190 lekë nga auditimi i veprimtarisë së sektorit të kontrollit nga zyra.

¹ Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuar, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura. ISSAI-IFPP 400 òAssurance in compliance auditing, Paragrafi 40-41;

¹ ISSAI-IFPP 400, Paragrafi 57 òAudit evidence & Paragrafi 58 òEvaluating audit evidence and forming conclusions.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara janë mospërputhje materiale por jo të përhapura, duke bërë që me siguri të arsyeshme të jepet opinion i kualifikuar, sipas shpjegimeve të detajuara në vijim:

- Në një rast është konstatuar kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për punime rikonstruksioni, pasi punimet janë zhvilluar në shkelje të lejes ku situacioni i punimeve është në vlerë më i madh se preventivi dhe ku janë shtuar zëra punimesh shtesë nga ato të parashikuara, veprime këto në kundërshtim me kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit nr. 6 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me efekte financiare dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 3,322,940 lekë;

- Në 11 raste janë konstatuar mos kryerja e veprimeve të duhura në lidhje me njohjen e shpenzimeve të amortizimit në pasqyrën e performancës veprime në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, me efekt financiar mungesën e të ardhurave buxhetore në total prej 115,135,079 lekë;

- Në një rast është konstatuar kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për ndërtim hidrocentrali sepse punimet janë zhvilluar në tejkalim të afatit të lejes kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit Nr.6 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me efekte financiare në arkëtimin e të ardhurave në shumën 42,150,598 lekë;

- Nga auditimi i sektorit të kontrollit nga zyra për vitet 2019 - 2020 dhe analizimi i të dhënave të sektorit të informatikës mbi mospërputhjet në deklarim të situatës financiare me të ardhurat në pasqyrat financiare u konstatua se ka tatimpagues (aktiv që kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe pasiv) të cilët kanë kryer deklarimin e tatimit mbi fitimin në 2019, por nuk kanë kryer pagesën e këtij tatim fitimi në vlerën gjithsej 11,465,102 lekë, duke krijuar deficit në të ardhurat buxhetore, si dhe subjekte me detyrime debitoare. E njëjta gjë ka ndodhur dhe në vitin 2020, duke shkaktuar të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit në total në vlerën 34,475,100 lekë, i cili duhej të ishte arkëtuar në periudhat pasardhëse;

- Në një rast ka dyshime të arsyeshme për evazion fiskal sipas përcaktimeve të nenit 116 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me efekte financiare në mungesën e të ardhurave në vlerën 16,158,369 lekë;

- Nga auditimi u konstatua se, DRT Korçë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e tij nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit në qarkullimin sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruar në deklaratat e TTH-s, TVSH-s në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-së ku u konstatuan: 23 subjekte për vitin 2019 me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 4,119,295 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 1,373,098 lekë. Për vitin 2020 u konstatuan 31 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 6,708,718 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 2,236,240 lekë;

b) Për biznesin e madh u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-së, ku u konstatuan për vitin 2019, 11 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 1,686,164 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 562,054 lekë. Për vitin 2020 u konstatuan 18 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 9,214,747 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 3,071,440 lekë;

- Nga auditimi janë konstatuar 12 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë

për mallrat e importit për vitin 2019 në vlerën 775,795 lekë. Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë, si dhe 4 raste të tilla për vitin 2020 në vlerën - 1,131,649 lekë. Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë, të cilat sjellin diferenca në vlerë të munguar të ardhurave në zërin Tatim Fitimi në total në vlerën prej 2,423,258 lekë.

- Është konstatuar një subjekt i cili ka në aktivitetin e tij ÷Prodhimin e materialeve dhe objekteve plastike të çdo lloji, por që nuk ka kryer pagesën e taksës së ambalazhit, veprime në kundërshtim me neni 2 të ligjit nr.178/2013 ÷Për disa shtesa në ligjin nr.9975 datë 28.07.2008 ÷Për taksat kombëtare të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr.2 datë 17.01.2014, me efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 2,406,200 lekë;

- Nga auditimi i raport kontrolleve të plota dhe rimbursimit të TVSH-së, është identifikuar një rast ku nuk është aplikuar ÷Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së për subjektet me aktivitet të përzier, veprim në kundërshtim me nenin 72 pika 2 të ligjit nr. 92/2014 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar; nenin 56 pika 3 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë me efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 456,019 lekë;

- Janë konstatuar 3 raste të cilat kanë pasur gabim në llogaritjen e kostos së mallrave të shitur veprime këto në kundërshtim me nenin 115 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë sjellë një efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 386,394 lekë;

- Në një rast është konstatuar shitje nën kosto të produkteve, veprime në kundërshtim me nenin 115, pika 1 të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008 ÷Për procedurat tatimore;

- Nga auditimi u konstatua në një rast diferencë midis njoftim vlerësimit të gjeneruar nga sistemi c@ts dhe detyrimeve sipas raport kontrollit duke shkaktuar të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit në total në shumën 139,458 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë:

Është detyrimi i strukturave drejtuese në DRT Korçë, që në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, si dhe Rregullores së Brendshme, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.

Strukturat drejtuese të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe

për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se Projektraporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionet e auditimit janë të përshtatshme.

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154.2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSH, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 947.1 prot., datë 14.09.2021 i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.09.2021 deri më datë 19.11.2021, është kryer auditimi në subjektin Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë për periudhën nga 01.01.2019 ó 31.08.2021, me objekt: Auditim Përputhshmërie nga Grupi i Audituesve Shtetërore.

1. Objekti i auditimit: Auditim përputhshmërie në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.

2. Qëllimi i auditimit: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evIdencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse aktiviteti izhvilluar për periudhën objekt auditimi përputhet me kriteret përkatëse të kuadrin ligjor, nënligjor e rregullator të fushës.

Objektivi i Auditimit është arritja e një konkluzioni nëse aktiviteti i zhvilluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatore përkatëse. Në funksion të përmbushjes së misionit.angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

Dhënia e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve të komponentëve të mëposhtëm:

-Evidentimi i shmangieve të veprimtarisë së DRT Korçë me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit;

-Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPT;

-Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash dhe ato të evazionit tatimor;

-Vlerësimi i përmbushjes së misionit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë për realizimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore;

-Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.

-Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.

-Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

-Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar. Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

-Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;

- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;

-Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe.ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2019 deri më 30.09.2021, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni sipas ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DRT Korçë të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore për Qarkun Korçë, masat e marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore, ecurinë e vetëdeklarimit të tatimpagueseve, saktësinë e këtyre deklaratave, monitorimin e mosdeklaruesve në të gjitha llojet e tatimeve, prokurimet, përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit, Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve dhe Drejtorisë së Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit etj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Është detyrimi i strukturave drejtuese në DRT Korçë, që në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar si dhe Rregullores së Brendshme, miratuar sipas Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 19, datë 22.02.2017.

Drejtori Rajonal përfaqëson Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe vepron si pikë e parë e kontaktit midis DPT dhe DRT. Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe zbatimin e detyrave të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtori i Kontrollit mban përgjegjësi në menaxhimin e sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në zbatimin e planeve mujore dhe vjetorë të D.Kontrollit, dhe merr raporte lidhur me zbatimin e tyre nga përgjegjësit e sektorëve. Përgatit raport për realizimin e detyrave dhe harton plane kontrolli apo vizita fiskale për inspektorët në varësi.

Drejtori i Shërbimit mban përgjegjësi në informimin e Drejtorit Rajonal dhe raporton çdo problematikë të stafit punonjës. Siguron përdorimin, publikimin, dhe raportimin e të dhënave brenda afateve të përcaktuara.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar;

- Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Në si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

- Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

- Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidencë ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

- Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Në jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ÷Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-të, si dhe ISSAI 30 ÷Kodi Etikë, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme për çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, në besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit: Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të DRT Korçë, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare që kanë lidhje me sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Ligji nr. 154.2014 *“Mbi organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të*
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik, i ndryshuar, etj.*
- Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat*
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*
- Ligji me Nr. 92.2014 *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH.*
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar;*
- Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *“Për miratimin e manualit të MFK.*
- Rregullore e brendshme me nr. 19, datë 22.02.2017 *“Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e administratës tatimore*
- Rregullore Nr. 2 *“Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve,*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 *“Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006;*
- Urdhri i Ministrisë nr. 64, datë 22.07.2014 *“Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar etj.*

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

- ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 *“Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 *“Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”*; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”*; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”*; etj.

8. Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- c. Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky projekt raporti i Auditimit.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të D.R.T Korçë, në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për, prokurimin, menaxhimin financiar aktivitetin e Drejtorive të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin D.R.T Korçë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë (DRT) është institucion publik, buxhetor, në varësi të drejtëpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Misioni i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve është mbledhja e detyrimeve tatimore, ofrimi i shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrolli i deklaratave dhe pagesave, kontrolli i tatimpaguesve si dhe mbledhja e borxhit tatimor.

Objektivat e përgjithshme të DRT-së:

- Të sigurojnë ndërmarrjen e të gjithë veprimeve në aktivitetin e tyre të cilat cojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore qendrore;
- Të mbledhin të ardhurat tatimore në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi me koston më të ulët të mundshme, nëpërmjet nxitjes dhe vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore;
- Të bashkëpunojnë me drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e planit operacional në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Të përcaktojnë plane operationale vjetore me shkrim për çdo funksion;

- Të bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për trajnimin e punonjësve;
- Të hartojnë dhe zbatojnë programe në mënyrë qepërgjegjësit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre;
- Të ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr.10296 datë 08.07.2020 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar

Në zbatim të kësaj pike të Programit të auditimit nr. 947/1 prot., datë 14.09.2021ö, i ndryshuar, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2019 -08/2021, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15/10/2015
- Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar me Ligjin nr.178 / 2014;
- Manualin për MFK-në, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016;
- Rregullorja e Brendshme;
- Struktura dhe organika e Drejtorisë Rajonale Korçe;
- Dosjet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Korçe , vlerësimet e punës, trajnimet, përshkrimet e punës, rekrutime;
- Procedura, procese pune, etapa raportimi;

Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA),dhe ai zbatues (NZ) i cili mban pozicionin e Drejtorit të funksioneve mbështetëse,gjithashtu janë përmbushur kërkesat e Nenit 12/1, òPërgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatuesò të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar.

Nga ana e institucionit të DRT Korçe nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore pyetësorët e vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2018, 2019 dhe 2020, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", që përcaktojnë se "deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i dërgohen Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave".

Nga auditimi rezulton se, komponentët e kontrollit të brendshëm në Drejtorinë Rajonale Korçe rezultojnë si më poshtë:

1. Mjedisi i kontrollit

a. *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.*

DRT Korçe funksionion sipas rregullores të brendshme të miratuar me urdhërin nr. 14858 Prot., të datës 12.08.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila përcakton rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm sipas strukturave.

Lidhur me respektimin e etikës, Institucioni nuk ka të hartuar veçmas kodin e etikës, sikundër kërkohet prej kapitullit 3.1 òIntegriteti dhe vlerat etikeò në manualin për MFK-në,miratuar me

urdhërin e Ministrit të financave nr 108 të datës 17.11.2016,kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një kod të brendshëm etike, ose në një kod sjelljeje.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.192, datë 12.08.2020 òPër funksionimin e administratës tatimore qëndrore është miratuar rregullorja e brendshme e DRT-ve e cila ka rregulla të qarta për ndarjen e detyrave, hierarkinë dhe linjat e raportimit.

Struktura lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Drejtori Rajonal, Drejtorët, përgjegjësit e sektorëve deri tek specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimarrje. Sipas strukturës së njësisë, Drejtori Rajonal është përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe funksioneve të kësaj strukture. Drejtuesit, drejtorët apo përgjegjësit e sektorëve janë në varësi direkte të tij.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Marrëdhëniet e punëdhënësit rregullohen në bazë të ligjit për statusin e nëpunësit civil. ligji për statusin e nëpunësit civil, kodi i punës dhe dispozitat e tjera ligjore si, ligji për buxhetin e shtetit, ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin etj., lejojnë titullarin e institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura. Por mungesa e kodit etik, lë hapsira për abuzim dhe përcaktim të saktë të funksioneve dhe përgjegjësisë të secilit punonjës. në rast konflikte interesash, apo problematika në lidhje me kompetencat dhe realizimin apo mosrealizimin e detyrave të punës, sjell risk për hapsira konfliktuale dhe paqartësie për trajtimin e situatave. etika nuk është pjesë e rregullores së brendshme të miratuar me urdhërin nr.192 të datës 12.08.2020

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore

Përgjatë periudhës objekt auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë janë rekrutuar 7 punonjës të ri dhe janë larguar 15 punonjës.

Nga auditimi i dosjeve të punonjësve të DRT-së Korçë në lidhje me nivelin e diplomës dhe vjetërsinë e punës janë audituar 7 dosje punonjësish ose sa 9% e totalit të punonjësve, në lidhje me kualifikimet dhe trajnimet e zhvilluara në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe shkallës së profesionalizimit në punë u konstatua si në vijim:

Në këtë Drejtori janë bërë vlerësimet e punës, por konstatohen mangësi në plotësimet e disa formularëve me jo të gjithë elementët e vet, siç plani i zhvillimit profesional të punonjësve, kjo mangësi është konstatuar në të gjitha dosjet e audituara. Ndërsa për sa i përket nivelit të diplomës dhe vjetërsisë së punës nuk janë konstatuar problematika.

Nga auditimi i kryer në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet vijuese të dala në zbatim të tij, duke analizuar përmbajtjen e rregullores si dhe pozicionet e rolet e vendosura në rregulloren e funksionimit të DRT, rezulton se mungon një përputhje dhe harmonizim i akteve dhe dispozitave,ku më konkretisht mungon harmonizimi midis rregullores dhe strukturës së miratuar.

2. Menaxhimi i Riskut

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë nuk ka të miratuar një hartë të risqeve institucionale. Gjithashtu Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë nuk ka asnjë raportim të riskut operacional për vitet objekt auditimi (01/2019-09/2021), nuk ka asnjë risk kryesor të identifikuar. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë nuk ka një regjistër risku dhe nuk ka një sistem

raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi, në kundërshtim me nenin 11 pika 2 të ligjit 10926 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

3. Aktivitetet e kontrollit

Në drejtim të kontrolleve të brendshme, lidhur me komponentin e òaktiviteteve të kontrollitò u konstatua se janë hartuar proceset kryesore të punës operacionale, por ndryshimet në strukturën e institucionit nuk janë reflektuar në procedurat e kontrollit të brëndshëm.

Në përgjithësi DRT Korçë për shkak të vendit vakant të pozicionit òDrejtore Rajonalò, ka funksionuar me delegime në mungesë të Drejtorin rajonal përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2019. Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i parashikuar për t’u përdorur për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për tu përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndëruar në një mekanizëm të përhershëm. Neni 12 pika 4 e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 ndalon delegimin e detyrave të caktuara të një pozicioni pune, nuk mundet këto pozicione të mbahen nga nëpunës të deleguar në periudha afatgjata apo një vjeçare, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni.

Nga auditimi rezulton se ekziston regjistri i aktiveve dhe azhurnohet në çdo fund viti.

4. Informim komunikimi

Referuar urdhërit nr.108 të datës 17.11.2016 të Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik òPër miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollitò në kapitullin III të tij përcakton procedurat e informimit dhe komunikimit. Nga auditimi u konstatua se përgjatë periudhës objekt auditimi (01/2019-08/2021) në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë nuk ka pasur asnjë raportim nga NA referuar këtij urdhëri, gjithashtu institucioni nuk ka një rregullim të raportimit të njësive të varësisë tek NA dhe NZ.

Nga auditimi rezulton mungesa e një dokumenti të detajuar mbi sistemin e komunikimit të brëndshëm të nevojshëm që mundëson që të gjithë punonjësit të kuptojnë detyrimet dhe përgjegjësitë që cdonjëri ka në këtë sistem komunikimi.

5. Monitorimi

Në DRT Korçë është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë që rregullohet nga urdhëri nr 192 i datës 12.08.2020 òPër miratimin e rregullores së funksionimit të administratës tatimoreò. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë.

Në institucion, titullari i njësive informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike (javore, mujore dhe tremujore).

Sipas shpjegimeve të DRT Korçë monitorimi kryhet përmes mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme nga drejtorët dhe përgjegjësit për sektorët e tyre. Megjithatë nga auditimi rezulton se nuk ka një dokument të mirëfilltë mbi monitorimin si pjesë e kontrollit të brëndshëm referuar nenit 22 pika 3 òëò të ligjit 10926 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Nga auditimi rezulton se strukturat përgjegjëse të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (DRT) Korçë, nuk kanë njohuri të plota mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, Manualin e miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016 si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Konkluzion: Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera jo në përputhje me detyrimet ligjore sipas rastit, ngarkohen me përgjegjësi z.J.S me detyrë drejtor rajonal përgjatë vitit 2019 deri në muajin gusht në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe drejtor i shërbimeve mbështetëse në cilësinë e nëpunësit zbatues nga muaji gusht 2019 deri në përfundim të periudhës së auditimit; TH.T me detyrë drejtor rajonal në cilësinë e nëpunësit autorizues nga muaji gusht i vitit 2019 deri në muajin gusht të vitit 2020, znj. D.L me detyrë drejtor rajonal në cilësinë e nëpunësit autorizues nga muaji gusht i vitit 2020 deri në përfundim të periudhës nën auditim; znj. E.K me detyrë i drejtor shërbimeve mbështetëse e deleguar në cilësinë e nëpunësit zbatues nga muaji janar deri në muajin gusht të vitit 2019.

Titulli:	Problematika në funksionimin e sistemit të MFK.
Situata:	Në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultuan problematikat në vijim: - Në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet vijuese të dala në zbatim të tij, duke analizuar përmbajtjen dhe pozicionet e rolet e vendosura në rregulloren e funksionimit të DRT-ve mungon një përputhje dhe harmonizim i akteve, dispozitave dhe strukturës së miratuar; - Nga DRT Korçë nuk janë hartuar pyetësorët e vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar; manualit të MFK, kapitulli III, pika 3.5 <i>“Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm”</i> ; - Nga DRT Korçë nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve për arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21 të ligjit nr.10296/2010 i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 30 të Rregullores për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.
Kriteri:	- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollinö i ndryshuar neni 10,11 pika 2, neni 12 pika 3, neni 9 pika 4 dhe 18 pika 1 - Manuali MFK, kapitulli 3.1 - Neni 30 I Rregullores së funksionimit të drejtorive rajonale tatimore, miratuar me urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave
Ndikimi/Efekti:	Vështirësi në parandalimin e risqeve dhe mos identifikimi i tyre
Shkaku:	Mungesa e njohjes nga ana e strukturave të detyrimeve ligjore përsa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Titullari i institucionit të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me problematikat e konstatuara dhe të marrë masa për zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve, njohjen dhe implementimin e detyrimeve duke synuar rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit.

2.2 Vlerësimi i përmbushjes së misionit për realizimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore për periudhën 01.01.2019 deri në 30.09.2021 në përputhje me ligjet vjetore të buxhetit dhe akteve normative në ndryshim të tyre. Ecuria sipas zërave kryesore të të ardhurave dhe grup-tatimpaguesve sipas sektorëve të industrisë.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit nr. 947/1 prot., datë 14.09.2021 nga ana e grupit auditues u shqyrtuan informacionet dhe dokumentacionet si më poshtë:

-Treguesit e realizimit të planit të DRT Korçë.

-Raporte elektronike të gjeneruar prej sistemit informatik C@TS

- Akt-Rakordimi mujore dhe vjetore për të ardhurat e xhiruara ne degën e thesarit te rrethit Korçë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë nëpërmjet sektorit të analizës dhe të kontabilitetit të të ardhurave kryen ndjekjen e realizimit të arkëtimit të ardhurave nga subjektet tatimpaguese të këtij qarku nga sistemi informatik *E-Tax* duke përgatitur raporte me qëllim monitorimin e tyre. Të ardhurat arkëtohen në një llogari të vetme në DPT. Raportimi mujor dhe progresiv finalizohet në fund viti duke nënshkruar evidencën përfundimtare nëpërmjet përfaqësuesit të Degës së Thesarit Korçë dhe DPT.

Drejtoria Rajonale Korçë realizon monitorimin e realizimit të të ardhurave tatimore të përqendruara në një llogari të qendëruar në DPT dhe ardhurave dytësore nga subjektet tatimpagues dhe përgatit në fund të çdo muaji dhe tremujori raporte dhe evidenca për DPT dhe Titullarin e institucionit për realizimin e treguesve të të ardhurave tatimore, si dhe evidencat të detyrimeve debitorë që mbahen jashtë sistemit informatik C@TS.

Konkretisht për vitin 2019.

Plani vjetor ka ndryshuar 3 herë krahasuar me planin fillestar të programuar më parë. Në aneksin bashkëlidhur këtij Raporti Auditimi pasqyrohen edhe ndryshimet respektive. Planifikimi fillestar i planifikuar nga DPT deri ne muajin Mars 2019 ka qenë në shifrën 6,051,000 lekë. Nga niveli i të ardhurave tatimore të planifikuara nga DPT-ja në shumën 6,051,000 mijë lekë në muajin mars plani i azhornuar nga DPT-ja ka kaluar në nivelin prej 6,140,000 mijë lekë sipas shkresës se ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe protokolluar me shkresën nr. 18977 prot, DRT Korçë më datë 12.12.2019. Rezulton se planifikimi i planit nga DPT-ja për realizim nga DRT Korce ka ardhë në rritje duke pësuar një ndryshim pozitiv ne shumën prej 89,000 lekë në muajin dhjetor 2019. Ndryshimet e shpeshta të planifikimit të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ne vecanti ne muajin dhjetor 2019 i cili është edhe muaji i fundit i vitit përgjate të cilit përmbillet realizimi vjetor i treguesve fiskale tregojnë për nje mangësi të nivelit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Per vitin 2019 rezulton nje realizim i të ardhurave tatimore në shumën prej 5,918,9193 mijë lekë dhe një mosrealizim në nivelin prej 4 % nga plani i të ardhurave të planifikuara nga DPT-ja në vlerën prej 221,087 mijë lekë, fakt i cili tregon për performancën e dobët të veprimtarisë së kësaj Drejtorie Rajonale të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë për vjeljen e të ardhurave tatimore në përmbushje të misionit të kësaj administrate .

Rezulton se zëri më pak i realizuar në llojet e tatimeve dhe taksave në të ardhurat tatimore është zëri **“Taksa Kombëtare”** i cili është realizuar në masën 55% të totalit të parashikuar, fakt i cili tregon për punën jo të duhur të kryer nga administrata tatimore e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë. Gjithashtu edhe zëri i të ardhurave tatimore **“Tatimi i TVSH”** ka rezultuar me mosrealizim në masën 8.7% dhe në vlerën 79,357 mijë lekë. Nga treguesit fiskalë rezulton e ardhura tatimore **“Tatimi mbi Fitimin”** në nivelin 95.5% dhe me një mosrealizim në masën

24,642 mijë lekë, si dhe treguesi i të ardhurës tatimore të të *Ardhurave Personale* me një realizim prej 15,9%, tejkallim në vlerën 131,880 mijë lekë.

Konkretisht për vitin 2020:

Plani vjetor ka ndryshuar 2 herë krahasuar me planin fillestar të programuar më parë. Në aneksin bashkëlidhur këtij Raporti Auditimi pasqyrohen edhe ndryshimet respektive. Planifikimi fillestar i planifikuar nga DPT deri në muajin shkurt 2020 ka qenë në shifrën 6,140,000 mijë lekë. Në muajin shkurt 2020 plani i azhornuar nga DPT-ja ka kaluar me ulje planifikimi në nivelin prej 5,990,000 mijë lekë sipas shkresës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në muajin gusht 2020 plani i azhornuar nga DPT-ja ka kaluar përsëri me ulje planifikimi në nivelin prej 5,435,000 mijë lekë me një ulje prej 12 % sipas shkresës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në përfundim të vitit 2020 rezulton një realizim i të ardhurave tatimore në shumën prej 5,240,820 mijë lekë me një mosrealizim në shumën 194,180 mijë lekë ose në nivelin prej 3.4% krahasuar me planifikimin e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve fakt i cili tregon për performancën e dobët të veprimtarisë së kësaj Drejtorie Rajonale të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë për vjeljen e të ardhurave tatimore në përmbushje të misionit të kësaj administrate.

Ndryshimet e shpeshta të planifikimit të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në vecanti në muajin gusht 2020 i cili tregojnë për një mangësi të nivelit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Rezultoni se zëri më pak i realizuar në llojet e tatimeve në të ardhurat tatimore është zëri *Taksa Kombëtare* i cili është realizuar në masën 74.3%, me një mosrealizim në nivelin 15,421 mijë lekë fakt i cili tregon për punën jo të duhur të kryer nga administrata tatimore e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë. Gjithashtu edhe zëri i të ardhurave tatimore *Tatimi i TVSH (Vlerës së shtuar)* ka rezultuar me mosrealizim në masën 12.5% në vlerën 99,507 mijë lekë. Nga treguesit me performancë negative rezultoni e ardhura tatimore *Tatimi mbi Fitimin* në nivelin 82.7% dhe me një mosrealizim në masën 69,234 mijë lekë si dhe treguesi i të ardhurës tatimore të të *Ardhurave Personale* me një mosrealizim në masën 87.1%, në vlerën 96,760 mijë lekë. Në përfundim rezultoni një mosrealizim total i të ardhurave tatimore në nivelin prej 3.6% nga plani i të ardhurave, në shumën 194,180 mijë lekë, fakt i cili tregon për performancën e dobët të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për vitin 2020 nga niveli më i lartë drejtues deri në nivelin bazë të personelit nëpunës të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtë dhe të tërthortë në punën e përditshme për vjeljen e të ardhurave tatimore në përmbushje të misionit të kësaj administrate .

Konkretisht për periudhën Janar-Shtator 2021.

Në aneksin bashkëlidhur këtij Projekt Raporti Auditimi pasqyrohen edhe ndryshimet respektive. Plani vjetor ka ndryshuar 2 herë krahasuar me atë fillestar. Për periudhën *Janar-Shtator 2021* treguesit e të ardhurave të mbledhura nga ana e DRT-Korçë paraqiten sipas aneksit bashkëlidhur këtij projekt raporti auditimi. Në ndryshimet e mësipërme e kryera krahasuar kjo me planifikimin fillestar të muajit Janar-Shtator 2021, rezultoni një realizim më i lartë i të ardhurave tatimore për Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë në shumën prej 58,185 mijë lekë ose në masën sa 102% të planifikimit. Rezultoni se zëri më pak i realizuar në llojet e tatimeve dhe taksave tatimore është zëri *Taksa Kombëtare* i cili është realizuar në masën 60% të totalit të parashikuar në planin përfundimtar dhe në vlerë 18,455 mijë lekë, fakt i cili tregon për punën jo të duhur të kryer nga administrata tatimore e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

Gjithashtu edhe zëri i të ardhurave tatimore *Tatimi i TVSH (Vlerës së shtuar)* ka rezultuar me një realizim në masën 92% të planit dhe me një mosrealizim në vlerën e 36,312 mijë lekë në ndryshim nga planifikimi. Nga treguesit me performancë negative rezultoni e ardhura tatimore

“**Tatimi mbi Fitimin**” në nivelin 85% dhe me një mosrealizim në masën 42,884 mijë lekë si dhe treguesi i të ardhurës tatimore të të **“Ardhurave Personale”** me një realizim dhe tregues performance pozitive në masën 125% % dhe me një realizim në krahasim me planifikimin në vlerën 106,809 mijë lekë. Në përfundim rezultojnë për periudhën Janar-Shtator 2021 një realizim total i të ardhurave tatimore të realizuara në nivelin prej 102% nga plani i të ardhurave të planifikuara për këtë periudhë dhe me një realizim neto në shumën 3,777.876 mijë lekë, fakt i cili tregon për një performancë të mirë të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për vitin 2021 nga niveli më i lartë drejtues deri në nivelin bazë të personelit nëpunës të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtë dhe të tërthortë në punën e përditshme për vjeljen e të ardhurave tatimore në përmbushje të misionit të kësaj administrate.

Trajtuar më hollësisht në aneksin nr 2.1-2.3 bashkelidhur këtij Projekt Raport Auditimi.

Në lidhje me të ardhurat dytësore:

- ***Të Ardhurat nga Tatim Fitimi i Thjeshtuar (TFTH) .***

U vendosën në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të dhënat për vitin 2019, 2020, dhe periudha 01.01.2021-30.09.2021 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TFTH mbi biznesin e vogël. Në anekset bashkelidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi janë edhe të dhënat për vitin 2019 sipas të ardhurave tatimore të ndarjeve territoriale të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

- ***Në lidhje me të Ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve***

Shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj për **vitin 2019** (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar në shumën 16,359,266 lekë

Nga rakordimi me Degën e thesarit rezultojnë se arkëtimet në thesar për vitin 2019 për shitjet e shtypshkrimeve janë në vlerën **16,363,416 lekë**.

Shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor etj., për **vitin 2020** (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar në shumën 7,408.572 lekë. Nga rakordimi me Degën e thesarit rezultojnë se arkëtimet në thesar janë në vlerën **7,407,186 lekë**. (diference shume e ulet)

Shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj për **vitin 2021 periudha Janar-Shtator 2021** (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar në shumën 3,464,016 lekë.

Nga rakordimi me Degën e thesarit rezultojnë se arkëtimet në thesar janë në vlerën **3,456,708 lekë**.

- ***Në lidhje me të Ardhurat nga deklarimi vjetor i tatim fitimit, dorëzimi në afat.***

Nga auditimi i dorëzimit të deklaratave vjetore të tatim fitimit për periudhën në auditim, pra 2019-2021, e cila përfshin :

- auditimin e **deklaratës përfundimtare të TF 2018** e cila është dorëzuar nga 01-01.2019-31.03.2019,
- auditimin e **deklaratës përfundimtare të TF 2019**, e cila është dorëzuar nga 01-01.2020-31.03.2020,
- auditimin e **deklaratës përfundimtare të TF 2020**, e cila është dorëzuar nga 01-01.2020-31.03.2020,

Rezultojnë se deklaratimet vjetore të të Ardhurave tatimore, Tatim fitim i detyrueshëm për t'u paguar dhe pagesat vjetore rezultojnë sipas të dhënave të tabelave për çdo vitet e mëposhteme

Tabela nr.9 “Deklarimet vjetore të T.F, tatim pagues të deklaruar dhe pagues viti 2018”

(në lekë)

SEKTORET.2018	NR. DEKLARUESVE	TE ARDHURAT TATIMORE	TF PER TU PAGUAR	PAGESA KRYER	NR. PAGUESVE
Sektorin e Ndërtimit	86	2,879,295,055	57,365,766	71,764,336	57
Sektorin e Prodhimit	209	8,703,306,050	152,092,539	143,935,973	144
Sektorin e Shërbimit	149	2,226,072,921	37,000,293	39,302,176	111
Sektorin e Transportit	30	860,428,416	8,967,726	6,449,638	22
Sektorin e Tregtisë	392	17,016,986,270	164,645,638	158,383,686	332
Grand Total	866	31,686,088,712	420,071,962	419,835,809	666

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Tabela nr.10 “Deklarimet vjetore të T.F, tatim pagues të deklaruar dhe pagues viti 2019”

(në lekë)

SEKTORET.2019	NR. DEKLARUESVE	TE ARDHURAT TATIMORE	TF PER TU PAGUAR	PAGESA KRYER	NR. PAGUESVE
Sektorin e Ndërtimit	78	2,607,643,285	52,780,978	63,652,034	50
Sektorin e Prodhimit	204	8,242,246,555	114,299,344	130,128,029	135
Sektorin e Shërbimit	150	2,634,754,850	39,166,853	38,809,039	108
Sektorin e Transportit	29	916,517,050	9,507,203	6,625,384	19
Sektorin e Tregtisë	387	17,747,047,044	155,972,058	164,778,208	322
Total	848	32,148,208,784	371,726,436	403,992,694	634

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Tabela nr.11 “Deklarimet vjetore të T.F, tatim pagues të deklaruar dhe pagues viti 2020”

(në lekë)

SEKTORET.2020	NR. DEKLARUESVE	TE ARDHURAT TATIMORE	TF PER TU PAGUAR	PAGESA KRYER	NR. PAGUESVE
Sektorin e Ndërtimit	80	2,017,277,556	35,128,033	28,980,957	50
Sektorin e Prodhimit	205	7,594,147,598	97,735,554	98,492,937	129
Sektorin e Shërbimit	165	2,478,338,630	25,193,241	26,810,696	109
Sektorin e Transportit	32	618,638,726	8,314,459	5,518,844	15
Sektorin e Tregtisë	388	17,662,076,753	170,155,742	155,115,572	299
Total	870	30,370,479,263	336,527,029	314,919,006	602

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se për vitin 2018 nga 866 subjekte tatimpagues që kanë qënë kategorizuar si subjekte që mbartin detyrimin ligjor për të deklaruar Tatim Fitim rezultojnë **666 subjekte që kanë rezultuar me fitim** dhe pjesa tjetër e subjekteve kane rezultuar me humbje. Për vitin 2019 nga 848 subjekte tatimpagues që kanë qënë kategorizuar si subjekte që mbartin detyrimin ligjor për të deklaruar Tatim Fitim rezultojnë **634 subjekte që kanë rezultuar me fitim** dhe pjesa tjetër e subjekteve kane rezultuar me humbje dhe për vitin 2020 nga 870 subjekte tatimpagues që kanë qënë kategorizuar si subjekte që mbartin detyrimin ligjor për të deklaruar Tatim Fitim rezultojnë **602 subjekte që kanë rezultuar me fitim** dhe pjesa tjetër e subjekteve kane rezultuar me humbje. Nga viti ushtrimor i periudhës tatimore të vitit 2018 krahasuar me vitin ushtrimor të periudhës të vitit 2020 reflektohet një rënie subjekteve që kanë

deklaruar fitim dhe që kanë paguar tatim fitim kryesisht në sektorin e ndërtimit, në sektorin e prodhimit, në sektorin e shërbimit, në sektorin e transportit dhe në sektorin e tregëtisë.

Si përfundim:

Për vitin 2019 rezulton një mosrealizim prej 4% në shumën prej 221,087 mijë lekë, fakt i cili tregon për performancën e dobët të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nga ana e personelit nëpunës të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në punën e përditshme për vjeljen e të ardhurave tatimore në përmbushje të misionit të kësaj administrate .

Për vitin 2020 rezulton një mosrealizim prej 3.6% në shumën 194,180 mijë lekë fakt i cili tregon për performancën e dobët të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe nga ana e personelit nëpunës të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në punën e përditshme për vjeljen e të ardhurave tatimore në përmbushje të misionit të kësaj administrate

Për periudhën Janar-Shtator 2021 rezulton një realizim total i të ardhurave tatimore prej 102%, me një realizim neto në shumën 3,777.876 mijë lekë fakt i cili tregon për performancë te mire të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe për këtë periudhë të vitit 2021. Rezulton se zëri më pak i realizuar dhe i arkëtuar në kategoritë e llojit të tatimeve është zëri **“Taksa Kombëtare”** i cili është realizuar në masën **55%** për vitin 2019 **74.3%** në 2020 dhe në nivelin **60%** për periudhën janar-teor 2021, fakt i cili tregon për punën jo të duhur të kryer nga administrata tatimore e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj takse kombëtare.

Rezulton se nga viti ushtrimor i periudhës tatimore të vitit 2018 (**666 subjekte që kanë rezultuar me fitim**) krahasuar me vitin ushtrimor të periudhës të vitit 2020 (**602 subjekte që kanë rezultuar me fitim**) reflektohet një rënie e subjekteve që kanë deklaruar fitim dhe që kanë paguar Tatim Fitim me një rënie në vitin 2020 konkretisht në sektorin e ndërtimit, në sektorin e prodhimit, në sektorin e shërbimit, në sektorin e transportit dhe në sektorin e tregëtisë. dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë nuk rezultoi një analizë specifike dhe e detajuar për këtë konstatim

Titulli i gjetjes :	<i>Mosrealizimi i treguesve tatimore pranë DRT-Korçë</i>
Situata:	Realizimi i të ardhurave për vitin 2019 rezulton me një diferencë prej 4%, e cila përfaqëson shumën 221,087 mijë lekë dhe për vitin 2020 mosrealizimi prej 3.6%, në vlerën 194,180 mijë lekë, fakt i cili tregon për performancën e dobët të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe në përmbushje të misionit të stafit drejtues dhe nëpunësve zyrtarë të kësaj Drejtorie. Në periudhën 01.01.2021 deri më datë 30.08.2021 konstatohet një realizim i të ardhurave tatimore në nivelin prej 102%, por me një rezultat të të ardhurave neto të arkëtuara më të vogël se ai i realizuar në vitin 2019 dhe 2020, si pasojë e rishikimit të planit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Zëri më pak i realizuar dhe i arkëtuar në kategoritë e llojit të tatimeve është për “Taksa kombëtare” i cili është realizuar 55% për 2019, për vitin 2020 është 74.3% dhe në nivelin 60% për vitin 2021, duke treguar për mangësi në veprimtarinë e këtij subjekti.
Kriteri:	<i>1- Neni 1, 2, 4 të Kapitullit 1 të Rregullores e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020.</i>

	2-Pika 1.3 pika 1,4 dhe pika 1,5 e Kapitullit 1 te Manuali i Kontrollit Tatimor 3-Neni 1, 2, 4 të Kapitullit 1 të Rregullores e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhërin nr. 1482/2 prot., datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave
Ndikimi. Efekti:	Mos realizim i të ardhurave tatimore pranë DRT Korçë me pasoje prishjen e ekuilibrave të të ardhurave dhe shpenzimeve ne Buxhetin e Shtetit.
Shkaku:	Mangësi dhe mos kryerja e analizave specifike nga DRT Korçë për realizimin e të ardhurave tatimore sipas zërave respektive dhe mos kryerja e nje analize periodike për ecurinë deklaruese dhe paguese të subjekteve tatimpagues sipas sektorit të industrive respektive.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të përmirësojë metodologjinë e punës të strukturave në tërësi dhe në veçanti të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, e cila kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në monitorimin dhe kontrollin e të ardhurave tatimore, bazuar në profilet e riskut, të monitorimit dhe të kontrollit për llojet e tatimeve dhe kategoritë e subjekteve tatimpagues që kryejnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të kësaj Drejtorie.

2.3 Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

2.3.1 Auditimi i procedurave tatimore në lidhje me afatet e evadimit të akteve administrative zyrtare në përputhje me afatet e parashikuara në legjislacionin tatimor në fuqi

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit u shqyrtua përputhshmëria e veprimtarisë së kryer nga drejtorja e kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullativ tatimor. Më konkretisht është audituar përputhshmëria e afateve kohore ligjore të përpunimit të dosjeve të program kontrolleve të tërhequra nga grupi i kontrollit për auditim mbi bazën e riskut të përpiluar nga audituesit shtetërorë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

✚ Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për nxjerrjen e aktit të njoftimit të kontrollit tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi u konstatua se :

Auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion është bazuar në nenin 81 -Njoftimi i Kontrollit Tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar ku përcaktohet se :

2. Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:

e) periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor;

f) datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut.

(h) një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik për kontrollin tatimor. Afati për kryerjen e kontrollit, i përcaktuar në përputhje me shkronjën "f", mund të zgjatet pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, por jo më shumë se 15 ditë pune.

Gjatë auditimit u konstatua se:

1- Nga shqyrtimi i aktit të njoftimit të kontrollit u konstatua se, akti i njoftim vlerësimit nuk kishte të përcaktuar inspektorin, nëpunësin përgjegjës të Drejtorisë Rajonale Tatimore, si dhe periudhën objekt të kontrollit sipas përcaktimeve ligjore të pikës 2/dh, të nenit 81 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

2- Bashkëlidhur aktit të njoftimit të kontrollit tatimor, të nënshkruar nga Drejtori Rajonal ishte bashkëlidhur edhe akti i programit të Kontrollit të nënshkruar nga përgjegjësi i zyrës së kontroleve dhe miratuar nga Drejtori i Zyrës së Kontrollit Tatimor, por pa datë, numër protokollit dhe vulë të institucionit.

3- Gjithashtu, formulari i vetdeklarimit sipas pikës nr. 3 të nenit nr. 81 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 nuk rezultonte i nënshkruar në asnjë dosje kontrolli nga subjekti tatimpagues objekt kontrolli.

Bazuar në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 *oKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë* neni 99 përcakton se *“Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik” duhet të përmbajnë elementët e mëposhtëm:*

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;

iii) datën e miratimit;

Në nenin 43 të ligjit të mësipërm *oNjësia dhe nëpunësi përgjegjës* përcaktohet sa më poshtë vijon se :

1. Në një procedure administrative, të filluar sipas parashikimeve të nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij neni.

2. Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.

3. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative. Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore.

Në nenin 99 të ligjit të mësipërm *oKërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik* përcaktohet sa më poshtë vijon se :

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin

ii) palët të cilave u drejtohet akti;

iii) datën e miratimit;

Nga ana e grupit të auditimit janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e program kontroleve të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arkiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së aktit administrativ të *oNjoftimi i Kontrollit Tatimor*. Në tabelën e aneksit nr. 3.1 bashkëlidhur këtij Raporti Auditimi trajtohen edhe rastet e praktikave të dosjeve të kontrollit të tërhequra pranë zyrës së arkiv-protokollit shoqëruar me rastet ku nuk është respektuar përcaktimi ligjor i nenit nr. 81 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *oPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 *oKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*.

Si konkluzion nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme arrihet në përfundimin se nga përgjegjësi i sektorit të kontrollit tatimor në terren z. P.T, me detyrë drejtor i kontrollit tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, z. E.M (për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020) dhe z. K.C (per periudhën nga data 16.12.2020-13.09.2021) nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren e funksionimit të administratës

tatimore dalë me urdherin nr. 192 datë 12.08.2020, si dhe përcaktimit të nenit 81 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*. Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të kryera sipas përcaktimeve të nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44.2015 datë 30.04.2015 procedurat administrative për nxjerrjen e akteve të *“Autorizimit”* për *Inspektorin Nënpunës civilë* që do të kryejë procedurat e kontrollit tatimor dhe procedura administrative e nxjerrjes së aktit administrative *“Program Kontrolli”* sipas formës së përcaktuar në kodin e procedurave administrative në lidhje me formën dhe përmbajtjen **e Aktit me numër, datë, firmë dhe vulë.**

Gjithashtu ngarkohen me përgjegjësi për moszbatim të detyrave funksionale në cilësinë e nënpunësit zyrtar të lartë që *“Menaxhon burimet e Drejtorisë Rajonale Tatimore për probleme që lidhen me zbatimin e detyrave të tjera të autorizuar nga legjislacioni dhe të kërkuara nga procedurat tatimore”* personat zyrtarë me detyra funksionale Drejtor të Drejtorisë Rajonale Korçë sipas nenit 4 pika 3 (e) Rregullores së funksionimit të administratës tatimore dalë me urdherin nr. 192 datë 12.08.2020.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2-Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020.

3-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

4-Manuali i Procedurave Tatimore.

5. Ligji nr 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

1- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020.

2- z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë per periudhën nga data 16.12.2020-13.09.2021.

3- z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

5- znj. D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 27.08.2020 deri 30.09.2021).

6- z. Th.T në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 05.08.2019 deri 14.08.2021).

7 z. J.S në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë(periudha 01.01.2019 deri 30.09.2021).

Sa me poshtë edhe tabela e rasteve të akteve administrative të Njoftim Kontrollit Tatimor për subjektet e trajtuar në tabelle ku nuk janë zbatuar kriteret ligjore dhe administrative të Aktit të Njoftimit Tatimor

VITI	Data Njoftimit	Pa procedure	Autorizim.program.kontroll	Nr. P.Kontroll	Formular.Vetdeklarimi	Pergj.Oper
2019	08.08.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	17.05.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	11.08.2020		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2018	15.06.2021		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	16.11.2020		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	12.02.2019	Mungon.INSP	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	09.03.2021		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	11.02.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	12.08.2020	Mungon.INSP	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	11.12.2018		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	13.10.2020	Mungon.INSP	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	05.11.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T

2020	01.10.2020	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	11.08.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	07.04.2020		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	12.08.2021		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	12.03.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	18.03.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2018	07.01.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	30.04.2020	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2018	07.01.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2018	29.10.2018		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	19.11.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	19.11.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	11.05.2021		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	16.09.2020		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	14.07.2021		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	29.06.2021	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	17.05.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	07.01.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	13.06.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2020	07.01.2020	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	18.03.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	03.02.2021		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	23.05.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2021	12.03.2021	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	25.04.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	26.08.2019		Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T
2019	05.11.2019	Mungon.INS	Pa procedure	pa date. firm.vule	Pa nenshkrim	P.T

Burimi: Të dhëna të marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

Trajtuar më hollësisht sipas rasteve respektive në tabelën nr 3.1 bashkëlidhur këij Raporti Projekt Auditimi.

✚ Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për nxjerrjen e Aktit të Raportit paraprak të kontrollit Tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi u konstatua se :

Nga Auditimi i dokumentacionit të marre në shqyrtim u konstatua se nuk janë përmbushur kriteret ligjore bazuar në nenin nr. 83 *“Raporti i kontrollit tatimor”* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar ku përcaktohet se

83.1 Pas çdo kontrolli tatimor, jo më shumë se 7 shtate dite nga përfundimi i tij, inspektori i kontrollit tatimor, është i detyruar të përgatisë raportin e kontrollit.

83.2 Raporti i kontrollit tatimor, përshkruan veprimtarinë ekonomike e tregtare të personit të tatueshëm, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, Të dhënat e shfrytëzuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështet atë. Raporti i kontrollit përbën bazën për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrole të mëvonshme si dhe për vlerësimin e punës së vete kontrollorit nga ana e drejtuesve të drejtorisë rajonale të tatimeve.

83.3 Inspektori i kontrollit i jep urdhëruesit të kontrollit një kopje e raportit të kontrollit, kurse një kopje tjetër ia dërgon personit të tatueshëm, me shërbimin postar rekomandë.

83.4 Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

83.5 Kundërshtimi paraqitet me shkrim dhe ai i dërgohet drejtorisë rajonale të tatimeve me shërbimin postar rekomandë ose dorëzohet dorazi në drejtorinë rajonale përkundrejt marrjes së një konfirmimi me shkrim.

Nga ana e grupit auditues janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e Raportit Kontrollit të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arshiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së Aktit administrativ të *“Raportit Kontrollit”*. Nga këqyrja e akteve të Përfundimit të Kontrollit në terren nga inspektori/nënpunësi përgjegjës dhe datës së evadimit të Raportit paraprak të kontrollit u konstatuan 4 raste në të cilat Evadimi shpresor i materialit të Raportit Kontrollit nuk ishte kryer brenda afateve të përcaktuara në nenin nr. 83 *“Raporti i Kontrollit Tatimor”* të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 brenda afatit prej 7 ditësh. Sa më poshtë rastet ku nuk janë zbatuar të sakta afatet ligjore për evadimin e materialeve të programit të kontrollit brenda afatit 7 ditësh.

Tabela nr.12 “Afatet ligjore për evadimin e materialeve të program kontrollit”

Emri	Vonese.Evadim	Inspektori
P.F	10 dite	A.ZH
G.K	142 dite	E.S
MRM	60 dite	E.S
F.B	12 dite	SH.XH

Burimi: Të dhëna të marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

Në aneksin bashkëlidhur këtij Projekt Raport Auditimi janë të evidentuara edhe rastet në të cilat nga ana e perfaqësuesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë **nuk janë zbatuar afatet ligjore** të përgatitjes së Raportit të Kontrollit brenda 7 ditëve sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*.

Aneksi 3.3 (Procedura ligjore e nxjerrjes së Aktit administrativ “Raporti i Kontrollit”)

Si konkluzion nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit Tatimor në Terren z. P.T, Drejtori i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë z. E.M (për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020) dhe z. K.C per periudhen nga data 16.12.2020 -30.09.2021, si dhe inspektorët/nëpunës përgjegjës të trajtuar në tabelën e mësipërme si dhe dhe në tabelën e ankesit nr. 3.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit të cilët nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren e funksionimit të administratës tatimore dalë me urdherin nr. 192 datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 83 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44.2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”* (rastet e përcaktuara sa më sipër që korrespondojnë me 8 ditë dhe 9 ditë vonese nuk merren në konsideratë si afate ligjore të shkelura).

Ngarkohen me përgjegjësi për moszbatim të detyrave funksionale në cilësinë e nënpunësit zyrtar të lartë që *“Menaxhon burimet e Drejtorisë Rajonale Tatimore për probleme që lidhen me zbatimin e detyrave të tjera të autorizuara nga legjislacioni dhe të kërkuara nga procedurat tatimore”* personat zyrtarë me detyra funksionale Drejtor të Drejtorisë Rajonale Korçë sipas nenit 4 pika 3 (e) Rregullores të Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*.

2- Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020

3-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave

4-Manuali i Kontrollit Tatimor

5. Ligji nr 44/2015, datë 30.04.2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

1- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020.

2- z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë per periudhen nga data 16.12.2020-13.09.2021.

3- z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

4- z. A.Zh në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

5- z. E.S në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

6- z. S.X në cilësinë e ish-inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

7- z. D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 27.08.2020 deri 30.09.2021).

8- z. Th.T në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 05.08.2019 deri 14.08.2020).

9- z. J.S në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 01.01.2019 deri 30.09.2021).

Trajtuar më hollësisht sipas rasteve respektive në tabelën nr 3.2 dhe nr 3.3 bashkëlidhur këtij Raporti Projekt Auditimi.

✚ Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për nxjerrjen e Aktit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi u konstatua se :

Nga Auditimi i dokumentacionit të marre në shqyrtim u konstatua se nuk janë përmbushur kriteret ligjore bazuar në nenin nr. 84 të Raportit Përfundimtar i Kontrollit Tatimor dhe nenit 23 të Mënyrat e Komunikimit me Tatimpaguesinë të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 të Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ku përcaktohet se :

1. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor.
2. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përshkruan vendin e kontrollit, periudhën, për të cilën është kryer kontrolli, një përshkrim të dokumenteve të shqyrtuara, personat e intervistuar, arsyetimin e tatimpaguesit, të marrë parasysh dhe rezultatin e argumentuar të kontrollit.
3. Një kopje e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor dhe shuma e vlerësimit, nëse ka, i dërgohet tatimpaguesit me postë dhe një kopje dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore apo në njësinë e ngjashme me të.
4. Nëse raporti përfundimtar i kontrollit tatimor propozon një vlerësim të ri, ky vlerësim hyn në fuqi 30 ditë kalendarike nga data që raporti i kontrollit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi
5. Tatimpaguesi, që kundërshton vlerësimin e propozuar, mund ta ankimojë këtë vlerësim, në përputhje me dispozitat e kreut XIII të këtij ligji.

Neni 23 Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin.

1. Administrata tatimore mund të kërkojë përdorimin nga tatimpaguesit të formularëve të veçantë, për dorëzimin e dokumentacionit, informacionit apo kërkesave. Kur nuk kërkohet formular, çdo komunikim, i kërkuar sipas legjislacionit tatimor, dërgohet në mënyrë elektronike ose dorëzohet me shkrim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.
2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën e deklaruar nga vetë ai:
 - a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike dhe;
 - b) nëpërmjet shërbimit postar rekomandë.
3. Aktet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të postës rekomandë. Data e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Dhënia e pëlqimit dhe mënyra për marrjen dhe vlefshmërinë e dhënies së pëlqimit për komunikimin elektronik të tatimpaguesit me administratën tatimore rregullohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Në tabelën e mëposhtme janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e Raportit Kontrollive të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arshiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së Aktit administrativ të Raportit Përfundimtar Kontrolliv. Nga

këqyrja e akteve të Evadimit të Raportit Perfundimtar të Kontrollit nga Inspektori/nënpunësi përgjegjës dhe zyrtarët eprorë të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi u konstatuan raste në të cilat evadimi shpresor i materialit të Raportit Perfundimtar të Kontrollit nuk ishte kryer brenda afateve të përcaktuara në nenin nr. 84 të Raportit *Përfundimtar të Kontrollit Tatimor*” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* brenda afateve të përcaktuara. Sa më poshtë edhe rastet ku nga ana e perfaqësuesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk janë zbatuar afatet ligjore të përgatitjes së raportit përfundimtar të kontrollit në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*,

Tabela nr.13 “Afatet ligjore të përgatitjes së raportit përfundimtar të kontrollit”

Viti	Emri	K.ekonomik	NIPTi	Oret e punes	Dt Evad..Rap	Dt Evadim.RapPerf	Shkelj e afati	Insp	Per..Ope r	D.Kontrolli
2021	P.F	C1013	Ki	100	05.05.2021	16.06.2021	41 dite	A.ZH	P.T	K.C

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Si konkluzion nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se nga Përgjegjësi i Sektorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor z. P.T, Drejtori i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë z. E.M (për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020) dhe z.K.C për periudhën nga data 16.12.2020-13.09.2021 si dhe inspektorët/nënpunës përgjegjës z. A.Zh të cilet nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 84 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44.2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”*.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2- Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020.

3-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

4-Manuali i Kontrollit Tatimor.

3 Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

1- z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë per periudhen nga data 16.12.2020-13.09.2021.

2- z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

3- z. A.Zh në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

4- znj. D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 27.08.2020 deri 30.09.2021).

Trajtuar më hollësisht sipas rasteve respektive në tabelën nr. 3.4. bashkëlidhur këtij Raporti Auditimi.

- ✚ Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për nxjerrjen e Njoftimit të Vlerësimit Tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor.*

Bazuar në nenin 69 të Njoftimit i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”

te Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ku përcaktohet se :

Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit Njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor:

Në tabelën e mëposhtëme janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e Raport Kontrollleve të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arkiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së Aktit administrativ të *ōRaportit Përfundimtar të Kontrollitō*. Nga këqyrja e akteve të Evadimit të Njoftimeve të Vlerësimit nga *inspektori/nēnpunēsi pērgjegjēs dhe zyrtarēt eprorē* të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi u konstatuan raste në të cilat evadimi shkresor i materialit të Njoftimit të Vlerësimit nuk ishte kryer brenda afateve të përcaktuara në nenin nr. 69 *ōNjoftimi i Vleresimit Tatimor”* të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ōPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëō*

Bashkelidhur këtij Raporti Auditimi edhe rastet ku nga ana e perfaqësuesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk janë zbatuar afatet ligjore të përgatitjes së Njoftimit të Vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *ōPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëō*. Nga këqyrja e akteve administrative të evadimit të njoftimeve të vlerësimit nga *inspektori/nēnpunēsi pērgjegjēs dhe zyrtarēt eprorē* të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi u konstatuan rastet në të cilat evadimi shkresor i materialit të njoftimit të vlerësimit nuk është kryer sipas afatev kohore të përcaktuara në nenin nr. 69 *ōNjoftimi i Vleresimit Tatimor”* të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ōPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëō* brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në tabelën e mëposhtëme edhe rastet konkrete:

Tabela nr.14 “Afatet ligjore të evadimit shkresor i materialit të njoftimit të vlerësimit”

<i>Emri</i>	<i>Insp.Kontr</i>	<i>Pergj.Oper</i>	<i>D.Kontrolli</i>	<i>Tejkalimi</i>
B	B.K	P.T	E.M	12 dite
E.M	K.C	P.T	E.M	12 dite
M	A.ZH	P.T	E.M	12 dite
F.G	B.P	P.T	K.C	14 dite
E.2	S.K	P.T	E.M	16 dite
M.P	K.C	P.T	E.M	16 dite
A	K.XH	P.T	E.M	18 dite
F-F	E.S	P.T	K.C	20 dite
E.C	SH.XH	P.T	E.M	25 dite
K.C	A.M	P.T	E.M	25 dite
F.C	M.H	P.T	E.M	92 dite

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Gjithashtu sa më poshtë vijon edhe rastet e evidentuara për raste të praktikave të dosjeve të program kontrolleve ku nuk rezultojnë të evaduar aktet e njoftim vlerësimit nga drejtoria rajonale tatimore Korçë dhe për të cilat nga zyra e arkiv-protokollit nuk u dha një përgjigje zyrtare dhe nuk u vendosën në dispozicion këto akte gjatë periudhës audituese në terren si dhe gjatë fazës së observacioneve gjatë përgatitjes së raportit të auditimit të cilat rezultojnë sa me poshtë vijon :

Tabela nr.15 “Njoftim vlerësime të pa evaduar”

<i>VITI</i>	<i>Emri</i>	<i>Kodi.E</i>	<i>Ins.Kontrollues</i>	<i>Pergj.Oper</i>	<i>D.Kontrolli</i>	<i>Dt.E.Rap.Perf</i>	<i>NR. Prot</i>	<i>Dt.Nj.Vleresim</i>
2019	MRM	9220	E.S	P.T	E.M	26.02.2020	Pa evaduar	Pa evaduar .mungon shkresa DRT
2021	A	2663	A.ZH	P.T	K.C		Pa evaduar	Pa evaduar .mungon shkresa DRT
2020	E.M.F	G4690		P.T	E.M	12.11.2020	Pa evaduar	Pa evaduar .mungon shkresa DRT
2021	F.B	G4672		P.T	E.M	18.04.2019	Pa evaduar	Pa evaduar .mungon shkresa DRT

2019	G.K	5510	E.S	P.T	E.M	24.10.2019	Pa evaduar	Pa evaduar .mungin shkresa DRT
2019	N.A	G4632		P.T	E.M	29.06.2021	Pa evaduar	Pa evaduar .mungon shkres DRT

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Si konkluzion nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit Tatimor në Terren z. P.T, Drejtori i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë z. E.M (për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020) dhe z.K.C per periudhen nga data 16.12.2020-13.09.2021 si dhe inspektorët.nëpunës përgjegjës të përmendur në tabelë nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 69 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*. dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44.2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”* Ngarkohen me përgjegjësi për moszbatim të detyrave funksionale në cilësinë e nënpunësit zyrtar të lartë që *“Menaxhon burimet e Drejtorisë Rajonale Tatimore për probleme që lidhen me zbatimin e detyrave të tjera të autorizuara nga legjislacioni dhe të kërkuara nga procedurat tatimore”* personat zyrtarë me detyra funksionale Drejtor të Drejtorisë Rajonale Korçë sipas nenit 4 pika 3 e Rregullore të Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2- Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020.

4-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave

3-Manuali i Kontrollit Tatimor.

3 Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

1- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë z. E.M për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020.

2- z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë per periudhën nga data 16.12.2020-13.09.2021.

3- z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

4- z. A.Zh në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

5- z. E.S në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

6- z. S.X në cilësinë e ish-inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

7- z. A.M në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

8- z. M.H në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

9- znj. D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 27.08.2020 deri 30.09.2021).

10- z. Th.T në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 05.08.2019 deri 14.08.2020).

11- z. J.S në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 01.01.2019 deri 30.09.2021).

❖ Te tjera gjate kësaj pike auditimi

Gjatë procedurave administrative të kryera nga grupi auditues në lidhje me verifikime në system të akteve të Njoftim.Vlerësimit dhe përputhshmërisë së akteve zyrtarë të përcjellë nga Drejtoria

Rajonale Tatimore Korçë në zbatim të nenit nenit 69 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*. dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”* u konstatua se ***Ne lidhje me Aktin e Njoftim Vlerësimit*** per detyrimet tatimore të llogaritura për subjektin *“E.M.F”* me NIPT K1 të datës 16.11.2020 me nr 10140 të gjeneruar nga sistemi C@TS u konstatua se për këtë subjekt kanë dalë fillimisht detyrime tatimore totale në shumën 64,596,268 lekë (*të cilat janë anuluar, gabim material në hedhje në sistem*) dhe pas shqyrtimit të observacionit të depozituar nga inspektori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor z. Gj.M sipas shkreses nr. 947/30, datë 01.12.2021 u trajtuan dhe u morën në konsideratë nga grupi auditues faktet dhe provat e paraqitura në observacion. Nga të dhenat e marra në mënyrë aposteriori nga sistemi C@TS u konstatua se Njoftim Vlerësimi i gjeneruar me nr. C0001169032 nga ky sistem për këtë program kontrolli rezultoi në shumën 0 lekë. Nga të dhënat e marra nga sistemi C@TS u konstatua se rezultati i shkeljeve tatimore të rezultuara në fund të periudhës së Program Kontrollit Përfundimtar me nr. 10140/1 prot datë 03.09.2020 të ushtruar në këtë subjekt rezultoi ***në shumën 139,458 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Shtetit. Në përfundim,*** rezultoi një mospërputhje ndërmjet rezultateve të detyrimeve tatimore të nxjerra në Aktin Administrativ të Njoftim Vlerësimit me nr. C0001169032, datë 17.11.2020 në shumën 0 lekë si dhe aktit të gjeneruar në Raportin Përfundimtar të Kontrollit në datën 16.11.2020 me nr.10140 prot., DRT Korçë në shumën 139,458 leke.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2-Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020.

3-Manuali i Kontrollit Tatimor.

4-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrisë të Financave.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

1- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën nga viti 2018 deri në periudhën 16.12.2020.

2- z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

3- z. Gj.M në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

Ne lidhje me Aktin e Njoftim Vlerësimit të subjektit *“E.M.F”* me NIPT K.. me aktivitet *“Tregtia e Mishit dhe produkteve të Mishit”* rezultoi se nga ana e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor z. K.B janë përgatitur dhe hedhur në sistemin C@TS dhe janë gjeneruar dy akte Njoftim/Vlerësimi për kontrollin e ushtruar për këtë subjekt sipas Programit të Kontrollit Tatimor të njoftuar me datën 05.11.2019 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

1- Akt Vlerësimi nr. 17342/4 Prot datë 28.04.2020 me vlerë të detyrimit tatimor 90,045 lekë

2-Akt Vlerësimi nr. 17342/5 prot datë 28.04.2020 me vlerë të detyrimit tatimor në shumën 58,940 lekë.

Nga sistemi C@TS rezultoi se rezultatet e Program Kontrollit Tatimor të ushtruar në këtë subjekt rezultojnë në shumën totale të mungësës së të ardhurave tatimore prej 148,987 lekë.

Në përfundim, Rezultoi një mospërputhje ligjore: *Ndërmjet rezultateve detyrimeve tatimore të nxjerra në Aktin Administrativ të Njoftim.Vlerësimit me nr. prot 17242.4 prot datë 28.04.2020 datë në shumën 90,045 lekë, Aktit administrativ të Njoftim.Vlerësimit nr. 17342.5 datë*

28.04.2020 në shumën 58,940 lekë me aktin e gjeneruar në Raportin Përfundimtar të Kontrollit në datën 21.04.2020 me nr. 17242.2 datë 18.02.2020

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2- Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020.

3-Manuali i Kontrollit Tatimor

4-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre :

1- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

3- z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

5- z. K.B në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

6- z. Th.T në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë (periudha 05.08.2019 deri 14.08.2020).

Për sa më sipër është mbajtur edhe Akt-Konstatimi nr. 6 datë 19.11.2021 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Titulli i gjetjes :	Moszbatimi i afateve kohore të evadimit të akteve administrative sipas përcaktimeve në legjislacionin tatimor.
Situata:	Nëpunësit e njësisë përgjegjëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk kanë respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin e fushës në lidhje me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ të njoftim kontrollit, në lidhje me afatet e evadimit të aktit administrative, të raportit paraprak të kontrollit, të raportit përfundimtar të kontrollit si dhe të njoftim vlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 <i>“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i> duke krijuar risk të lartë për të mbartur në vijim efekte administrative me pasoja në pavlefshmërinë ligjore të akteve të nxjerra nga kjo njësi.
Kriteri:	1-Neni 69, 81, 83 dhe 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” 2- Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdherin nr. 192 datë 12.08.2020. 3-Manuali i Kontrollit Tatimor 4-Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhërin nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave
Ndikimi.Efekti:	Rezulton risk i lartë për të mbartur në vijim efekte administrative me pasoja në vlefshmërinë ligjore të akteve të nxjerra nga njësi përgjegjëse si dhe në mbledhjen e të ardhurave tatimore.
Shkaku:	Mungesa e përvojës së zyrtarëve, mungesa e njohjes dhe e zbatimit të legjislacionit, mungesa e vlerësimit të çështjeve nga ana e tyre, mungesa e monitorimit të veprimtarisë së nëpunësve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Drejtuesit e njësisë përgjegjëse dhe nëpunësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë gjatë procedurave administrative të nxjerrjes dhe evadimit të akteve administrative, të respektojnë afatet ligjore të nxjerrjes së akteve me qëllim eliminimin e riskut në mosvlefshmërinë ligjore të akteve administrative të nxjerra nga kjo njësi përgjegjëse.
---------------------	---

2.3.2 Auditimi i procedurave tatimore në lidhje kontrollet e ushtruara nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit *“Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor”* u shqyrtua dokumentacioni si poshtë:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.
- Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.
- Rregullore e Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore miratuar me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave
- Planin e kontrolleve të plota dhe me rimbursim periudha 01.01.2019 -30.09.2021
- Ndarjen e subjekteve sipas NIPTeve për cdo inspektor për sektorin e kontrollit nga zyrat (urdhurat.shkresat e nxjerra nga Drejtoria Rajonale)
- Tabelat e qarkullimit të TVSH sipas xhiros dhe Qarkullimit sipas deklaratës së T.Fitimit për periudhën nën auditim
- Tabelën e importeve TVSH (Tatime - Doganë)

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë grupi i auditimit ka përgjendhur dosjet e kontrollit mbi bazë risku. Përzgjedhja konsistoi në parimin e respektimit të shqyrtimit të dosjeve për çdo Inspektor Kontrolli siaps kritereve bazë në lidhje me:

- 1- Kontrolle normale,
- 2- Kontrolle për rimbursim,
- 3- Xhiron (Të ardhurat pa TVSH për secilën nga vitet),
- 4- Norma e fitimit Vjetor Fitimit Bruto.të ardhura për secilin vit,
- 5- Zbulime gjatë kontrollit (TVSH Detyrime, TVSH Ulje gjendjes kreditore, TVSH Gjoha, Tatim Fitimi Detyrim, Tatim Fitimi Gjoha, Sigurime shoqërore Detyrime, Sigurime shoqërore Gjoha, Te ardhura personale Detyrime, Te ardhura personale Gjoha, Akciza Detyrime, Akciza Gjoha, Divident Detyrim, Divident Gjoha, Detyrime dhe gjoha të tjera përfshirë edhe taksat nacionale, Ulja e Humbje dhe shumat e rimbursimit të kërkuar dhe miratuar),
- 6- Sektori dhe lloji i aktivitetit të subjektit.

Sa më sipër, u përzgjedhën për auditim 40 dosjet fizike të raport kontrolleve nga 384 dosje në total. Nga auditimi i kryer, analizuar rast pas rasti u konstatua se:

1. Subjekti: “A.SH” SHPK, me NIPT K.. dhe aktivitet: Prodhim, Amballazhim i produkteve ushqimore, tregëtim i tyre, Import-Eksport i produkteve të ndryshme, bar restorant, Tregëtim me

pakice i karburanteve dhe lubrifikanteve te ndryshem, tregeti me pakice i gazit te lengeshem, sherbim hotelerie, sherbime ligjore per persona fizik dhe juridik.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori kontrollit: K.XH për:

1. TVSH për periudhën 05.2017 deri 06.2019.
2. Tatim Fitimi viti 2017-2018.
3. Sigurime shoqërore për periudhën 05.2017 deri 06.2019.
4. Tatime të tjera për periudhën 05.2017 deri 06.2019.

Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se:

- Nuk është bërë detajimi i aktiveve që zotëron shoqëria dhe ku të përcaktohet edhe orgjina e krijimit të tyre. Nuk është realizuar një analizë e detajuar në përlogaritjen e zërit të shpenzimeve të amortizimit, duke marrë në analizë AAGJ të shoqërisë për të cilat të jepte informacion mbi datën e hyrjes në shoqëri, vlerësimin fillestar në hyrje, normat e amortizimit, amortizimin e akumuluar etj.;
- Nuk është bërë ndarja dhe analiza e rentabilitetit të aktiviteteve të veçanta që ushtron kjo shoqëri. Ku nga objekti i aktivitetit të deklaruar në QKB rezulton se shoqëria ushtron shumë aktivitete të cilat janë të ndryshme për nga natyra dhe kërkojnë një trajtim dhe analizë të ndarë dhe të detajuar për aktivitetet e ndryshme.
Sipas QKB-së rezulton se fusha dhe objekti i aktivitetit është si më lart.
Është bërë analiza e kostos dhe janë verifikuar marzhet e cmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilacin material;
- Është mbajtur procesverbal i gjëndjes fizike të materiale në momentin e kontrollit, nga ku ka rezultuar se ka gjëndje inventar mallra për rishitje;
- Është mbajtur procesverbali i gjëndjes së arkës;
- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit;
- Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll;
- Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Shoqëria ka bërë gabime në llogaritjen dhe njohjen e shpenzimeve të amortizimit dhe për rrjedhojë inspektori duhet të bënte vlerësimin korrekt sipas kërkesave Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22 “Amortizimi”, më poshtë janë paraqitur veprimet llogaritëse të grupit të auditimit.

Tabela nr.16 Llogaritja e amortizimit viti 2017

(në lekë)

Emërtimi	Gjendje Fillim	Shtesa	Pakësime	Gjendja Fund	Amortizimi	Amortizimi ligji 8438 datë 28.12.1998	Amortizimi sipas Bilancit	Diferenca
Makineri e pajisje	5,819,802	2,015,821		7,835,623	20%	1,567,125	50,302	1,516,823
Rikarakterizim	5,819,802							1,536,541
Detyrim tatim fitimi								230,481.19
Gjobe tatim fitimi 21.9%								50,475
Detyrim TVSH								307,308
GjobeTVSH 21.9%								67,301
Totali detyrim 2017								655,565

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar K.L.SH

Tabela nr. 17 Llogaritja e amortizimit viti 2018

(në lekë)

Emërtimi	Gjendje Fillim	Shtesa	Pakësime	Diferenca lloga nga audituesi	Gjendja T2 rilloq	Amortizimi	Amortizimi ligji 8438 datë 28.12.1998	Amortizimi sipas Bilancit	Diferenca
Makineri e pajisje	7,785,321	3,386,811		1,516,823	9,655,309	20%	1,931,062	53,000	1,878,062
Totali asete	7,785,321	3,386,811		1,516,823	9,655,309		1,931,062	53,000	1,878,062
Rikarakterizim									1,889,330
Detyrim tatim fitimi									283,400
Gjore tatim fitimi 21.9%									62,064
Detyrim TVSH									377,866
Gjore TVSH 21.9%									82,753
Totali detyrim 2018									806,083

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Rezultoni se gjatë periudhës së kontrollit subjekti i ka amortizuar aktivet e shoqërisë me norma me të ulëta seç përcakton ligji konkretisht në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22 “Amortizimi”:

1. Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, amortizimi për aktivet e veprimtarisë llogariten nga:

a) pronari i aktiveve të veprimtarisë, në të gjithë rastet, përveç atyre të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni;

b) në rastet e aktiveve të dhëna me qira, me huapërdorje ose në një formë tjetër, të parashikuara me dispozita ligjore, nga personi që mbart riskun për humbjen apo shkatërrimin e aktivitetit.

2. Toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen;

3. Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind. (Ndryshuar me ligj nr. 10228, datë. 4.2.2010).

Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 3 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore. (Ndryshuar me Ligj nr. 156/2014, dt. 27.11.2014).

4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara, llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;

5. Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë:

a) Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte “software” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.

b) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.

Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore. (Ndryshuar me Ligj nr. 156.2014, dt. 27.11.2014. Botuar në FL.Z. nr. 195, dt. 24 dhjetor 2014.)

6. Në çdo kategori, të përshkruar në paragrafin e pestë të këtij neni, përqindja e amortizimit, e specifikuar në këtë pikë, zbatohet mbi bazën e amortizimit të kategorisë përkatëse.

7. Baza e amortizimit të jetë vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore:

a) duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë gjatë periudhës tatimore;

b) duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera, të pavullnetshme gjatë periudhës tatimore. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet fitimit të tatueshëm dhe baza e amortizimit merret zero. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5,000 lekë, e gjithë baza e amortizimit të jetë një shpenzim i zbritshëm veprimtarie.

Nga tabelat e mësipërme janë konstatuar diferenca të mëdha në shpenzimet e amortizimit të panjohura në pasqyrën e rezultatit financiar, për të cilat inspektori duhet të kishte bërë vlerësim alternativ sipas të drejtës që i jepet nga neni 71, germa òbö, neni 72, germa òaö dhe neni 115 i ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Pra, bazuar në sa më sipër duhet të ishte kryer rikarakterizim i shpenzimeve të amortizimit të pa përfshira në pasqyrën e performancës financiare, në të ardhura duke llogaritur dhe normën e fitimit për vitin 2017 në 1.3% dhe vitin 2018 në 0.6%, që shuma totale për të 2 vitet e shpenzimeve të amortizimit të ri-karakterizohen si të ardhura.

Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Në total nga grupi i auditimit janë konstatuar detyrime të munguara për tatim fitimin, TVSH-në dhe gjoba në vlerën 1,461,648 lekë, të pa trajtuara në dosjen e kontrollit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1.

Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3 dhe pika 5.

Shënim: Në të 40 dosjet e kontrollit të audituara nga grupi i Kontrollit të Lartë të Shtetit inspektorët, përgjegjësitet, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk kanë respektuar dispozitat e parashikuara në:

Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020. audituara Neni 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”.

Pika 1.

Neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësitet të sektorit të kontrollit në vend”.

Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8.

Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të drejtorisë së kontrollit tatimor në drejtoritë e tjera rajonale”

Pikat 2, 7.

Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.

Pikat 3, 10, 11, 18.

Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr. 1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrisë të Financave.

Manuali i Kontrollit Tatimor.

Formulari i dokumentimit të levizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale. (Inspektor, Përgjegjës Sektori, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që firmos dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i Drt-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën

përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nënpunësit, titullar si person që ka dëjuri dhe nënshkruan aktin administrative të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 16.12.2020.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.

z. K.XH në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

z. Th.T në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 05.08.2019 - 14.08.2020.

2. Subjekti: "A.SH.P.K" me NIPT K... dhe aktiviteti: Ndertimi i ndertesave rezidenciale dhe jo rezidenciale, Import export ,etj".

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori kontrollit: A.ZH për:

1. TVSH për periudhën 05.2019 deri 04.2021.
2. Tatim Fitimi viti 2019-2020.
3. Sigurime shoqërore për periudhën 05.2019 deri 04.2021.
4. Tatime të tjera për periudhën 05.2019 deri 04.2021.

Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se:

- Nuk është mbajtur procesverbali i gjendjes së arkës, rezulton gjendje e lartë e llogarisë òArkaò në vlerën 6,607,550 lekë në fund të vitit 2019 dhe 6,014,430 lekë në fund të vitit 2020. Ne zbatim te kerkesave te program kontrollit, si dhe ne zbatim te Ligjit 9920 datë 19.05.2008 òPer Procedurat Tatimore ne RSH-seò, si udhezimit të MF në zbatim të tij, nuk është verifikuar nëse subjekti ka kryer transaksione shitje apo blerje me para në dorë për shuma që tejkalojnë 150,000 lekë.
- Nuk është analizuar llogariaò Të drejta të arkëtueshme të tjeraò edhe pse sipas të dhënave të bilancit kontabël të vitit 2019 ky zë është në shumën 42,964,216 lekë ose 27% e totalit të aktiveve të shoqërisë dhe sipas të dhënave të bilancit kontabël të vitit 2020 kjo llogari është në vlerën 31,505,516 lekë ose 17% e totalit të aktivitetit të shoqërisë.
- Është bërë analiza e kostos dhe janë verifikuar marzhet e cmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilacin material.
- Është mbajtur procesverbal i gjendjes fizike të materialeve në momentin e kontrollit, nga ku ka rezultuar se ka gjendje inventar mallra për rishitje.
- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.
- Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.
- Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.

Nga verifikimi i llogarisë shpenzime amortizimi për periudhën 2020 rezulton se subjekti ka amortizuar aktivet materiale nën normën e lejuar për efekte fiskale në kundërshtim me pikën 3, dhe 5, nenin 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, Për tatimin mbi të ardhurat i Ndryshuar ò

3. *Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind.”*

5. *Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë:*

a) *Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte “software” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.*

b) *Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind. Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktivi, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore.*

Tabela nr. 18 Llogaritja e amortizimit viti 2020

(në lekë)

Emërtimi	Gjendje Fillim	Amortizim akumuluar	Gjendja Fund	Amortizimi	Amortizimi ligji 8438 datë 28.12.1998	Amortizimi sipas Bilancit	Diferenca
Toka	10,478,400		10,478,400			-	
Ndertesat	42,499,744		42,499,744	5%	2,124,987	1,500,000	624,987
Makineri e pajisje	839,450		839,450	20%	167,890		167,890
Mjete transporti	1,081,812		240,277	20%	48,055		48,055
Pajisje kompjuterike	219,360		219,360	25%	54,840	31,665	23,175
Pajisje zyre	240,277		240,277	20%	48,055		48,055
TOTALI	55,359,043		54,517,508		2,443,828	1,531,665	912,163

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Për vitin 2020, rezultoi se subjekti nuk ka pasqyruar shpenzimet për amortizimin e aktiveve materiale në shumën 912,163 lekë, e cila duke u indeksuar me normen e fitimit 5% të shoqërisë për periudhën 2020 shkon në vlerën 957,771 lekë.

Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 71, germa 0b, neni 72, germa 0a00 dhe neni 115, pika 1 *Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*, ku citohet *“Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”*, janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Tatim Fitimi 957,771 x 15 % = 143,666 lekë
 Gjobe TF..... 143,666 lekë x 0.06% x 365 dite = 31,463 lekë
 TVSH 957,771 x 20 % = 191,554 lekë
 Gjobe TVSH 191,554 lekë x 0.06% x 365 dite = 41,950 lekë
Shuma..... = 408,633 lekë

Në total nga grupi i auditimit janë konstatuar detyrime për tatim fitimin, TVSH-në dhe gjoba në vlerën **408,633** lekë, të pa trajtuara në dosjen e kontrollit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:
 Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 71, germa 0b, neni 72, germa 0a00 dhe neni 115, pika 1.
 Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, neni 22, pika 3 dhe pika 5.

Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020. Neni 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”.

Pika 1.

Neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit të kontrollit në vend”.

Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8.

Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të drejtorisë së kontrollit tatimor në drejtoritë e tjera rajonale”

Pikat 2, 7.

Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.

Pikat 3, 10, 11, 18.

Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrisë të Financave.

Manuali i Kontrollit Tatimor.

Formulari i dokumentimit të levizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale. (Inspektor, Përgjegjës Sektori, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që firmos dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i DRT-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nënpunësit titullar si person që ka detyrën dhe nënshkruan aktin administrativ të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

znj.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.

z. A.ZH në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

3. Subjekti: “E.M.F” SHPK me NIPT L... dhe aktiviteti: Tregëtimi me shumicë dhe pakicë, artikuj të ndryshëm etj

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori kontrollit Gj.M për:

1. TVSH për periudhën 09.2019 deri 06.2020.
2. Tatim Fitimi viti 2019.
3. Sigurime shoqërore për periudhën 09.2019 deri 06.2020. .
4. Tatime të tjera për periudhën 09.2019 deri 06.2020. . .

Nga verifikimi i llogarisë shpenzime amortizimi për periudhën 2019 rezulton se subjekti ka amortizuar aktivet materiale nën normën e lejuar për efekte fiskale në kundërshtim me pikën 3, dhe 5, nenin 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar ö

z. B.K në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

13. **Subjekti:** “E” SHPK me NIPT L. dhe aktiviteti: Import-eksport, tregtim me shumice i kafshëve të gjalla (Kërmilli) Import - eksport, tregti me shumice dhe pakice, depozitim të bimëve medicinale (mjekësore) Blerje, shitje, prodhim, përpunim, trajtim dhe import eksport të të gjitha produkteve bujqësore dhe ose nënprodukteve të tyre të të gjitha llojeve. Prodhim të produkteve me origjinë bimë dhe shtazore.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori A.H për:

2. Rimbursim TVSH: 03.2018 – 12.2018.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÒFormulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca I) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.
- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Akt-marrëveshjet me fermerët nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Situacionet me zërat përkatës për mirëmbajtje ndërtesë nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Nuk është bërë analizë e detajuar pse për punimet e mirëmbajtjes së ndërtesës nuk kërkohet leje ndërtimi sipas Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” dhe gjithashtu nuk ka lënë gjurmë mbi verifikimin korrekt të kësaj çështje.
- Nuk është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (billoqet) në momentin e kontrollit dhe nuk është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Korçë me numrat serial të përdorur (të regjistruar në librin e shitjeve).
- Nuk shprehet në lidhje me kasat fiskale të subjektit të audituar në raportet e kontrollit.

Formulari i dokumentimit të levizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale. (Inspektor, Përgjegjës Sektor, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që firmos dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i DRT-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nënpunësit titullar si person që ka detyrën dhe nënshkruan aktin administrativ të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. A.H në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë Korçë.

14. **Subjekti:** “E.K” SHPK me NIPT L. dhe aktiviteti: Prodhimi dhe tregtimi i konfeksioneve, qëndisje, stampime, qepje etj.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori K.R dhe I.S për:

1. *Rimbursim TVSH: 01.2018 – 10.2018.*

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca I) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit të hartuar nga inspektori K.R ku pjesë e punës ka qenë dhe Inxhinier I.S është konstatuar se subjekti “E” SHPK, ka kryer punime ndërtimi bazuar tek “Deklarata paraprake e kryerjes së punimeve” të miratuar me Vendimin Nr. 1033., datë 06.03.2018, të Këshillit Bashkiake Bashkia Korçë, bashkangjitur të cilit është edhe “Preventivi i punimeve”. Nga krahasimi i situacionit të punimeve me preventivin dalin diferenca në zëra dhe vlerë totale të punimeve gjë e cila përbën shkelje të deklaratës së kryerjes së punimeve të miratuar. Inspektori dhe Inxhinieri kanë kryer verifikimet dhe llogaritjet përkatëse por jo plotësisht sipas parashikimeve të nenit 20, pika 8, shkronja a, d e Udhëzimit Nr. 6., datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ku theksohet se:

8.b. Në çdo rast përse i përket ndërtimit por edhe çdo fushe tjetër të veprimtarisë, rregullat për qëllime të TVSH-së, si në këtë rast, përcaktohen për të rregulluar dhe sqaruar zbatimin e tatimit për një veprimtari të kryer bazuar në legjislacionin e fushës ku ushtrohet veprimtaria (p.sh. ndërtim, bankë, tregti, hidrokarbure) duke siguruar në çdo moment që çdo operacion, transaksion, furnizim, është kryer në përputhje me lejet, licencat, kërkesat, kriteret, etj.), të kërkuara sipas legjislacionit të fushës.

8.d. Për çdo punim në ndërtim të kryer në shkelje të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ose çdo punim të kryer përpara se leja përkatëse e kërkuar nga legjislacioni i fushës, të jetë lëshuar, personi i tatueshëm ndërtues është i detyruar të paguajë TVSH për pjesën e punimeve të kryera, por ndërkohë atij nuk i lejohet të zbresë TVSH-në për blerjet e kryera që i korrespondojnë situacioneve (pjesës së punimeve) në fjalë, përse për kryerjen e punimeve nuk janë respektuar kërkesat dhe dispozitat ligjore të fushës përkatëse. Nga ana tjetër investitorit të objektit, nëse e ka zbritur TVSH-në e punimeve të kryera prej personit të tatueshëm ndërtues, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse të punimeve të ndërtimit të kryera në kushtet e shkeljes.

Prandaj sipas gjykimit të grupit të auditimit për të qenë korrekt dhe në sinkron me parashtrimet e nenit të mësipërm, duhej që pjesa e TVSH-së së diferencës në vlerë midis situacionit të punimeve të paraqitura nga subjekti me preventivin e miratuar të mos njihet si TVSH kreditore subjektit dhe përveç këtij fakti të bëhet dhe penalizimi për “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” sipas përcaktimeve të nenit 115 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku citohet se:

“Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Llogaritjet e Grupit të Auditimit paraqiten më poshtë:

Vlera e Situacionit = 27,756,000 Lekë

Vlera e Preventivit = 11,400,262 Lekë

Diferenca = 16,355,738 Lekë

Ulje gjendjes kreditore të TVSH = 2,725,956 Lekë

Penaliteti (Gjobë 21.9%) = 596,984 Lekë

Totali = 3,322,940 Lekë.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.

z. K.R në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

z. I.S në cilësinë e nënpunësit me detyrë funksionale inxhinier pranë Drejtorisë Rajonale Korçë.

15. Subjekti: *“G.S” Sh.p.k. (Degw e shoqërisë së huaj) me NIPT L. dhe Aktiviteti: “Prodhimit të shuajve për këpucëve nën regjimin e përpunimit aktiv”.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori A.M për:

3. TVSH: 11.2018-07.2020.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, nën 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca I) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

-Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Bilanci material nuk është shoqëruar me analizën e harxhimit të materialeve sipas kartës teknologjike të prodhimit përse i përket pjesës së aktivitetit që shoqëria ushtron në fushën e prodhimit të shuajve për këpucë nën regjimin e përpunimit aktiv.

-Inspektori i dosjes nuk ka verifikuar me dokument justifikues marrëdhëniet me kontraktorët dhe nuk është analizuar çmimi i shitjes së deklaruar nga subjekti me çmimin e përcaktuar në kontratë me klientin.

- Në dosjen e kontrollit nuk rezultojnë autorizimet nga drejtoria e doganave për regjimin e përpunimit aktiv të këtij subjekti.

- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*billoqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Korçë me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo llojë produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është kryer zbërthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Është kryer analiza e TVSH-së, llogaritja e normës së TVSH-së dhe është kryer krahasimi me normën mesatare të subjekteve të ngjashme.
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

znj.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. A.M në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

16. **Subjekti:** “K-1” SHPK me NIPT J. dhe aktiviteti: “Tregti me shumice pakice artikuj të ndryshëm industriale, imp-eks, prodhim përpunim i letrës plastik, krijimin e impianteve për grumbullimin e mbetjeve të pa rrezikshme për qëllim riciklimi, seleksionimin, copëtimin mekanik, ambalazhimin dhe eksportimin e tyre. Prodhim, ambalazhim, etiketim dhe shitje me shumice dhe pakice e vajrave ushqimore, margarinës dhe yndyrave të tjera me origjinë bimore dhe shtazore, Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice të qumështit dhe nënprodukteve të tij, import - eksport i tyre. Grumbullimin e të gjitha mbetjeve të ricikloheshe si letër, plastikes, hekurit etj”.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori SH.XH për:

1. TVSH: 09.2018-09.2019.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të

përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (*Shtojca 1*) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Inspektori në raport me qëllim saktësimin e kreditimit të TVSH-së brenda normave të lejuara të përcaktuara sipas *Udhëzimit Nr. 6 datë 30.05.2015, i ndryshuar*, neni 55, nuk ka kryer analizën e harxhimit të naftës për secilin mjet transporti duke ju referuar rrugëve të përshkruara në bazë të normativa të subjektit. Në dosjen e rimbursimit dhe në sistemin C@ts nuk janë paraqitur normativat e konsumit të karburantit të subjektit.

- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.

- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.

- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*bllloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Korçë me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).

- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.

- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.

- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.

- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.

- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo llojë produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.

- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.

- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.

- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.

- Është kryer analiza e TVSH-së, llogaritja e normës së TVSH-së dhe është kryer krahasimi me normën mesatare të subjekteve të ngjashme.

- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. Th.T në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. S.X në cilësinë e ish inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

17. Subjekti: “M-T” SHPK me NIPT Jí dhe aktivitet: “Prodhimit të këpucëve për eksport me fason dhe tregtim mallrash industriale”.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

1. TVSH: 03.2017-12.2019.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

-Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Bilanci material nuk është shoqëruar me analizën e harxhimit të materialeve sipas kartës teknologjike të prodhimit përse i përket pjesës së aktivitetit që shoqëria ushtron në fushën e prodhimit.

-Inspektori i dosjes nuk ka verifikuar me dokument justifikues marrëdhëniet me kontraktorët, në dosjen e rimbursimit si dhe në sistemin C@ts nuk është paraqitur kontrata e lidhur me eksportuesin si dhe nuk është analizuar çmimi i shitjes së deklaruar nga subjekti me çmimin e përcaktuar në kontratë me klientin.

- Nuk është kërkuar informacion shkresor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të verifikuar deklaratat doganore.

- Në dosjen e kontrollit nuk rezultojnë autorizimet nga drejtoria e doganave për regjimin e përpunimit aktiv të këtij subjekti.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. Th.T në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 05.08.2019 - 14.08.2020.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. K.B në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

18. Subjekti: “M.E” SHPK me NIPT L. dhe Aktiviteti: Transport rrugor i pasagjereve me sistem urban. Agjenci e udhëtimit turistike për turiste, Transporti i udhëtareve dhe mallrave, agjenci udhëtimesh brenda dhe jashtë vendit, tregti me shumice e pakice të artikujve ushqimorë dhe industriale, tregti me shumice e pakice të mjeteve të ndryshme si auto-vetura dhe autobusë, pjese këmbimi për to, karburante e vajrave lubrifikante. Dhënia e mjeteve të transportit me qera”

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

4. TVSH: 02.2019-09.2019.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Inspektori në raport është shprehur se për analizimin e normativave të konsumit të karburantit ka përdorur normativat e paraqitura nga subjekti, të cilat nuk rezultojnë në dosjen e kontrollit dhe

nuk janë paraqitur në Drt Korçë, të detajuara për secilin mjet sipas inventarit të autobusëve në përdorim për transport ndërkombëtar.

- Drt Korçë nuk ka kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Korçë për subjektin "M.E" me NIPT L. në lidhje me:

a. Daljet nëpërmjet pikës Doganore Kapshticë sipas linjave që ka disponuar të ndara për çdo automjet sipas targave të autobusave të rregjistruar në sistem

b. Numrin total të pasagjerëve për çdo dalje.

- Rezulton se inspektori ka saktësuar shumë kreditorë e TVSH-së së krijuar pa konfirmuar të dhënat e numrit të hyrje-daljeve të autobusave dhe numri i pasagjerëve nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Korçë në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" ku citohet, "Detyrimi i të tretëve për të dhënë informacion" ku citohet "Me kërkesën e administratës tatimore, palët e treta japin informacion, me shkrim ose me gojë, vënë në dispozicion librat dhe regjistrimet, si dhe informacion tjetër për detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, me të cilin ata kanë hyrë në transaksione tregtare ose financiare".

- Kur tatimpaguesi ose një palë e tretë nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas këtij kreu, administrata tatimore mund të ushtrojë autoritetin e vet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe 62 "Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion".

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. Th.T në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 05.08.2019 - 14.08.2020.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. A.ZH në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

19. *Subjekti: "M.H.C" SHPK dhe Aktiviteti: Ndërtim, instalim, shfrytëzim i centraleve elektrike, import-eksport, prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim me energji elektrike dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektorët K.XH dhe I.S për:

5. *Rimbursim TVSH: 06.2018 – 08.2019.*

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Nga auditimi është konstatuar se kontrata fillestare koncesionare midis subjektit është lidhur në 30.01.2008. Subjekti është pajisur me leje zhvillimore komplekse Nr. 6839.1., datë 26.02.2014 për ndërtimin e Hidrocentralit miratuar me Vendim Nr. 7., datë 10.05.2013. **Afati kohor i përfundimit të punimeve sipas kontratës fillestare të koncesionit është 12 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.** Nëpërmjet shkresës Nr. 11., Prot, datë 06.11.2017 që Shoqëria "AL" SHPK i dërgon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ku i kërkohet miratimi i transferimit të 100%

të kuotave të shoqërisë koncesionare favor të shoqërisë "A.L." Sh.p.k. Me anë të shkresës Nr. 1583.1., Prot, datë 24.11.2017 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është kthyer përgjigje për miratimin e kuotave me kushtin që të ruhet emri i Koncesionarit si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e koncesionit midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, në të kundërt marrëveshja është e pavlefshme. Më datë 30.05.2018 është bërë shtesa e kontratës e cila është lidhur midis Shoqërisë dhe Autoritetit Kontraktues që është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Rezulton se shtesa e kontratës nuk është lidhur midis Shoqërisë, i cili ka kërkuar rimbursimin e TVSH për punimet e kryera, por midis Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë Aí , e cila dhe pse zotëron 100% të kuotave të kompanisë koncesionare është entitet juridik i ndryshëm nga koncesionari.

Për t'u theksuar është fakti se sipas shkresës nr. 06.11 prot., datë 12.09.2019 të AKBN-së drejtuar DPT-së dhe aneksit bashkëlidhur, ku theksohet se për rastin në fjalë punimet kanë filluar në datën 05.09.2013 gjë që është para datës së miratimit të lejes zhvillimore 26.02.2014. Për vlerën e punimeve që i takojnë periudhave nga 05.09.2013 deri në 26.02.2014 e cila është përpara datës së miratimit të lejes dhe në kundërshtim me pikat 8.a, 8.b dhe 8.d të nenit 20 të Udhëzimit Nr. 6 "Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nuk duhet të njihet TVSH-kreditore dhe rimbursimi i saj.

Sipas raportit të inspektorit të kontrollit theksohet se vlera e investuar në objekt gjatë periudhës Qershor 2018-Gusht 2019 nxjerrë sipas faturave (Nuk ka vendosur në dispozicion faturat dhe situacionet përkatëse) është 198,691,586.4 lekë nga të cilat: 153,116,112.4 lekë "Punime Ndërtimi", 43,399,746 lekë "Makineri dhe Pajisje" dhe 2,175,998 lekë "Studim, projektim, mbikëqyrje dhe analiza laboratorike" etj. Vlera e përgjithshme e investuar në subjekt nga fillimi i punimeve prej 05.09.2013 deri tani nuk është e saktësuar mbasi subjekti ka dhënë informacion vetëm për periudhën e kontrollit. Gjithashtu theksohet se punimet në HEC kanë filluar në datën 05.09.2013, kjo e vërtetuar nga "Proces-verbali mbi fillimin e punimeve" dhe "Akt-Piketimi" që mbajnë respektivisht data 05.09.2013 dhe 06.09.2013 deri në datë 22.04.2014 kanë qenë kryer 1,414,236 lek.

Nga sa më sipër verifikohet se punimet e ndërtimit të hidrocentralit janë në tejkalim të afatit të lejes së ndërtimit të miratuar dhe për rrjedhojë edhe kreditimi i TVSH-së për këto punime nuk duhet të kryhet në favor të këtij subjekti. Inspektori i kontrollit i ka certifikuar gjithë shumën që subjekti ka kërkuar për rimbursim TVSH-je në vlerën **34,578,013 lek**. Veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit Nr. 6 "Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikat:

8.a. Rastet e mësipërme janë ilustruese të situatave të ndryshme në ndërtim, por nuk janë shteruese.

8.b. Në çdo rast përsa i përket ndërtimit por edhe çdo fushe tjetër të veprimtarisë, rregullat për qëllime të TVSH-së, si në këtë rast, përcaktohen për të rregulluar dhe sqaruar zbatimin e tatimit për një veprimtari të kryer bazuar në legjislacionin e fushës ku ushtrohet veprimtaria (p.sh. ndërtim, bankë, tregti, hidrokarbure) duke siguruar në çdo moment që çdo operacion, transaksion, furnizim, është kryer në përputhje me lejet, licencat, kërkesat, kriteret, etj.), të kërkuara sipas legjislacionit të fushës.

8.d. Për çdo punim në ndërtim të kryer në shkelje të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ose çdo punim të kryer përpara se leja përkatëse e kërkuar nga legjislacioni i fushës, të jetë lëshuar, personi i tatueshëm ndërtues është i detyruar të paguajë TVSH për pjesën e punimeve të kryera, por ndërkohë atij nuk i lejohet të zbresë TVSH-në për blerjet e kryera që i korrespondojnë situacioneve (pjesës së punimeve) në fjalë, përsa për kryerjen e punimeve nuk janë respektuar kërkesat dhe dispozitat ligjore të fushës përkatëse. Nga ana tjetër

investitorit të objektit, nëse e ka zbritur TVSH-në e punimeve të kryera prej personit të tatueshëm ndërtues, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse të punimeve të ndërtimit të kryera në kushtet e shkeljes.

Subjektit nuk duhet ti njihej TVSH-ja kreditore dhe ti bëhej ulje e tepricës kreditore të TVSH gjithashtu duhet të penalizohet për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore sipas nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, ku të përcaktohet se: *Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.*

Ulje e tepricës kreditore të TVSH = 34,578,013 lekë.

*Gjobë TVSH (34,578,013 lekë * 0.06% * 365 ditë) = 7,572,585 lekë.*

Total Detyrim 42,150,598 lekë

Për t’u theksuar është edhe fakti se sipas shkresës Nr. 06.11 prot., datë 12.09.2019 të AKBN-së drejtuar DPT-së dhe aneksit bashkëlidhur, ku theksohet se për rastin në fjalë punimet kanë filluar në datën 05.09.2013 gjë që është para datës së miratimit të lejes zhvillimore 26.02.2014. Për vlerën e punimeve që i takojnë periudhave nga 05.09.2013 deri në 26.02.2014 e cila është përpara datës së miratimit të lejes dhe në kundërshtim me pikat 8.a, 8.b dhe 8.d të nenit 20 të Udhëzimit Nr. 6 “Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk duhet të njihet TVSH-kreditore dhe rimbursimi i saj.

Dhe ku afati kohor i kësaj leje përcaktohet sipas kontratës së koncesionit në fuqi. Nisur nga ky fakt rezulton se subjekti është në shkelje të afateve të cilat janë të përcaktuara në kontratë në nenin 7 “Programi i Punimeve” të saj, ku më konkretisht përcaktohet se:

Nga auditimi është konstatuar se subjekti është pajisur me leje zhvillimore komplekse” në vitin 2014 dhe ku afati kohor i kësaj leje përcaktohet sipas kontratës së koncesionit në fuqi. Nisur nga ky fakt rezulton se subjekti është në shkelje të afateve të cilat janë të përcaktuara në kontratë në nenin 7 “Programi i Punimeve” të saj, ku më konkretisht përcaktohet se:

7.1 Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës sipas aneksit bashkëlidhur.

7.2 Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Gjithashtu sipas nenit 18 “Sanksionet” të kontratës përcaktohet se: Mosrespektim i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate në përfundim të periudhës 15 mujore penalizon koncesionarin sa mëposhtë:

18.1 Për shkelje të afatit të ndërtimi 0.05% në ditë të vlerës së investimeve të munguara.

18.2 Për mos kryerje të investimeve për vlerën e marr përsipër në konkurrim, koncesionari penalizohet me 10% të vlerës së investimeve të përealizuara.

18.3 Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10,000 lek.

18.4 Në rast mosrealizimi për faj të koncesionarit të prodhimit të energjisë elektrike prej 1,340,000 milion KËh.vit, koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të përealizuar për periudhën raportuese.

18.5 Për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga koncesionari, ai do të penalizohet me 10% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

18.6 Nëse mosrealizimi i fuqisë së vendosur është më shumë se 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga koncesionari, autoriteti kontraktues ka të drejt të prish kontratën në mënyrë të njëanshme.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. Th.T në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 05.08.2019 - 14.08.2020 .

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. K.XH në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

z. Ii.s në cilësinë e nënpunësit me detyrë funksionale inxhinier pranë Drejtorisë Rajonale Korçë.

20. Subjekti: “P.P” SHPK dhe aktivitet: Prodhimin e materialeve dhe objekteve plastike të çdo lloji. Tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve plastike, i lendes se pare për prodhimin e materialeve plastike të çdo lloji, përpunimi i tyre dhe shitja me shumice e pakice e materialeve dhe elementeve plastike te përpunuar për të tretet, importimi, eksportimi, tranzitimi me shumice e pakice i lendes se pare apo i materialeve apo i materialeve të përpunuar plastike. Në fushën e bujqësisë: Mbjellja e drithërave, perimeve, frutave, luleve, fidanishteve, frutave me lëvozhge, farave dhe kulturave te tjera. Ne fushën e blegtorisë: Rritja e gjedheve, derrave, shpendëve e kafshëve te tjera, prodhimi dhe përpunimi i qumështit ne ferma. Në fushën e materialeve të ndërtimit: Prodhimi, përpunimi e shitja me shumice e materialeve te ndryshme të ndërtimit, importimi dhe eksportimi i tyre.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori L.B për:

1. Rimbursim TVSH: 06.2017 – 10.2017.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Nga auditimi rezulton se subjekti kryen aktivitete të “Prodhimin e materialeve dhe objekteve plastike të çdo lloji. Tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve plastike, i lendes se pare për prodhimin e materialeve plastike të çdo lloji, përpunimi i tyre dhe shitja me shumice e pakice e materialeve dhe elementeve plastike te përpunuar për të tretet, importimi, eksportimi, tranzitimi me shumice e pakice i lendes se pare apo i materialeve apo i materialeve të përpunuar plastike etj”, sipas përshtimit të fushës së aktivitetit të përcaktuar në QKB, rrjedhimisht është subjekt i taksës së ambalazhit (TAM) siç përcaktohet nga legjislacioni i poshtë cituar:

Rezulton se me **ligjin nr. 178.2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008** òPër taksat kombëtareò i ndryshuar neni 2 përcaktohet se:

Ambalazh është çdo material paketues që shërben për paketimin e produkteve i cili e mbulon pjesërisht apo tërësisht atë.

Neni 8 përcakton se:

Taksa e materialeve.artikujve plastikë dhe e ambalazheve prej plastike.qelqi. 8.1. Materiale.artikuj plastikë konsiderohen mallrat e importuara sipas kapitullit 39 të NKM-së. 8.2. Ambalazh plastik.qelqi është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe.ose vlerën e tij dhe që e 3 bëjnë të përshtatshëm

për transport, tregtim dhe përdorim. Taksa e Ambalazhit plastik **TAM** llogaritet në **shumën 100 lek/kg.**

Neni i Udhëzimit nr 2 datë 17.01.2014

Pika 2.8.5 përcakton se “Për mallrat me ambalazhe plastike apo qelqi, të prodhuara në vend, TAM do të paguhet në momentin e shitjes së mallrave, me faturë tatimore. Për efekt pagese, subjekti prodhues do të ndajë në faturën tatimore çdo shitje të mallrave sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit”.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh plastik apo qelqi, furnizohen nga subjekte që importojnë apo prodhojnë këto ambalazhe, kërkojnë nga prodhuesi apo importuesi, krahas faturës tatimore, dhe pagesën e TAM në organet tatimore apo doganore. Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh plastik apo qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë për të tretë, do të paguajnë TAM për sasinë e shitur me faturë tatimore.

Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve të plastikës dhe të qelqit, boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve boshe, në fund të çdo muaji do të deklarojnë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar. Në rast të kundërt, organet tatimore do të llogarisin TAM-in e këtyre ambalazheve për të gjitha shitjet e kryera për çdo muaj.

Pika 2.8.6 Të gjitha subjektet prodhuese të ambalazheve të plastikës dhe të qelqit duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale ku janë regjistruar, këto dokumente:

- a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës, për prodhimin e produkteve njëpërdorimshme të plastikës dhe të qelqit;
- b) Kopje të kartës teknologjike të prodhimit.

Çdo ndryshim i kartës teknologjike duhet t’u njoftohet organit tatimor një muaj përpara.

Bazuar në nenin 5 “Agjentet e Taksave“ të Ligjit nr. 178/2013 “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”.

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e taksën së materialeve/artikujve plastikë dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi ngarkohen **Administrata Tatimore**, në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi dhe plastike.

Bazuar në nenin 10 “Shkeljet dhe sanksionet” të Ligjit nr. 178.2013 “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” përcaktohet se:

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Nga grupi i auditimit është bërë analiza e raportit përfundimtar të kontrollit duke nxjerrë peshën dhe sasinë e “Granulatit” që është futur në proces prodhimi për të prodhuara produktin “Ambalazh” të llojeve të ndryshme të listuara në tabelën e mëposhtme, për të cilat është llogaritur edhe detyrimi përkatës sipas bazës ligjore të sipër cituar.

Tabela nr.32 Taksa kombëtare e ambalazhit

(në lekë)

Nr	Ambalazh	Njësia.cop	Sasi.K	Taksa Kombëtare	Detyrimi	Sanksioni	Totali
----	----------	------------	--------	-----------------	----------	-----------	--------

		<i>e</i>	<i>g</i>				
1	Ambalazh 0.3 L	17,900	394	100 lek.kg	39,400	39,400	78,800
2	Ambalazh 0.5 L	1,900	44	100 lek.kg	4,400	4,400	8,800
3	Ambalazh 0.75 L	500	20	100 lek.kg	2,000	2,000	4,000
4	Ambalazh 1 L	7,200	389	100 lek.kg	38,900	38,900	77,800
5	Ambalazh 13Litra	12,100	8,833	100 lek.kg	883,300	883,300	1,766,600
6	Ambalazh 3 Litra	5,400	1,031	100 lek.kg	103,100	103,100	206,200
7	Ambalazh 4 litra	600	114	100 lek.kg	11,400	11,400	22,800
8	Ambalazh 5 litra	6,700	1,206	100 lek.kg	120,600	120,600	241,200
Totali					1,203,100	1,203,100	2,406,200

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Rezultoni se Inspektori i Kontrollit nga zyra nuk ka kryer verifikimin e pagesës së taksës kombëtare të ambalazhit sipas përcaktimeve të ligjit nr. **178.2013 “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare për artikullin ambalazh plastik , gjatë shitjeve të kryera nga ky subjekt për periudhën e specifikuar në dosjen e program kontrollit, për të cilën nuk është evidentuar pagesa e kësaj takse.**

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 16.12.2020 .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.

z. L.M në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

znj. O.C në cilësinë e inpektorit të kontrollit nga Zyra të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

21. *Subjekti: “S” Sh.p.k. dhe Aktivitet: “Transport rrugor i pasagjereve me sistem urban.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori Gj.M për:

1. TVSH: 01.2018-12.2018.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca I) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Inspektori në raport është shprehur se për analizimin e normativave të konsumit të karburantit ka përdorur normativat e paraqitura nga subjekti, të cilat nuk rezultojnë të protokolluara në DRT Korçë, të detajuara për secilin mjet sipas inventarit të autobusëve në përdorim për transport ndërkombëtar.

- DRT Korçë me shkresat nr 6778.1 prot., nr 6778.2 prot., datë 15.05.2019 në zbatim të Njoftimit për kontroll Tatimor me nr 6778 prot datë 26.04.2019, dhe në mbështetje të nenit 61 “Detyrimi i të tretëve për të dhënë informacion” dhe 62 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ÷ i ndryshuar ka kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Korçë për subjektin ÷Sö me NIPT I. në lidhje me

a. Daljet nëpërmjet pikës Doganore Kapshticë sipas linjave që ka disponuar të ndara për çdo automjet sipas targave të autobuzave të rregjistruar në sistem

b. Numrin total të pasagjerëve për çdo dalje.

- Rezulton se shkresa është dërguar në datën 15.05.2019, pra pas datës së kryerjes së kontrollit në terren (kontrolli në ambientet e shoqërisë sipas programit të kontrollit nga data 03.05.2019 deri në 13.05.2019), si dhe është saktësuar shuma kreditore e TVSH-së së krijuar në vlerën 14,070,342 lekë pa konfirmuar të dhënat e numrit të hyrje-daljeve të autobuzave dhe numri i pasagjerëve nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Korçë, në kundërshtim me nenin 61 0Detyrimi i të tretëve për të dhënë informacionë ku citohet “Me kërkesën e administratës tatimore, palët e treta japin informacion, me shkrim ose me gojë, vënë në dispozicion librat dhe regjistrimet, si dhe informacion tjetër për detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, me të cilin ata kanë hyrë në transaksione tregtare ose financiare.

- Kur tatimpaguesi ose një palë e tretë nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas këtij kreu, administrata tatimore mund të ushtrojë autoritetin e vet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe 62 “Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion” të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. Gj.M në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

22. Subjekti: “S” SHPK me Aktiviteti: Prodhim për llogari të saj si dhe për të treta (FASON)
Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori E.S për:

1. Rimbursim TVSH: 11.2017 – 12.2018.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Nga kontrolli i dosjes së kontrollit dhe shqyrtimi i informacionit të QKB-së, rezulton se shoqëria “S”, regjistrua me seli në Australias, 6, 3017, Lemosos, Qipro (Vend i cili sipas përcaktimeve të udhëzuesve të OECD-së është i ngjashëm me “parajsat fiskale” dhe transaksionet me kompani që selitë qëndrore i kanë në këtë vend duhet të kenë monitorim më të kujdesshëm) zotëron 100% të kuotave të shoqërisë 0S0 SHPK. Bazuar tek pika A. Pjesa e parë ó Procedurat Verifikuese e programit të kontrollit ku përcaktohet qartë se nga ana e inspektorit të kontrollit duhet të ishte realizuar “Procedura verifikuese në lidhje me formën juridike dhe kapitalin, krahasimi me kërkesat e ligjit të shoqërive tregtare për këtë qëllim”.

Transaksionet kryesore tregtare (Importet dhe Eksportet) janë drejt kompanisë “St. S.A”, Shoqëri Anonime Industriale e Tregtare e veshjeve për fëmije dhe llojeve të ngjashme” me qendër në Greqi. Shoqëria “St. S.Aö, ka zotëruar 100% të kuotave të shoqërisë 0S0 SHPK të cilat i ka transferuar tek shoqëria “S” në vitin 2010.

Administratori aktual i shoqërisë 0S0 SHPK është Z. A ka qenë administrator i shoqërisë “S S.Aö deri në vitin 2010 kur është bërë transferimi i kuotave tek shoqëria 0S0, dhe me të cilën siç është cituar edhe më sipër ka pjesën më të madhe të transaksioneve tregtare (import-eksport).

Nga auditimi dhe nga faktet e parashtruara më sipër rezulton se nga inspektori i kontrollit nuk janë bërë verifikimet përkatëse që përcaktohen në raste të tilla në Ligjin Nr. 42.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i

Ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, Datë 18.6.2014 “Për Transferimin e Çmimit”, për të përcaktuar nqs kemi të bëjmë me transaksione midis palëve të lidhura, të verifikojë nqs transaksionet janë në përputhje me “Parimin e Tregut”, sikur ato transaksione të ndodhnin midis dy palëve të pa lidhura në kushte normale tregu.

Inspektori i kontrollit nuk ka bërë analizën e firove, humbjeve, dëmtimeve dhe skarcove gjatë procesit të prodhimit dhe nuk ka marr në shqyrtim kartën teknologjike sipas së cilës është i organizuar procesi i punës së subjektit. Veprime këto jo në përputhje me nenin 60 “*Trajtimi fiskal i firove.humbjeve gjate procesit të prodhimit, magazinimit, transportit*”, të Udhëzim Nr. 6 Datë 30.01.2015 “*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*” dhe VKM Nr. 434 datë 20.5.2015 “*Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale*”.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.S në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

23. *Subjekti: “A.O” me Aktiviteti: Baxho. Grumbullim, përpunim, tregtimi, importi dhe exporti i qumështit dhe nënprodukteve te tij. Mbledhja, përpunimi, tregtimi dhe importi i ullinjëve dhe nënprodukteve.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori J.A për:

6. TVSH: 01.2019 - 03.2021.

7. Tatimi Fitimi: 2018 – 2020.

8. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 01.2019 - 03.2021.

9. Tatime të tjera: Deri 03.2021.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.
- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga Drt Korçë me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.

- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo llojë produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. K.C në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.

z. J.A në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

znj.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

24. *Subjekti: “A” SHPK me Aktiviteti: Rritje zogj pula për mish, shitje mish, import zogj, pula dhe koncentrat. Përpunim i ushqimit për shpendë. Prodhim (çelje zogjsh) 24 orësh për mish brolier. Prodhim të produkteve bujqësore.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori J.A për:

1. *TVSH: 07.2018 – 07.2020.*
2. *Tatimi Fitimi: 2018-2019.*
3. *Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 07.2018 – 07.2020.*
4. *Tatime të tjera: 07.2018 – 07.2020.*

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca I) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

-Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.

- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.

- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.

- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (bllloqet) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Korçë me numrat serial të përdorur (të regjistruar në librin e shitjeve).

2. *Kur një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi.transaksioni **rikarakterizohet** dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore. (Ndryshuar me Ligj 97.2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)*

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. *Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:*

a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;

b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta;

c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjerë;

ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (Ndryshuar me Ligj nr. 164.2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur. 3. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrisë të Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj nr. 164.2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014).

Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”, pika 1) ku përcaktohet se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me **0,06 përqind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Tabela nr. 38 Llogaritja e amortizimit viti 2020

(në lekë)

Viti	Emërtimi	Gjendje Fillim	Shtesa	Pakësime	Gjendja Fund	Amortizimi	Amortizimi sipas Bilancit	Diferenca
2020	Makineri & Pajisje	788,000	-	-	788,000	157,600	20,000	-
2020	Të tjera	103,137	-	-	103,137	20,627		-
Total		891,137	-	-	891,137	178,227	20,000	158,227

Emërtimi Viti 2020	Vlera
Shpenzimi i amortimit llogaritur nga subjekti	20,000
Shpenzimi i amortizimit që duhet llogaritur sipas normativave ligjore	178,227
Shpenzime amortizimi të pallogaritura nga subjekti	158,227
Marzhi Bruto	109%
Rivlerësim të Ardhurash	172,467
Tatim Fitim	25,870
Gjobë Tatim Fitimi	5,666
TVSH	34,493.49
Gjobë TVSH	7,554.07
Total	73,583

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.39 Llogaritja e amortizimit viti 2019

(në lekë)

Viti	Emërtimi	Gjendje Fillim	Shtesa	Pakësime	Gjendja Fund	Amortizimi	Amortizimi sipas Bilancit	Diferenca
2019	Makineri & Pajisje	254,452			254,452	50,890	4,500	46,390
2019	Mjete Transporti	190,090	600,000		790,090	158,018	18,500	139,518
2019	Kompjuter	165,983			165,983	41,496	2,500	38,996
Total		610,525	600,000	-	1,210,525	250,404	25,500	224,904

Emërtimi Viti 2019	Vlera
Shpenzimi i amortimit llogaritur nga subjekti	25,500
Shpenzimi i amortizimit që duhet llogaritur sipas normativave ligjore	250,404
Shpenzime amortizimi të pallogaritura nga subjekti	224,904
Marzhi Bruto	111%

Rivlerësim të Ardhurash	249,643
Tatim Fitim	37,447
Gjobë Tatim Fitimi	8,201
TVSH	49,928.69
Gjobë TVSH	10,934.38
Total	106,510

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

znj.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. A.L në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

33. Subjekti: ÷I.01"Sh.p.k me aktivitet: Ne fushën e tregtisë, Import-eksport tregti me shumice dhe pakicë të veshmbathjeve, materialë ndërtimi dhe pajisje elektroshtepiake

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori B.K për:

14. TVSH: 08.2016-01.2019.

15. Tatimi Fitimi: 2016-2017.

16. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 08.2016-01.2019.

17. Tatime të tjera: 08.2016-01.2019.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.
- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Nuk është verifikuar me dokumentat justifikuese nëqoftëse pagat janë paguar me bankë.
- Është bërë analizë sipërfaqësore në përlllogaritjen e zërit të shpenzimeve të amortizimit, duke marrë në analizë AAGJ të shoqërisë për të cilat të jepte informacion mbi datën e hyrjes në shoqëri, vlerësimin fillestar në hyrje, normat e amortizimit, amortizimin e akumuluar etj.
- Nuk është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzimi i procesverbalit , nga ku rezulton nivel i lartë i gjendjes së arkës për vitin 2017 (Gjendja e arkës ne dt 31.12.2017 eshte per vlerën 19,181,980 lekë).
- Është mbajtur procesverbal i fuqisë punëtore ku është bërë verifikimi i fuqisë punëtore .
- Është bërë analiza e kostos dhe janë verifikuar marzhet e cmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilacin matrial.
- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.
- Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.

- Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll
- Është bërë inventarizimi i blloqeve tatimore.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. B.K në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

34. *Subjekti: “K.G” Sh.A me aktivitet: Tregtia me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori A.H për:

18. *TVSH: 08.2014- 01.2019.*

19. *Tatimi Fitimi: 2014-2018.*

20. *Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 10.2014 – 03.2019.*

21. *Tatime të tjera: 10.2014 – 03.2019.*

Nga auditimi i dosjes së kontrollit u konstatua se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.
- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Normativat e konsumit të karburantit nuk rezultojnë në DRT Korçë, të detajuara për secilin mjet sipas inventarit të mjeteve në përdorim.
- Në analizën e TVSH në lidhje me llogaritjen e normës së fitimit nuk është bërë krahasimi me normën mesatare të TVSH me subjekte të ngjashme.
- Nuk është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzimi i procesverbalit.
- Nuk është verifikuar me dokumentat justifikuese nëqoftëse pagat janë paguar me bankë.
- Është bërë analizë sipërfaqësore në përlllogaritjen e zërit të shpenzimeve të amortizimit, duke marrë në analizë AAGJ të shoqërisë për të cilat të jepte informacion mbi datën e hyrjes në shoqëri, vlerësimin fillestar në hyrje, normat e amortizimit, amortizimin e akumuluar etj.
- Është mbajtur procesverbal i fuqisë punëtore ku është bërë verifikimi i fuqisë punëtore .
- Është bërë analiza e kostos dhe janë verifikuar marzhet e çmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilancin matrial.
- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.
- Është bërë rakordimi i blerjeve faktike sipas faturave me deklaratimet e subjektit sipas FDP-ve ne STI.

Sipas sqarimit të Inspektorit të Kontrollit në raport theksohet se: *“Kapitali i nënshkruar i shoqërisë në shumën 25,000,000lekë, vjen i rritur nga viti i kaluar në vlerën 24,900,000 lekë pasi shoqëria për*

ketë periudhe ka bere zmadhim kapitali në këtë vlerë, me vendim te ortakeve të shoqërisë Nr. 2 datë 02.10.2014 sipas raportit të ekspertit kontabël të licencuar Z. dhe te depozituar ne QKB në datën 08.10.2014. Me anë të këtij raporti i është lënë detyrë shoqërisë qe ti reflektoje këto ndryshime ne pasqyrat financiare, por nga kontrolli i P.F rezultoi se shoqëria nuk i ka reflektuar këto ndryshime te cilat nuk kane ndikim ne rezultat. Për këto arsye nga ana e kontrollit do të aplikohet gjobë 10,000 lekë për mbajtje të gabuar të llogarive pa ndikim në rezultatin financiar sipas Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi te Ardhurat” i ndryshuar neni 32, pika 2.

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se: “Në bilancin e paraqitur në organet tatimore dhe të pasqyruar në sistemin C@ts rezulton se për vitin 2016 dhe 2017 kapitali i nënshkruar është 100.000 lekë. Analiza e inspektorit në raport kontrollin është bazuar në kapitalin 25.000.000 lekë për këto vite (pra bazuar në pasqyrat financiare të depozituara ne QKB). Konstatojmë se ka diferenca midis kapitalit të deklaruar në QKB dhe atij në tatime”. Kjo është një situatë ku nuk krijohet siguri mbi evidencat e mbledhura sepse nga konfirmimi nga burime të ndryshme dalin përfundime të ndryshme, gjë që e bën punën e inspektorit të kontrollit dhe analizat e tij jo të besueshme.

Në zërin “**Hua te tjera**” ku janë përfshirë hua të marra nga ortakët e shoqërisë, inspektori nuk ka kryer asnjë analizë të këtij zëri material, duke konstatuar se kjo llogari vjen e mbartur nga vitet e kaluara dhe se dokumentacioni me lidhje me këtë llogari është kontrolluar nga kontrollet e mëpareshme të Drt Korçë.

Në bazë të analizës së kryer nga grupi i kontrollit rezulton situata e mëposhtme:

Tabela nr.40 Analiza e llogarisë hua afatgjatë

		(në lekë)			
Nr.	PASIVET DHE KAPITALI	2014	2015	2016	2017
II	PASIVET AFATGJATA	91,958,612	62,451,683	75,905,331	75,905,632
	3.5.1 Huamarrje te tjera afat gjata	91,958,612	62,451,683	75,905,331	75,905,632
	3.5.2 Detyrime ndaj institucionit të kredisë				
	5.3. Kapitali aksionar	100,000	25,000,000	25,000,000	25,000,000

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Zëri i bilancit “**Huamarrje të tjera afat-gjata**” ka pësuar ndryshime si në vijim në vitin 2014 ka qenë në vlerën 91,958,612 lekë, në vitin 2015 62.451,683 lekë, në vitin 2017 ka përfunduar në vlerën 75,905,632 lekë. Nga ana e inspektorit nuk janë analizuar burimet dhe nëse janë llogaritur dhe paguar tatim për këto shuma parash që janë derdhur si huamarrje nga ortakët për shoqërinë. Nga ana e inspektorit gjithashtu nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me Ligjin Nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Në gjykimin e audituesve për efekte tatimore duhet te ishin llogaritur shpenzime interesi për pjesën e huasë që ortakut i ka dhënë shoqërisë me kushte normale tregu. Në bazë të nenit 131 “Mosshlyerja e kredisë” të Ligjit Nr. 9901, Datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, u citohet se:

1. Kur aksionari i jep hua shoqërisë, duke zbatuar kushte më pak të favorshme nga kushtet normale të tregut dhe nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, atëherë aksionari nuk ka të drejtë të kërkojë rikthimin e huasë, kur ky veprim do të kishte si pasojë reduktimin e kapitaleve të veta të shoqërisë, nën vlerën e kapitalit të saj minimal.

2. Nëse një i tretë i ka dhënë shoqërisë hua, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni dhe rikthimi i huasë është garantuar nga aksionari, atëherë i treti, në rastet kur shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, mund t'i kërkojë shoqërisë vetëm rikthimin e shumës, që nuk ka mundur ta ekzekutojë nga garancia e aksionarit.

3. Pikat 1 e 2 të këtij neni zbatohen edhe për veprimet e tjera të aksionarit apo palëve të treta, nëse, nga pikëpamja ekonomike, janë të ngjashme me marrëveshjet e huasë, të parashikuara në këto pika.

Nga analiza që i është bërë subjektit nuk jemi në kushtet kur kemi të bëjmë me gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë dhe nuk kemi të bëjmë me veprime të cilët do të reduktonin kapitalet e veta të shoqërisë, nën vlerën e kapitalit të saj minimal.

Në lidhje me këtë procedurë kontrolli të dosjes duhet të ishte bërë rikarakterizim i situatës duke llogaritur shpenzime interesi për huanë e ortakut sipas të drejtës që i jepet nga Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht pika:

b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;

c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;

dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore;

Neni 71.2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor”.

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;

b)veprimet.transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;

c) veprimet.transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;

ç) forma e veprimit.transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;

d) evidentohen elemente të veprimeve. transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim.transaksion apo një seri veprimesh. transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

2. Kur një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi.transaksioni **rikarakterizohet** dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore. (Ndryshuar me Ligj 97.2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

- a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;
- b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta;
- c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjerë;
- ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;**
- d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (Ndryshuar me Ligj nr. 164.2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.) 2. Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur. 3. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj nr. 164.2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Nga sa më sipër duhet të bërë rikarakterizimi i shpenzimeve të interesit të pa llogaritura nga ana e subjektit si të ardhura duke përdorur normën mesatare të huave ndaj subjekteve të publikuara nga Bankës së Shqipërisë. Për rivlerësimin e të ardhurave është përdorur edhe marzhi bruto i cili gjendet në llogaritjet dhe dokumentacionin e tatimpaguesit.

Ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit (Kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi nga KLSH), pra kjo do të thotë se rritje në të ardhura është e gjitha fitim.

Penalizmi i subjektit duhej të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, Neni 124, pika 1), ku përcaktohet qartë: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Tabela nr. 41 Analiza e llogarisë hua afatgjatë

(në lekë)

Viti	2014	2015	2016	2017
Shuma e Huasë	91,958,612	62,451,683	75,905,331	75,905,632
Vlera e pakontabilizuar si shpenzim	4,597,931	3,122,584	3,795,267	3,795,282
Marzhi Bruto	4.44%	4.37%	7.46%	4.61%
Rivlerësim të ardhurash	4,802,079	3,259,041	4,078,393	3,970,244
TVSH	960,416	651,808	815,679	794,049
Gjobë TVSH	960,416	651,808	815,679	794,049
Tatim Fitimi	720,312	488,856	611,759	595,537
Gjobë Tatim Fitimi	720,312	488,856	611,759	595,537
Detyrim Total	3,361,455	2,281,329	2,854,875	2,779,171

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:
Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre
 z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. A.H në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

35. *Subjekti: “K” SHPK me aktivitet: Tregti artikuj te ndryshëm ushqimor e cigare, eksport - import, te pijeve alkoolike dhe jo alkoolike , ushqimore dhe lendeve te para, makineri ndërtimi e pajisje bujqësore, industriale, transport mallra , materiale udhëtare tregtim i lendeve te para hidraulike , elektrike dhe pajisje elektroshtepiake. Ndërtime civile, industriale ,turistike ,bujqësore, rrugë -kanalizime, ujësjellësa, impiante te ndryshme, rikonstruksione e restaurimeve në fushën e ndërtimit etj Prodhim dhe tregtim birre dhe pije te ngjashme me lende te pare cereale të të gjitha llojeve*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori K.C për:

1. TVSH: 07.2016 – 10.2018.

2. Tatimi Fitimi: 2016-2018.

3. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 06.2016 – 10.2018.

4. Tatime të tjera: 06.2016 – 10.2018.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

- Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.

- Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.

- Është mbajtur procesverbal i fuqisë punëtore ku është bërë verifikimi i fuqisë punëtore .

- Është bërë analiza e kosos dhe janë verifikuar marzhet e çmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilancin matrial.

- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.

- Analiza e kosos së plotë të artikullit të shitur është bërë gabim sepse tek janë përfshirë të gjitha shpenzimet që ka bërë subjekti pa bërë një ndarje të saktë në qendra kostosh dhe shpenzimeve të cilat lidhen specifikisht me produktet.

Për vitin 2016 nga ana e inspektorit të dosjes së kontrollit është bërë përlllogaritja e kosos së mallrave të shitur e cila rezulton se nuk është e njëjtë por ka diferencë me vlerën e llogaritur nga grupi i auditimit, e cila paraqitet më poshtë:

Tabela nr.42 Analiza e kosos së mallrave të shitur vitur 2016

(në lekë)

<i>KMSH 2016</i>	
<i>Blerje Mallra</i>	83,042,982
<i>Gjendja T1</i>	17,115,129
<i>Gjendja T2</i>	-25,190,304
<i>Import Investime me 20%</i>	-115,761

Investime Vendas 20%	-908,708
Shpenzime te raportuara ne librin e blerjeve	-1,319,589
KMSH	72,623,749
Bilanci	73,420,033
Diferenca	-796,284

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Nga ku rezulton se shpenzimet e njohura në pasqyrën e performancës së subjektit janë më shumë me një diferencë prej 796,284 lekë. Veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 21 të Shpenzime të panjohura, shkronja 1) të ligjit Nr. 8483, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe sipas nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të ligjit Nr. 9920., datë 19.05.2008, i ndryshuar ku citohet qartë se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”. Detyrimet e subjektit përlllogariten si në vijim:

*Detyrim për Tatim Fitimin 796,284 lekë * 15% = 119,423 lekë*

*Penalitet në masën 0.06%.ditë * 119,284 lekë * 365 ditë = 26,158 lekë*

Totali i detyrimit = 145,600 lekë.

Nga ana e inspektorit të kontrollit në nuk janë kryer veprimet rregulluese në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit për vitet objekt kontrolli, por është vendosur penalitet në masën 10,000 lekë sipas nenit 32, pika 2 të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duke e trajtuar si mos mbajtje e rregullt e llogarive dhe pa ndikim në rezultatin financiar të subjektit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Neni 22 “Amortizimi”, pika 1), shkronja a), pika 2), pika 3), pika 4), pika 5) shkronja a) dhe b), pika 6) dhe pika 7) ku përcaktohet qartë se: 1) Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, amortizimi për aktivet e veprimtarisë llogariten nga:

a) pronari i aktiveve të veprimtarisë, në të gjithë rastet, përveç atyre të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni.

2) Toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, **nuk amortizohen;**

3. Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, **amortizohen vecmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind.**

4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara, llogaritet veç për secilin aktiv, sipas **metodës lineare, në masën 15 për qind.**

5. Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë:

a) Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte “software” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me **25 për qind.**

b) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me **20 për qind.**

Në lidhje me këtë procedurë kontrolli të dosjes duhet të ishte bërë rikarakterizim i situatës duke llogaritur shpenzime e amortizimit sipas të drejtës që i jepet nga Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht pika:

b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;

c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;

dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore;

Neni 71.2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor”.

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformatojnë parimet e ligjit tatimor;

b)veprimet.transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;

c) veprimet.transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;

ç) forma e veprimit.transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;

d) evidentohen elemente të veprimeve. transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim.transaksion apo një seri veprimesh. transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

2. Kur një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi.transaksioni **rikarakterizohet** dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore. (Ndryshuar me Ligj 97.2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;

Penalizmi i subjektit duhej të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 1) ku përcaktohet se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me **0,06 përqind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Tabela nr.43 Llogaritja e amortizimit viti 2016

(në lekë)

Viti	Emërtimi	Gjendje Fillim	Shtesa	Pakësi me	Gjendja Fund	Amortizimi	Amortizim i sipas Bilancit	Diferenca
2016	Makineri & Pajisje	8,599,072	750,000	-	9,349,072	1,869,814	790,659	1,079,155

Emërtimi.Viti 2016	Vlera
Shpenzimi i amortimit llogaritur nga subjekti	790,659
Shpenzimi i amortizimit që duhej llogaritur sipas normativave ligjore	1,869,814
Shpenzime amortizimi të pallogaritura nga subjekti	1,079,155
Marzhi Bruto	109%
Rivlerësim të Ardhurash	1,178,761
Tatim Fitim	176,814

Gjobë Tatim Fitimi	38,722
TVSH	235,752.20
Gjobë TVSH	51,629.73
Total	502,918

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr. 44 Llogaritja e amortizimit viti 2017

(në lekë)

Viti	Emërtimi	Gjendje Fillim	Shtesa	Pakësime	Gjendja Fund	Amortizimi	Amortizimi sipas Bilancit	Diferenca
2017	Makineri & Pajisje	8,558,413	809,295	-	9,367,708	1,873,542	158,132	1,715,410
	Mjete Transporti	431,562	130,000	-	561,562	112,312	97,146	15,166
	Kompjuter	39,904	-	-	39,904	9,976	7,981	1,995
Totali						1,995,830	263,259	1,732,571

Emërtimi.Viti 2016	Vlera
Shpenzimi i amortizimit llogaritur nga subjekti	263,259
Shpenzimi i amortizimit që duhej llogaritur sipas normativave ligjore	1,995,830
Shpenzime amortizimi të pallogaritura nga subjekti	1,732,571
Marzhi Bruto	110%
Rivlerësim të Ardhurash	1,900,630
Tatim Fitim	285,095
Gjobë Tatim Fitimi	62,436
TVSH	380,126.08
Gjobë TVSH	83,247.61
Total	810,904

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

- z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë
- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë .
- z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.
- z. K.C në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

36. Subjekti: “K.C” me aktivitet: “Tregtimi me shumicë e pakicë e fruta perimeve”.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori A.M për:

- 22. TVSH: 02.2017-03.2019.
- 23. Tatimi Fitimi: 2017-2018.
- 24. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 02.2017-03.2019.
- 25. Tatime të tjera: 02.2017-03.2019.

Nga auditimi i dosjes së kontrollit u konstatua se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.
- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Në analizën e TVSH në lidhje me llogaritjen e normës së fitimit nuk është bërë krahasimi me normën mesatare të TVSH me subjekte të ngjashme.
- Në analizën e llogarisë furnitorë nuk janë evidentuar furnitorët me NIPT-i
- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (bllloqet) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Korçë me numrat serial të përdorur (të regjistruar në librin e shitjeve).
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo llojë produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 16.12.2020 .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.

z. A.M në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë

37. Subjekti: “M.B” tregtar të materialeve të ndërtimit, servisit dhe transportit, magazinimin, marketing, frashingut si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër prodhues, shërbim tregtimi që vjen në rritje të shoqërisë import-eksport, ndërtim objekti.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori A.H për:

26. TVSH: 01.2014 – 10.2018.

27. Tatimi Fitimi: 2013 – 2017.

28. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 01.2014 – 10.2018.

29. Tatime të tjera: 01.2014 – 10.2018.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në analizën e TVSH në lidhje me llogaritjen e normës së fitimit nuk është bërë krahasimi me normën mesatare të TVSH me subjekte të ngjashme.
- Nuk është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzimi i procesverbalit. Rezulton gjendje e konsiderueshme e llogarisë òArkaò në fund të çdo periudhe të detajuara si më poshtë për të cilat inspektori nuk është shprehur.
- Nuk është verifikuar me dokumentat justifikuese nëqoftëse pagat janë paguar me bankë
- Është bërë analizë sipërfaqore në përlllogaritjen e zërit të shpenzimeve të amortizimit, duke marrë në analizë AAGJ të shoqërisë për të cilat të jepte informacion mbi datën e hyrjes në shoqëri, vlerësimin fillestar në hyrje, normat e amortizimit, amortizimin e akumuluar etj.
- Është mbajtur procesverbal i fuqisë punëtore ku është bërë verifikimi i fuqisë punëtore .
- Është bërë analiza e kostos dhe janë verifikuar marzhet e cmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilacin matrial.
- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.
- Është bërë rakordimi i blerjeve faktike sipas faturave me deklaratimet e subjektit sipas FDP-ve ne STI.

Në zërin “*Të pagueshme ndaj Ortakut*” ku janë përfshirë hua të marra nga ortakët e shoqërisë, inspektori nuk ka kryer asnjë analizë të këtij zëri material. Zëri i bilancit “*Të pagueshme ndaj Ortakut*” nuk ka pësuar ndryshime duke qëndruar konstante përgjatë viteve 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 ka qenë në vlerën 10,000,000 lekë. Nga ana e inspektorit nuk janë analizuar burimet dhe nëse janë llogaritur dhe paguar tatim për këto shuma parash që janë derdhur si huamarrje nga ortakët për shoqërinë. Nga ana e inspektorit gjithashtu nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me Ligjin Nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Tabela nr.45 Analiza e llogarisë të pagueshme ndaj ortakut

(në lekë)

Nr.	Pasivet dhe Kapitali	2013	2014	2015	2016	2017
1	<i>Të pagueshme ndaj Ortakut</i>	10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Në gjykimin e audituesve për efekte tatimore duhet të ishin llogaritur shpenzime interesi për pjesën e huasë që ortaku i ka dhënë shoqërisë me kushte normale tregu. Në bazë të nenit 131 “Mosshyerja e kredisë” të Ligjit Nr. 9901, Datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, u citohet se:

1. Kur aksionari i jep hua shoqërisë, duke zbatuar kushte më pak të favorshme nga kushtet normale të tregut dhe nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, atëherë aksionari nuk ka të drejtë të kërkojë rikthimin e huasë, kur ky veprim do të kishte si pasojë reduktimin e kapitaleve të veta të shoqërisë, nën vlerën e kapitalit të saj minimal.
2. Nëse një i tretë i ka dhënë shoqërisë hua, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni dhe rikthimi i huasë është garantuar nga aksionari, atëherë i tretë, në rastet kur shoqëria është në gjendjen e

paftësisë paguese, mund t'i kërkojë shoqërisë vetëm rikthimin e shumës, që nuk ka mundur ta ekzekutojë nga garancia e aksionarit.

3. Pikat 1 e 2 të këtij neni zbatohen edhe për veprimet e tjera të aksionarit apo palëve të treta, nëse, nga pikëpamja ekonomike, janë të ngjashme me marrëveshjet e huasë, të parashikuara në këto pika.

Nga analiza që i është bërë subjektit nuk jemi në kushtet kur kemi të bëjmë me gjendjen e paftësisë paguese të shoqërisë dhe nuk kemi të bëjmë me veprime të cilët do të reduktonin kapitalet e veta të shoqërisë, nën vlerën e kapitalit të saj minimal.

Në lidhje me këtë procedurë kontrolli të dosjes duhet të ishte bërë rikarakterizim i situatës duke llogaritur shpenzime interesi për huanë e ortakut sipas të drejtës që i jepet nga Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht pika:

b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;

c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;

dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore;

Neni 71.2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor”.

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

a) veprimet e ndërmarrë nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;

b) veprimet.transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;

c) veprimet.transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;

ç) forma e veprimit.transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;

d) evidentohen elemente të veprimeve. transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim.transaksion apo një seri veprimesh. transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

2. Kur një veprim.transaksion apo seri veprimesh.transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi.transaksioni **rikarakterizohet** dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore. (Ndryshuar me Ligj 97.2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;

b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta;

c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjerë;

ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (Ndryshuar me Ligj nr. 164.2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

2. Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind

nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur. 3. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrisë së Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj nr. 164.2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Nga sa më sipër duhet të bërë rikarakterizimi i shpenzimeve të interesit të pa llogaritura nga ana e subjektit si të ardhura duke përdorur normën mesatare të huave ndaj subjekteve të publikuara nga Bankës së Shqipërisë. Për rivlerësimin e të ardhurave është përdorur edhe marzhi bruto i cili gjendet në llogaritjet dhe dokumentacionin e tatimpaguesit.

Ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit (Kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi nga KLSH), pra kjo do të thotë se rritje në të ardhura është e gjitha fitim.

Penalizmi i subjektit duhej të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, Neni 124, pika 1), ku përcaktohet qartë: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Tabela nr.46 Analiza e llogarisë të pagueshme ndaj ortakut

(në lekë)

Viti	2014	2015	2016	2017
Shuma e Huasë	10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000
Vlera e pakontabilizuar si shpenzim (Interesi 5%)	500,000	500,000	500,000	500,000
Marzhi Bruto	195%	195%	159%	166%
Rivlerësim të ardhurash	975,000	975,000	795,000	830,000
TVSH	195,000	195,000	159,000	166,000
Gjobë TVSH	195,000	195,000	159,000	166,000
Tatim Fitimi	146,250	146,250	119,250	124,500
Gjobë Tatim Fitimi	146,250	146,250	119,250	124,500
Detyrim Total	682,500	682,500	556,500	581,000

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. A.H në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

38. Subjekti: “M.P.N” SHPK me aktivitet: Prodhimi i karrigeve metalike, i artikujve të tjerë metalike dhe i artikujve prej druri.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori L.B për:

1. TVSH: 01.2016-08.2018.
2. Tatimi Fitimi: 2015-2017.
3. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 01.2016 – 08.2018.
4. Tatime të tjera: 01.2016 – 08.2018.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.
- Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.
- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (blloqet) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Korçë me numrat serial të përdorur (të regjistruar në librin e shitjeve).
- Janë kryer procedurat verifikuese në lidhje Për tatimin mbi të ardhurat në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është bërë verifikimi i zbatimit të ligjit dhe standarteve të kontabilitetit.
- Është kryer verifikimi i llogarisë së ortakut dhe i detyrimeve ndaj të tretëve.
- Janë verifikuar dhe analizuar qarkullimi i parasë (Cash-Floë) dhe pasqyra e ndryshimit të kapitaleve si pjesë përbërëse.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Është kryer verifikimi i saktësisë së llogaritjes në zërin paga, sigurime shoqërore dhe likuidimit të detyrimeve mbi sigurimet shoqërore.
- Është verifikuar dhe kontrolluar shpërndarja e fitimit dhe përlllogaritjet dhe derdhjet e tatimeve përkatëse.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

z. J.S në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. P.T në cilësinë e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. L.B në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

39. *Subjekti: "N.A" SHPK me aktivitet: Projektim në përgjithësi dhe në veçanti: Planifikim strategjik. Projektimi infrastruktura. Projektimi i veprave dhe impianteve qytetare të çdo gjinie. Drejtimi i punimeve në realizimin e veprave e impianteve qytetare të çdo gjinie. Drejtimi i punimeve në realizimin e impianteve qytetare. (Vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori K.B për:

1. *TVSH: 05.2014 – 08.2020.*
2. *Tatimi Fitimi: 2014-2019.*
3. *Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 05.2014 – 08.2020.*
4. *Tatime të tjera: 05.2014 – 08.2020.*

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Nga kontrolli i raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se subjekti nuk është paraqitur për kontroll si dhe nuk ka bashkëpunuar për procesin e kontrollit. Kështu që inspektori i kontrollit mbasi ka ezauruar të gjitha hallkat dhe etapat e parashikuara nga ligji ka kërkuar miratimin e Drejtorit Rajonal për të përdorur metodat alternative të vlerësimit sipas parashikimeve të ligjit.

Sipas Inspektorit të kontrollit u munduan të kontaktohej me përfaqësuesin e subjektit edhe nëpërmjet numrit të telefonit të regjistruar në sistemin tatimor C@TS por rezultoi se është jashtë funksionit. Sipas inspektorit sqarohet se subjekti është njoftuar nga DRT Korçë për kontroll me njoftimin me nr. 658.1 prot dt.03.02.2021 dhe me nr. 658.3 prot dt.17.03.2021, njoftimet janë marrë nga subjekti pasi në DRT nga posta nuk janë kthyer. Sipas inspektorit është kryer edhe verifikimi në vend (*bashkangjitur raportit ka edhe foto*), ku rezultoi që subjekti nuk ushtron aktivitet dhe në ambientet e tij nuk është gjetur asnjë punonjës .Nga verifikimi në sistem ka figuruar se subjekti është pezulluar në dt.28.08.2020 dhe administratori Z. A.P është person i huaj. Duke mos pasur asnjë mundësi kontakti, inspektori ka kërkuar me shkresën Nr. 658.4.,prot dt.18.03.2021 në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçe informacion për këtë person dhe i është kthyer përgjigje që ky person nuk ka të regjistruara hyrje-dalje në sistemin òTIMSò. Gjithashtu inspektori me shkresën Nr. 658.6 prot dt.13.04.2021 është ri-njoftuar për detyrimet ligjore që ka sipas legjislacionit për kontrollin tatimor dhe përfaqësuesin tatimor në zbatim të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.ò, i ndryshuar dhe UMF në zbatim të tij, tatimpaguesi jo-rezident ka detyrimin të emëroje një përfaqësues tatimor rezident dhe regjistrohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, kur kjo i kërkohet nga legjislacioni në fuqi, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.ò, i ndryshuar dhe UMF në zbatim të tij. Gjithashtu nga ana e inspektorit të kontrollit është njoftuar se "*Mosparaqitja për ushtrimin e kontrollit tatimor në zbatim e detyrim të ligjeve të sipërcituara brenda afateve ligjore i jep të drejtë administratës tatimore të vazhdojë procedurat e kontrollit*" duke përdorur metodat alternative në zbatim të nenit 71 dhe 72 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.ò, i ndryshuar dhe UMF në zbatim të tij. Duke qene se brenda afateve ligjore subjekti nuk ka dërguar asnjë përfaqësues apo nuk është paraqitur administratori për të vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga ana e inspektorit të kontrollit i është kërkuar Drejtorit Rajonal autorizim për përdorimin e metodave alternative të vlerësimit dhe pas aprovimit nga ana e Tij dhe në zbatim të nenit 71 dhe 72 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.ò, i ndryshuar dhe UMF në zbatim të tij u krye kontrolli.

Për Kontrollin e TVSH-së:

- Për periudhën Maj 2014-Dhjetor 2015 TVSH-ja nuk u kontrollua nga ana e inspektorit të kontrollit pasi e drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës neni 73 Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër Procedurat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

- Për vitin 2016 është sqaruar se subjekti ka deklaruar të gjitha deklaratat e TVSH-së me 0 lekë .

- Për periudhën JanaróDhjetor të vitit 2017, 2018, 2019 dhe 2020 subjekti ka kryer blerje dhe i ka deklaruar në sistemin tatimor C@ts. Duke qene se brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për kontrollin i është kërkuar Drejtorit Rajonal autorizim për përdorimin e metodave alternative te vlerësimit në zbatim të germës ödö të nenit 71 dhe germës öaö të nenit 72 të ligjit Nr. 9920 datë.19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.ö, i ndryshuar dhe UMF në zbatim të tij. Pas marrjes së miratimit, subjektit nuk i është njohur kreditimi i TVSH së këtyre blerjeve pasi nuk janë dorëzuar faturat për të kontrolluar saktësinë e tyre, kreditimin e TVSH etj, në zbatim të kërkesave ligjore të neneve 69, 101, 115 të ligjit nr. 92.2014 òPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSHö. Për këtë arsye subjektit nuk i është njohur kreditimi është penalizohet në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër Procedurat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

Për Kontrollin e Tatim-Fitimit:

- Për periudhën 2014 tatim fitimi nuk është kontrolluar pasi e drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës neni 73 ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër Procedurat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

- Për vitin 2015 subjektit nuk i është njohur si shpenzim asnjë vlere, në masën që nuk është vërtetuar me dokumente nga tatimpaguesi, pasi nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues. Shpenzim është njohur vetëm për kontributeve e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të deklaruara në sistemin C@TS të cilat i ka paguar. Duke qene se brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për kontrollin inspektori i ka kërkuar Drejtorit Rajonal autorizim për përdorimin e metodave alternative të vlerësimit në zbatim të germës ödö te nenit 71 dhe germës öaö të nenit 72 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.ö, i ndryshuar dhe UMF në zbatim të tij. Pas marrjes së miratimit inspektori ka vendosur që subjektit nuk do ti njihen shpenzimet ne mbështetje të germës öLö te nenit 21 te Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar dhe UMF ne zbatim te tij dhe ka bërë penalizmin e subjektit në zbatim të nenit 115 të ligjit nr. 9920 datë.19.05.2008 òPër Procedurat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

Nga grupi i auditimit mbas shqyrtimit të dosjes së kontrollit gjykoket se jemi në situatën kur kemi të bëjmë më evazion fiskal siç sanksionohet edhe nga kërkesat e nenit 116 “Evazoni tatimor” të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: *Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt”. Grupi i auditimit gjykon se penalizimi i subjektit duhet të ishte bërë sic tregohet më poshtë:*

Tabela nr.47 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Viti 2015			
Përshkrimi	Subjekti	Auditi	Diferenca
Shitjet neto	13,909,350	13,909,350	0
Materialet e konsumuara	7,409,269	0	-7,409,269
- Pagat e personelit	1,541,000	0	-1,541,000
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	221,254	221,254	
Amortizimi dhe zhvlerësimet			
Shpenzime te tjera			
Shpenzime panjohura	53,000		-53,000
Total shpenzime	9,224,523	221,254	-9,003,269
Fitimi (humbja) para tatimit	4,684,828	13,688,097	9,003,269
Shpenzime panjohura	53,000	53,000	
Fitimi (humbja) para tatimit	4,737,828	13,741,097	9,003,269
Tatim Fitimi	710,674	2,061,164	1,350,490
Fitimi.humbja neto e vitit financiar	3,974,153	11,626,932	7,652,779

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr. 48 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Përshkrimi	Vlera
Tatim Fitimi	1,350,490
Gjobë (100%) Tatim Fitimi	1,350,490
Total Detyrimi	2,700,980

Tabela nr.49 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Viti 2016			
Përshkrimi	Subjekti	Auditi	Diferenca
Shitjet neto		0	0
Materialet e konsumuara		0	0
- Pagat e personelit	40,000	0	-40,000
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	10,560	10,560	0
Amortizimi dhe zhvlerësimet			0
Shpenzime te tjera			0
Shpenzime panjohura			0
Total shpenzime	50,560	10,560	-40,000
Fitimi (humbja) para tatimit	-50,560	-10,560	40,000
Shpenzime panjohura		-	0
Fitimi (humbja) para tatimit	-50,560	-10,560	40,000
Tatim Fitimi	-7,584	-1,584	6,000
Fitimi.humbja neto e vitit financiar	-42,976	-8,976	34,000

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.50 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Viti 2017

Përshkrimi	Subjekti	Auditi	Diferenca
Shitjet neto	11,471,050	11,471,050	0
Materialet e konsumuara	8,113,904	0	-8,113,904
- Pagat e personelit	882,055	0	-882,055
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	290,598	290,598	0
Amortizimi dhe zhvlerësimet	100,000		-100,000
Shpenzime te tjera	1,230,717		-1,230,717
Shpenzime panjohura			0
Total shpenzime	10,617,274	290,598	-10,326,676
Fitimi (humbja) para tatimit	853,776	11,180,452	10,326,676
Shpenzime panjohura		-	0
Fitimi (humbja) para tatimit	853,776	11,180,452	10,326,676
Tatim Fitimi	128,066	1,677,068	1,549,001
Fitimi.humbja neto e vitit financiar	725,710	9,503,384	8,777,675

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr. 51 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Përshkrimi	Vlera
Tatim Fitimi	1,549,001
Gjobe (100%) Tatim Fitimi	1,549,001
Total Detyrimi	3,098,002

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.52 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Viti 2018			
Përshkrimi	Subjekti	Auditi	Diferenca
Shitjet neto	18,768,800	18,768,800	0
Materialet e konsumuara	54,214	0	-54,214
- Pagat e personelit	4,061,717	0	-4,061,717
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	468,855	468,855	0
Amortizimi dhe zhvlerësimet	1,400,000		-1,400,000
Shpenzime te tjera	3,171,628		-3,171,628
Shpenzime panjohura			0
Total shpenzime	9,156,414	468,855	-8,687,559
Fitimi (humbja) para tatimit	9,612,386	18,299,945	8,687,559
Shpenzime panjohura		-	0
Fitimi (humbja) para tatimit	9,612,386	18,299,945	8,687,559
Tatim Fitimi	1,441,858	2,744,992	1,303,134
Fitimi.humbja neto e vitit financiar	8,170,528	15,554,953	7,384,425

Përshkrimi	Vlera
Tatim Fitimi	1,303,134
Gjobe (100%) Tatim Fitimi	1,303,134
Total Detyrimi	2,606,268

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr. 53 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Viti 2019			
Përshkrimi	Subjekti	Auditi	Diferenca
Shitjet neto	12,866,810	12,866,810	0
Materialet e konsumuara	5,708,325	0	-5,708,325
- Pagat e personelit	4,150,213	0	-4,150,213
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	436,620	436,620	0
Amortizimi dhe zhvlerësimet	450,000		-450,000
Shpenzime te tjera	2,033,808		-2,033,808
Shpenzime panjohura			0
Total shpenzime	12,778,966	436,620	-12,342,346
Fitimi (humbja) para tatimit	87,844	12,430,190	12,342,346
Shpenzime panjohura		-	0
Fitimi (humbja) para tatimit	87,844	12,430,190	12,342,346
Tatim Fitimi	4,392	621,510	617,117
Fitimi.humbja neto e vitit financiar	83,452	11,808,681	11,725,229

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.54 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Përshkrimi	Vlera
Tatim Fitimi	617,117
Gjobe (100%) Tatim Fitimi	617,117
Total Detyrimi	1,234,234

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.55 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	Total
Tatim Fitimi	1,350,490	-	1,549,001	1,303,134	617,117	4,819,742
Gjobë (100%) Tatim Fitimi	1,350,490	-	1,549,001	1,303,134	617,117	4,819,742
Total Detyrimi	2,700,980	-	3,098,002	2,606,268	1,234,234	9,639,484

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.56 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Viti	Përrjashtuara	Blerje Furnitorë Vendas	TVSH	Importe	TVSH	Importe të përjashtuara të investimeve pa TVSH	Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%	TVSH
2017	83,220	5,788,097	1,157,619					
2018	568,688	2,275,340	455,068			526,654	1,000,000	200,000
2019	480,978	6,851,165	1,370,233					
31.08.2020	36,009	382,610	76,522					
Total	1,168,895	15,297,212	3,059,442	0	0	526,654	1,000,000	200,000

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Tabela nr.57 Rillogaritja e detyrimeve sipas audituesve

(në lekë)

Përshkrimi	Vlera
Blerje Furnitorë Vendas	15,297,212
Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%	1,000,000
Totali Blerjeve	16,297,212
TVSH (Mosnjohje Kreditimi)	3,259,442
Gjobe (100%)TVSH-je	3,259,442
Total	6,518,885

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, përpunuar nga K.L.SH

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

znj.D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë .

z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

z. K.B në cilësinë e inektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

40. Subjekti: “V.SH” me aktivitet: Prodhim dhe tregtim fara fidanë dhe inpute bujqësore etj.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar nga inspektori A.M për:

1. TVSH: 10.2014-09.2019.
2. Tatimi Fitimi: 2015-2018.
3. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore: 10.2014-09.2019.
4. Tatime të tjera: 10.2014-09.2019.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- ÷Formulari-pyetësor i Vetëdeklarimit para kontrollit që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81 të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (Shtojca 1) me UMF Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, që ndodhet bashkangjitur praktikës jo i plotësuar.

-Intervista me tatimpaguesin nuk ndodhet bashkangjitur praktikës.

-Nuk është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzimi i procesverbalit

-Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.

-Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll dhe janë evidentuar edhe faturat e blerjeve.

-Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll dhe janë evidentuar faturat e shitjes.

-Është realizuar analiza e kostos.

-Është bërë verifikimi i fuqisë punëtore sipas funksioneve që ata kryejnë në shoqëri dhe është mbajtur procesverbal, por në procesverbal është evidentuar vetëm ekonomisti i shoqërisë.

-Është mbajtur procesverbal për evidentimin e faturës së fundit të blerjes dhe të shitjes deri në momentin e kontrollit.

-Është bërë inventarizimi i blloqeve tatimore.

-Është bërë analiza e kostos dhe e çmimit të blerjes.

-Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll, gjithashtu janë evidentuar faturat përkatëse të blerjeve.

- Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll, gjithashtu janë evidentuar faturat përkatëse të shitjeve.
- Nuk është verifikuar me dokumentat justifikuese nëqoftëse pagat janë paguar me bankë.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

- z. D.L në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.
- z. E.M në cilësinë e ish-Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.
- z. P.T në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.
- z. A.M në cilësinë e inpektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Korçë.

Titulli gjetjes:	Parregullsi të dala nga auditimi i dosjeve të kontrollit të inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor
Situata:	<p>Nga auditimi i raport kontrolleve të plota dhe rimbursimit të TVSH-së, u konstatuan parregullësi në veprimet e inspektorëve të kontrollit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Është identifikuar një rast ku nuk është aplikuar <i>ōLlogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-sëō</i> për subjektet me aktivitet të përzier veprim në kundërshtim me nenin 72 pika 2 të ligjit nr. 92/2014 <i>ōPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëō</i>; nenin 56 pika 3 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 <i>ōPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisëō</i> me efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 456,019 lekë; - Janë konstatuar 3 raste të cilat kanë pasur gabim në llogaritjen e kostos së mallrave të shitur veprime këto në kundërshtim me nenin 115 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 <i>ōPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëō</i> dhe që kanë sjellë një efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 386,394 lekë; - Në një rast është konstatuar kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për ndërtim hidrocentrali sepse punimet janë zhvilluar në tejkalim të afatit të lejes kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit Nr.6 <i>ōPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëō</i>, i ndryshuar, me efekte financiare në arkëtimin e të ardhurave në shumën 42,150,598 lekë; - Në 11 raste janë konstatuar mos kryerja e veprimeve të duhura në lidhje me njohjen e shpenzimeve të amortizimit në pasqyrën e performancës veprime në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 <i>ōPër tatimin mbi të ardhuratō</i>, i ndryshuar, me efekt financiar mungesën e të ardhurave buxhetore në total prej 115,135,079 lekë; - Në një rast është konstatuar shitje nën kosto të produkteve, veprime në kundërshtim me nenin 115, pika 1 të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008 <i>ōPër procedurat tatimoreō</i>; - Në një rast ka dyshime të arsyeshme për evazion fiskal sipas përcaktimeve të nenit 116 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 <i>ōPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëō</i>, i ndryshuar, me efekte financiare në mungesën e të ardhurave në vlerën 16,158,369 lekë;

	- Nga auditimi u konstatua në një rast diferencë midis njoftim vlerësimit të gjeneruar nga sistemi c@ts dhe detyrimeve sipas raport kontrollit duke shkaktuar të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit në total në shumën 139,458 lekë.
Kriteri:	<i>Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 116 Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 22 Ligjin Nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 UMF Nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2. Ligj Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Ligj Nr 92 2014 datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. UMF Nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. UMF Nr. 6, datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhër nr. 192 datë 12.08.2020. Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave. Manuali i Kontrollit Tatimor.</i>
Ndikimi.Efekti:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumën 177,639,052 lekë.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit në vend
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogarituara për subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve tatimore <i>sipas aneksit 5.1 në shumën 174,316,112 lekë.</i>

Titulli gjetjes:	Parregullsi të dala nga auditimi i dosjeve të kontrollit të inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor si pasojë e mos pagesës së taksës së ambalazhit.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se nga analiza e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor në bazë të programit nr. 17344/4 prot., datë 19.02.2020 duke nxjerrë peshën dhe sasitë e <i>ogranulati</i> të që është futur në proces

	<p>prodhimi për të prodhuar produktin ÷Ambalazhë të llojeve të ndryshme nga subjekti ÷P.Pö SHPK me NIPT nuk është kryer pagesa e plotë për sasinë e mallit të prodhuar ambalazh plastik në sasinë prej 12 031 kg për detyrimin tatimor gjithsej prej 2,406,200 lekë penalitet bazuar dhe në nenin 5 ÷Agjentët e taksaveö të ligjit nr. 178/2013 ÷Për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtareö. Gjithashtu konstatohet se për një periudhë kohore 5 mujore (qershor-tetor) të vitit 2017, aktiviteti subjekti ÷P.P” SHPK sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka prodhuar një sasi prej 12 031 kg ambalazh plastik fakt i cili nuk është kontestuar në asnjë rast nga Drejtoria Tatimore Korçë, ndërsa për një periudhë kohore prej 12 mujore (janar-dhjetor) të vitit 2017, aktiviteti i këtij subjekti ka prodhuar dhe shitur një sasi prej 13,265 kg ambalazh plastik, fakt i vënë në dispozicion gjatë fazës audituese të Projekt-Raportit të Auditimit. Nuk rezulton një analizë e plotë e bilancit material për sasinë e prodhuara dhe të shitura për vitin ushtrimor 2017 për aktivitetin e subjektit ÷P.Pö SHPK mbështetur në treguesit e importit, eksportit, kartës teknologjike, firove, humbjeve me qëllim dokumentimin e provës se vërtetësisë se pagesës plotë të taksës TAM për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, nisur edhe nga analiza korrekte e kryer nga grupi auditues për një periudhë të pjesshme kohore prej 40% periudhës së aktivitetit të këtij subjekti tatimpagues.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 178/2013 ÷Për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 ÷Për taksat kombëtareö
Ndikimi.Efekti:	Nga ana e inspektorit të kontrollit nga zyra, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumën 2,406,200 lekë.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit nga zyra
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtorja Rajonale Tatimore Korçë të marrë në shqyrtim të plotë mos pagesat e Taksës Kombëtare TAM dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të kërkojë kontroll të thelluar tatimor për deklarimet e kryera nga subjekti ÷Pö SHPK në lidhje me sasinë e prodhuar të ambalazhit plastik dhe pagesën e kryer dhe të papaguar në shumën 2,406,200 lekë për taksën kombëtare të ambalazhit TAM për vitin 2017 që përbën të ardhur të munguar në Buxhetin e Shtetit dhe në vijim për detyrime tatimore që do të rezultojnë bazuar në legjislacionin tatimor sipas nenit nr. 85 “Ri kontrolli Tatimorë sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar. Në përfundim të kontrollit të kryer të vihet në dijeni Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me rezultatet e arritura nga administrata tatimore në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues ÷P.Pö SHPK me nipt L. për mospagesat e taksës së ambalazhit plastik për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2022.
Titulli gjetjes:	Parregullsi të dala nga auditimi i dosjeve të kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor

Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se gjatë zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë òK.Gò SHPK dhe òE.Mò SHPK në periudha të ndryshme kohore janë kryer kreditime nga llogaria e ortakut për llogari të këtyre shoqërive me qëllim rritjen e aktivitetit tregtar. Këto pagesa konfirmohen në raportet e kontrollit tatimor si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Gjatë auditimit u konstatua se për këto hua ose shuma në vlera monetare të dhëna nga llogaria e ortakut në favor të shoqërive òK.Gò SHPK dhe òE.Mò SHPK nuk rezultonin llogaritje të interesave vjetore në pasqyrat e performancës së këtyre shoqërive, duke sjellë pasojë efekte tatimore të rrillogaritura si rikarakterizim të ardhurash dhe me detyrime tatimore në shumën 3,221,952 lekë për TVSH dhe 3,221,952 lekë gjobë 100% TVSH për periudhën 2014-2017, si dhe në shumën 2,416,464 lekë për tatim fitimin dhe 2,416,464 lekë gjobë 100% tatim fitimi për periudhën 2014 deri 2017 për subjektin òE.Gò SHPK. Për subjektin òK.Gò SHPK rezultuan detyrime tatimore nga rikarakterizimi në shumën 715,000 lekë për TVSH dhe 715,000 lekë gjobë 100% TVSH për periudhën 2014-2017, si dhe shumën 536,250 lekë për tatim fitimin dhe 536,250 lekë gjobë 100% tatim fitimi për periudhën 2014-2017. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë me anë të observacioneve ka kundërshtuar rrillogaritjen e detyrimeve tatimore për këto raste si një praktikë dhe metodologji që nuk trajtohej nga legjislacioni tatimor i fushës dhe në praktikën e përditshme të raport kontrolleve tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 <i>òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò</i>. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si òPalë të lidhuraò, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në ligjin nr. 42/2014 <i>òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.16, datë 18.6.2014 òPër transferimin e çmimitò, gjë që sjell se, çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet të përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (òArmò Lengthò). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rrillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë, referuar Kodit Civil i miratuar me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, neni 1050 <i>òPër Huanëò cilësohet se huamarrësi duhet të paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.</i></i></p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 òKodi civil i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 1050 <i>òPër huanëò</i> - Ligji nr. 42/2014 <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar</i> - Udhëzimi nr.16, datë 18.6.2014 <i>“Për transferimin e çmimit”,</i>
Ndikimi.Efekti:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet

	e subjektit sipas Legjislacionit për verifikimin e llogarië së ortakut.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit në vend
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin veprime administrative me qëllim përcaktimin e një metologjie të llogaritjes së detyrimeve totale tatimore të trajtuara sa më sipër për subjektet òK.Gò shpk dhe òE.Mò shpk. Gjithashtu Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të përcaktojnë një metodologji të qartë dhe të saktë ligjore dhe një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontroleve tatimore, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë ku ata janë ortakë për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga kundërshtitë ligjore që parashikon kodi i procedurave civile.

Titulli gjetjes:	Parregullsi të dala nga auditimi i dosjeve të kontrollit të inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor
Situata:	Nga auditimi i raport kontroleve të plota, për subjektin òE.Kò rezulton kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për punime rikonstruksioni në shumën 3,322,940 lekë, ku punimet janë zhvilluar në shkelje të lejes së ndërtimit, situacioni i punimeve është në vlerë më të madhe se preventivi si dhe janë shtuar zëra punimesh shtesë nga ato të parashikuara.
Kriteri:	<i>Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 72, Ligj Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Rrregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020. Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr. 1482.2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrisë të Financave. Manuali i Kontrollit Tatimor.</i>
Ndikimi.Efekti:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumën 3,322,940 lekë.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit në vend
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogarituar për subjektin që ka shmangur pagesën e detyrimeve tatimore në shumën 3,322,940 lekë.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 7 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Trajtuar sa më poshtë gjykimi i audituesve në lidhje me observacionet e derguara.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. A.M në mënyrë shkresore nr 947/44 prot., datë 12.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues: Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon inspektori i kontrollit se nuk ka sjellë bazë ligjore, fakte apo dokumente të reja që ta kundërshtojnë konstatimin e grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. Gj.M në mënyrë shkresore nr 947.45 prot., datë 12.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues: Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se nga shqyrtimi i observacionit të dërguar nga inspektori i kontrollit është konstatuar se nuk ka sjellë bazë ligjore, fakte apo dokumente të reja që ta kundërshtojnë konstatimin e grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. I njëjti observacion është paraqitur dhe gjatë fazës së projekt raportit.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. A.ZH në mënyrë shkresore nr 947.45 prot., datë 12.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues: Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se bazuar në nenin 22, pika 7 e ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Baza e amortizimit të jetë vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore: a) duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë gjatë periudhës tatimore; b) duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera, të pavullnetshme gjatë periudhës tatimore.”, ku nga verifikimi inspektori nuk ka llogaritur amortizimin sipas kësaj pike. Në lidhje me normativat e konsumit të karburantit nuk rezultojnë në dosjen e kontrollit të detajuar për secilin mjet sipas inventarit të autobusëve në përdorim për transport ndërkombëtar dhe nuk janë paraqitur prova shkresore mbi këtë konstatim.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. P.T në mënyrë shkresore nr 947.45 prot., datë 12.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues: Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se Logjika e ligjit është që të vendos kufijtë të mirëpërcaktuar në zërat të cilët mund të jenë evaziv dhe që organet tatimore kanë vështirësi të masin dhe monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme, e njëjta logjikë si të përcaktimet e nenit 21 të Shpenzimeve të panjohura të Ligjit Nr 8438 Për Tatimin mbi të Ardhurat, më konkretisht e), h), o) dhe pika 2). Në asnjë dosje kontrolli të audituar nga grupi i auditimit nuk është analizuar nga ana e inspektorëve nëse aktivitetet përfshihen ose jo në veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit. Në lidhje me pretendimin e llogaritjes së amortizimit nga dita e parë e muajit të hyrjes nga të dhënat e paraqitura në dosjet e kontrollit nuk janë paraqitur evidenca mbi këtë fakt (datën e hyrjes së aktiveve). Në lidhje me akt konstatimin nr 8 për kontrollin nga zyra nuk janë sjellë bazë ligjore, fakte, argumente ose dokumente të reja të cilat të hedhin poshtë konstatimet e grupit të audituesve të Kllsh-së

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar në mënyrë shkresore nr 947.45 prot., datë 12.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues : Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se argumentet e trajtuara nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova shkresore të cilat duhet ti viheshin në dispozicion grupit auditues gjatë fazës së auditimit në terren dhe duhet të ishin pjesë e dosjeve të kontrollit.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. K.R në mënyrë shkresore nr 945/46 datë 13.01.2022 në mënyrë shkresore nr nr 945/46 datë 13.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues: Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se nga shqyrtimi i observacionit të dërguar nga inspektori i kontrollit është konstatuar se nuk sjellë bazë ligjore, fakte apo dokumente të reja që ta kundërshtojnë konstatimin e grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Situata vazhdon të jetë e njëjtë ku subjekti nuk ka zbatuar preventivin e miratuar dhe të përcaktuar tek òDeklarata paraprake e kryerjes së punimeveò. Por ka rezultuar në një diferencë në vlerë dhe zëra punimesh midis preventivit dhe situacionit përkatës të punimeve. Veprime këto të cilat bien ndesh me parashikimet e nenit 20, pika 8, shkronja a, d e Udhëzimit Nr. 6., datë 30.01.2015 òPër tatimin mbi vlerën e shtuarò. Për arsyet e përmendura mësipër observacioni nuk merret parasysh.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. A.H në mënyrë shkresore nr 947/47 datë 13.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues : Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se argumentet e paraqitura janë trajtuar nga grupi i auditimit gjatë fazës së hartimit të projekt raportit të auditimit me shkresën nuk nr 8090.43 prot, datë 26.11.2021 (me tonën nr 947.18 prot., datë 01.12.2021) dhe nuk ka elementë të tjerë.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar në mënyrë shkresore nr 947/48 datë 13.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Oëndrimi i grupit auditues : Grupi auditues gjykon që argumentet dhe provat e paraqitura dhe trajtuara nuk janë të plota dhe nuk argumentojnë parimisht dhe në mënyrë faktike pagesën e plotë të Taksës Kombëtare të Ambalazhit për periudhën e vitit ushtrimor dhe pagesave tatimore që lidhen me këtë taksë kombëtare për sasi të totale të ambalazhit plastik të prodhuar dhe të hedhur në qarkullim të lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2017.

Rezultoni në observacionin e ardhur nga znj M. se nga subjekti subjekti "P.P" SHPK me NIPT L. kane rezultuar sasa të ambalazhit plastik të prodhuar dhe të hedhur në qarkullim të lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë .

për vitin 2017 sasia prej 13,265 kg

për vitin 2018 sasia prej 22,191 kg

për vitin 2019 sasia prej 55,539 kg

për vitin 2020 sasia prej 46,840 kg

për vitin 2021 sasia prej 33,140 kg

Rezultoni se nga përfaqësuesi i DRT Korçe nuk është vendosë në dispozicion një dhe nuk është kryer një analizë e plotë totale për sasinë e prodhuar dhe shitur brenda territorit të RSH nga subjekti P.P" SHPK me NIPT L. për periudhën deklaruese 01.01.2017 deri 31.12.2017

Nga audituesit e KLSH gjatw auditimit të dosjes të subjektit sipas Program Kontrolli Përfundimtar nr. 17344/4 datë 19.02.2020 (periudha nentor 2017-shtator 2019) është bërë

analiza e raportit përfundimtar të kontrollit duke nxjerrë peshën dhe sasinë e “Granulatit” që është futur në proces prodhimi për të prodhuar produktin “Ambalazh” të llojeve të ndryshme për të cilat është llogaritur edhe detyrimi përkatës sipas bazës ligjore bazuar në ligjin nr. 178.2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare dhe Gjithashtu bazuar në nenin 5 “Agjentet e Taksave” të Ligjit nr. 178.2013 “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” ku përcaktohet se

“Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e taksën së materialeve artikujve plastikë dhe taksën e ambalazheve prej plastike qelqi ngarkohen Administrata Tatimore, në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi dhe plastike”.

Gjithashtu bazuar në nenin 10 “Shkeljet dhe sanksionet” të Ligjit nr. 178.2013 “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” përcaktohet se:

“Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të fakteve dhe provave të paraqitura rezulton se për periudhën ushtrimore tatimore 01.01.2017-31.12.2017 rezultojnë të prodhuara dhe të shitura dhe të deklaruara nga subjekti P.P” SHPK me NIPT sasia prej 13,265 kg,

Nga rezultatet e auditimit të kryera nga grupi auditues vetëm për periudhën qershor-tetor 2017 pra vetëm për një periudhë 5 mujore aktiviteti dhe deklarimi të evidentuara në auditimin e materialit të Program Kontrolli Përfundimtar nr. 17344/4 datë 19.02.2020 (qershor 2017-tetor 2017) marrë në shqyrtim nga grupi auditues rezulton një sasi e prodhuar e artikullit ambalazh plastik prej 12,301 kg.

Nga analiza faktike rezulton një diferencë e madhe sasiore për sasinë e prodhura dhe taksën kombëtare TAM te paguar.

Per nje periudhe kohore prej **5 mujore (qershor-tetor) te vitit 2017**, aktiviteti subjekti “P.P” SHPK me NIPT sipas përlllogaritjeve të Kontrollit te Larte te Shtetit ka prodhuar nje sasi prej **12,031 kg ambalazh plastik** fakt i cili nuk eshte kontestuar ne asnjë rast nga DRTatimore Korçe

Per nje periudhe kohore prej **12 mujore (janar-dhjetor) te vitit 2017**, aktiviteti subjekti “P.P” SHPK me NIPT sipas përlllogaritjeve të Kontrollit te Larte te Shtetit ka prodhuar një sasi prej **13,265 kg ambalazh plastik** fakt i vene ne dispozicion gjate fazës audituese te ProjektRaportit te Auditimit nga znj M..

Gjithashtu ju ritheksojmë se gjate procesit auditues te realizuar nga KLSHja ne Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçe u konstatua se zëri më pak i realizuar dhe i arkëtuar në kategoritë e llojit të tatimeve është zëri “**Taksa Kombëtare**” i cili është realizuar në masën 55% për vitin 2019 ne krahasim me planin e planifikuar prej 67,748 mijë lekë, në nivelin 74.3% ne krahasim me planin e planifikuar prej 44,579 mijë lekë për vitin 2020 dhe në nivelin 60% të totalit të parashikuar të Planit të Programuar (plan në vijim), fakt i cili tregon për punën jo të duhur të kryer nga administrata tatimore e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj takse kombëtarë.

Në përfundim nga provat dhe dokumentacioni i paraqitur nga përfaqësuesi i DRT Korçe znj M. grupi auditues konstaton se provat dhe faktet e paraqitura janë jo të plota, jo të mbështetura, nuk rezulton një analizë e plotë e bilancit material për për sasinë e prodhuara dhe të shitura për vitin ushtrimor 2017 për aktivitetin e subjektit “P.P” SHPK mbështetur ne treguesit e importit, eksportit, kartës teknologjike, firove , humbjeve me qëllim dokumentimin e provës se vërtetësisë se pagesës plotë të taksës TAM për llogari te Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë , nisur edhe analiza korrekte e kryer nga grupi auditues per një periudhe te pjesshme kohore prej 40% periudhës se aktivitetit te këtij subjekti tatimpagues.

*Ne analize te fakteve dhe provave te mësipërme grupi auditues arrin ne konkluzioni qe:
Argumentet dhe provat e paraqitura nga znj M. nuk merren ne konsiderate, dhe nuk ritrajohen ne Raportin Përfundimtar te Auditimit.*

Drejtoria Rajonale Tatimore Korce te marre në shqyrim te plote këtë analize ne lidhje me msopagesat e Takses Kombetare TAM te reflektuara edhe ne mosrealizimin faktik te zërit te kësaj takse kombëtare dhe ne bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme te Tatimeve te kerkoje kontroll te thelluar tatimor për deklarimet e kryera nga subjekti “P.P” SHPK ne lidhje me sasinë e prodhuar te ambalazhit plastik dhe pagesën e kryer për taksen kombëtare te ambalazhit TAM per vitin 2017 dhe ne vijim sipas legjislacionit tatimor bazuar ne nenin 85 “**Ri kontrolli Tatimor**” sipas ligjit 9920, datë 19.5.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar

1. Rezultatet e kontrollit tatimor janë detyruese për administratën tatimore. Për të njëjtin detyrim tatimor nuk mund të kryhen kontrole të mëtejshme, me përjashtim të rasteve kur:

a) tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar gjatë kontrollit tatimor ose nuk ka vepruar, në përputhje me kërkesën me shkrim, për t’i dhënë informacion administratës tatimore, gjatë kryerjes së kontrollit tatimor;

b) administrata tatimore ka prova, konkrete dhe të besueshme, që tatimpaguesi është përfshirë në evazion tatimor;

c) inspektori, gjatë kontrollit tatimor, nuk ka vepruar në përputhje me procedurat dhe, për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore apo janë marrë masa disiplinore. Në përbërjen e grupit të rikontrollit tatimor nuk mund të bëjnë pjesë inspektorë, që kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor të mëparshëm.

2. Ri kontrolli tatimor miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kërkesës me shkrim për fillimin e një ri kontrolli tatimor, të bërë nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, si dhe nga drejtori i drejtorisë së kontrollit apo auditit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Vendimi i miratimit të ri kontrollit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në të cilin janë shprehur qartë arsyet e ri kontrollit, i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin e kontrollit tatimor

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. K.C në mënyrë shkresore nr 947/49 datë 14.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Qëndrimi i grupit auditues : Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se argumentet e paraqitura janë trajtuar nga grupi i auditimit gjatë fazës së hartimit të projekt raportit të auditimit me shkresën nr 947/11 datë 01.12.2021.

Në lidhje me këtë Projekt Raport nga përfaqësuesit e subjektit të audituar z. K.XH në mënyrë shkresore nr 947/42 datë 12.01.2022 observacioni në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë material.

Qëndrimi i grupit auditues : Në lidhje me këtë observacion grupi auditues gjykon se argumentet e paraqitura janë trajtuar nga grupi i auditimit gjatë fazës së hartimit të projekt raportit të auditimit me shkresën nr 947/17 datë 01.12.2021.

2.3.3 Mbi auditimin e veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit Procedurat e kontroleve për rimbursim nga Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit òNr 947/1 Prot. Datë 14.09.2021ò, i ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Organika e Sektorit të kontrollit nga Zyra dhe monitorimit.*
2. *Plane mujore të punës.*
3. *Ndarjet e NIPT-ve sipas inspektorëve.*
4. *Deklaratat mujore në nivel subjekti të TVSH.*
5. *Deklaratat vjetore në nivel subjekti të TVSH.*
6. *Tepricat kreditore TVSH-Tf-Tthf.*
7. *Deklaratat e Tf-Tthf.*
8. *Rivlerësimet e kësteve të Tf.*
9. *Deklaratat e Tatimit në burim dhe pagesat e Tatimit mbi Dividentin.*
10. *Kasat Fiskale.*
11. *Gabimet e Kasave.*
12. *Pasqyrat Financiare të subjekteve.*
13. *Sistemi C@TS me akses të kufizuar.*

Çdo informacion dhe dokumentacion shtesë i vlerësuar për kontroll nga grupi i auditimit dhe i vënë në dispozicion nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit).

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit për periudhën e auditimit nuk disponon plane mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët për të monitoruar subjektet në mënyrë të vazhdueshme. Nga dokumentacioni i kërkuar në DRT Korçë mbi hartimin dhe raportimin e planeve mujore, grupit të auditimit nuk janë vënë në dispozicion plane mujore dhe vjetore të punës për këtë sektor, veprime këto jo në përputhje me pikën 5, 8 dhe 9 të Manualit të Kontrollit nga Zyra.

Ndarja e NIPTe-ve sipas Inspektorëve.

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion 6 komunikime elektronike (*E-mail*) të përgatitura nga Përgjegjësi i Sektorit, aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit dhe miratuar nga Drejtori Rajonal në lidhje me ndarjen e subjekteve si në vijim:

- *E-mail nr.1, datë 25.02.2019, nr.2, datë 02.04.2019 drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra.*
- *E-mail nr.3, datë 27.02.2020, nr.4, datë 07.09.2020 drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra.*
- *E-mail nr.5, datë 16.03.2021, nr.6, datë 29.07.2021 drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra.*

Rezulton se:

Në lidhje me organizimin e inspektorëve nga zyra nuk janë respektuar udhëzimet në Manual, pika 5 *Organizimi i Inspektorëve nga Zyra*, ku citohet: *“Në muajin Janar të çdo viti, drejtori i kontrollit tatimor /përgjegjësi i sektorit të kontrollit nga zyra në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, merr listën e plotë të tatimpaguesve të rajonit, përfshirë Persona fizikë : tatimpaguesit e regjistruar për TFTH & TVSH , tatimpaguesit me Xhiro e parashikuar < 2.000.000, Persona juridikë : tatimpaguesit e regjistruar për TF & TVSH, si dhe Individët. Bazuar në këtë listë, drejtori i kontrollit tatimor /përgjegjësi i sektorit të kontrollit nga zyra bën ndarjen e të gjithë tatimpaguesve sipas inspektorëve të kontrollit nga zyra. Për sa më sipër kjo ndarje nuk është bërë në periudhën e përcaktuar në Manual.*

Gjithashtu rezulton se për periudhën 01.01.2019 deri në 16.03.2021 nuk ka një ndarje detyrash për kontrollin e individëve private, në kundërshtim me pikën 5 “Organizimi i Inspektorëve nga Zyra”, Manuali i Drejtorisë së Kontrollit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: *Ish-Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit Z. P.B për periudhën 01.01.2019 – 24.07.2020, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit Z. I.C për periudhën 24.07.2020 – 30.09.2021, Ish-Drejtori i Kontrollit Tatimor Z. E.M për periudhën 01.01.2019 – 16.12.2020, Drejtori i Kontrollit Tatimor Z. K.C për periudhën 31.12.2020 – 30.09.2021.*

Tepricat Kreditore të TVSH-së, Tatimit mbi Fitimin dhe Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin.

1. Teprica Kreditore e TVSH-së.

Nga databaza e tepricave kreditore të TVSH-së u përzgjedhën subjektet (Top 50) me tepricën më të lartë kreditore në fund të periudhës tatimore 2018-2020 të detajuar në aneksin 5,2:

Për sa më sipër rezulton se për periudhën/ecurinë në auditim (01.01.2019-30.09.2021) ka subjekte me tepricë kreditore në nivele të larta ku veçohen sektori i tregtisë dhe prodhimit dhe me tepricë kreditore me prirje në rritje që është sektori i tregtisë: nga 39% në vitin 2019, 44% në vitin 2020 dhe deri në 58% deri në 31.08.2021, të cilat rrisin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këta subjekte përbëjnë rreth 47% të tepricës kreditore në raport me totalin. Fakti që teprica kreditore mbetet në nivele relativisht të larta dhe nga ana e Inspektorit përkatës për këtë periudhë nuk është kërkuar informacion apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit dhe për pasojë në arkëtimin e detyrimeve tatimore. Duke qenë se ky numër i kufizuar subjektësh të përzgjedhura (në raport me totalin) të tatimpaguesve të DRT Korçë ka 47% të tepricës kreditore të TVSH-së, domosdoshmërisht duhet të ishin objekt monitorimi dhe verifikimi.

Kredia e tatimpaguesve për çdo lloj tatimi (Nga deklaratat dhe nga mbi-pagesat).

1. Teprica kreditore e Tatim Fitimit.

Nga të dhënat e marra lidhur me ecurinë e tepricës kreditore të Tatim Fitimit dhe veprimet e ndërmarra nga administrata e DRT-Korçë mbi monitorimin dhe verifikimin, u përzgjedhën subjektet (Top 50) me tepricën më të lartë kreditore për vitet 2018-30.09.2021 sipas aneksit 5.3:

2. Teprica kreditore e Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin.

Nga databaza e tepricave kreditore të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin u përzgjedhën (Top 50) subjektet me tepricën më të lartë kreditore për vitet 2018-30.09.2021 detajuar në aneksin nr 58.

Në rastet e tepricave kreditore të TF dhe TFTH, konstatojmë se nuk janë bërë kërkesa për kontroll me qëllim certifikimin e detyrimit të tatimit, pasi pas certifikimit kjo tepricë duhet të kalonte në pagesën e detyrimeve të papaguara tatimore.

Biznes i Madh me Humbje Tatimore mbi 1 Vit.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur subjektet Biznes i madh me humbje të konsiderueshme në vitet 2018-31.08.2021 si në vijim. Disa prej subjekteve janë dhe me humbje në 3 vite me radhë. Nga grupi i auditimit është bërë dhe një kryqëzim me të dhënat e marra nga drejtoria e mbledhjes së detyrimeve të papaguara ku ka rezultuar se disa prej tyre janë dhe debitorë si në vijim:

Tabela nr.59 Biznes i Madh me Humbje Tatimore mbi 1 Vit

(në lekë)

Statusi (Aktiv/Pasiv)	Humbja 2020	Humbja 2019	Humbja 2018	Vlera (Totale) Debitorë deri në 31.08.2021

Aktiv	5,231,490	4,004,159	2,904,830	360,870
Aktiv	16,139,289	37,962,566	1,526,164	68,370
Aktiv	342,456	274,745	351,593	-
Aktiv	22,906,744	13,441,369	4,780,570	835,739
Aktiv	1,429,389	1,573,891	1,321,346	510,303
Pasiv	12,671	1,017,201	1,129,015	-
Aktiv	83,354	44,724	1,351,405	450,935
Aktiv	58,032	87,048	80,352	121,183
Aktiv	1,015,649	1,676,149	521,489	805,795
Aktiv	354,131	475,422	680,818	62,772
Aktiv	1,928,145	4,216,481	12,863,393	1,500
Kërkesë për Çregjistrim	289,256	78,250	50,465	490,130
Aktiv	2,191,409	1,880,408	423,433	2,010,259
Aktiv	3,471,700	3,391,711	3,389,445	10,000
Aktiv	458,195	544,085	66,108	34,794
Aktiv	425,157	522,438	549,477	-
Aktiv	6,115,229	4,095,916	228,830	30,000
Aktiv	3,030,898	4,618,785	5,148,033	1,242,778
Aktiv	12,289,066	10,533,025	9,339,454	50,000
Aktiv	132,097	414,539	156,312	4,239,473
Aktiv	285,641	552,142	692,011	20,000
Aktiv	861,139	969,071	1,054,587	2,145,161
Pasiv	640,695	256,140	755,878	819,174
Aktiv	6,722,547	6,717,909	648,679	-
Aktiv	-	5,886,713	12,970,340	913,311
Aktiv	148,491	155,469	109,734	610,587
Kërkesë për Çregjistrim	140,280	296,760	296,760	31,143
Aktiv	448,706	448,404	144,478	8,370
Aktiv	65,520	456,120	556,676	205,782
Aktiv	2,801,764	2,679,617	3,319,695	-
Pasiv	365,104	91,400	336,096	-
Aktiv	54,289	985,545	628,490	589,830
Aktiv	545,182	1,184,704	3,020,980	13,057,820

Pasiv	2,999,600	3,324,454	2,321,898	-
Aktiv	1,551,718	2,184,185	2,485,150	187,535
Aktiv	738,105	1,062,725	1,041,455	-
Aktiv	515,814	787,488	608,440	1,236,573
Pasiv	189,208	695,029	160,836	10,071
Aktiv	414,827	2,556,623	536,633	-
Aktiv	3,282,674	12,218,433	1,585,638	1,463,626
Aktiv	2,975,309	759,988	1,138,377	10,114
Kërkesë për Çregjistrim	44,324	391,241	387,970	10,045
Pasiv	227,201	2,966,886	432,378	10,000
Aktiv	1,231,252	1,466,073	685,364	17,880
Aktiv	156,312	364,104	280,080	10,090
Aktiv	305,865	952,285	1,802,120	16,010
Aktiv	2,509,961	220,070	238,841	-
Pasiv	171,212	368,904	383,463	-
Aktiv	1,039,538	430,104	338,181	20,000
Aktiv	2,681,906	1,714,511	151,513	-
112,018,541	143,996,009	85,975,273	32,718,023	

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër rezulton se:

Humbja tatimore e vitit 2018 për top 50 subjektet është në vlerën 85,975,237 lekë.

Humbja tatimore e vitit 2019 për top 50 subjektet është në vlerën 143,996,009 lekë.

Humbja tatimore e vitit 2020 për top 50 subjektet është në vlerën 112,018,541 lekë.

Nga top 50 subjektet që rezultojnë me humbje, 12 prej tyre janë dhe debitorë kundrejt DRT Korçë në vlerën 32,718,023 lekë. Nga administrata tatimore Korçë nuk janë marrë masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to.

Biznes i Vogël me Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin me Humbje Tatimore më shumë se 500,000 lekë.

Nga Biznesi i vogël, janë konstatuar 53 Biznese me Humbje Tatimore mbi vlerën 500,000 lekë, në vitet 2018, 2019, 2020 deri më 31.08.2021.

Humbja tatimore e vitit 2018 është në vlerën 81,442,023lekë, vlerë që u përket 25 subjekteve.

Humbja tatimore e vitit 2019 është në vlerën 90,149,151lekë, vlerë që u përket 20 subjekteve.

Humbja tatimore e vitit 2020 është në vlerën 78,537,858lekë, vlerë që u përket 26 subjekteve.

Konstatohen subjekte me humbje edhe 3 vite me radhë.

Tabela nr.60 Biznes i Vogël me TTHF me Humbje Tatimore > 500,000 lekë

(në lekë)

		Lloji Biz	Statusi	Humbja 2020	Humbja 2019	Humbja 2018
		BV ME TVSH	Aktiv	20,792,613	5,182,266	-
		BV ME TVSH	Aktiv			

				4,242,821	6,089,696	12,303,714
		BV ME TVSH	Aktiv	-	-	11,423,000
		BV ME TVSH	Aktiv	-	8,390,158	-
		BV PA TVSH	Aktiv	-	8,172,030	-
		BV PA TVSH	Pasiv	-	-	7,426,764
		BM	Aktiv	-	6,097,302	-
		BM	Aktiv	-	6,008,726	-
		BM	Aktiv	2,082,929	1,322,594	1,598,480
		BV PA TVSH	Pasiv	4,698,940	-	-
		BM	Aktiv	-	1,752,820	2,830,999
		BM	Aktiv	-	4,500,177	-
		BV ME TVSH	Aktiv	2,187,948	2,187,967	-
		BM	Aktiv	-	4,297,912	-
		BM	Aktiv	-	877,358	3,414,351
		BV PA TVSH	Aktiv	2,637,491	1,542,449	-
		BV PA TVSH	Aktiv	-	3,393,655	785,661
		BM	Aktiv	-	-	4,177,856
		BV ME TVSH	Kërkesë për Çregjistrim	-	-	4,134,736
		BV ME TVSH	Aktiv	-	4,097,832	-
		BM	Aktiv	-	-	3,915,269
		BV PA TVSH	Aktiv	1,891,433	718,507	1,285,900
		BV ME TVSH	Aktiv	3,881,650	-	-
		BM	Aktiv	-	1,904,306	1,759,240
		BV PA TVSH	Aktiv	3,620,751	-	-
		BM	Aktiv	-	-	3,617,169
		BV ME TVSH	Pasiv	-	-	3,610,173
		BV PA TVSH	Aktiv	1,579,659	1,974,043	-
		BV PA TVSH	Aktiv	2,754,154	791,033	-
		BV PA TVSH	Aktiv	686,658	1,994,114	818,934
		BV PA TVSH	Aktiv	1,312,044	2,041,500	-
		BV PA TVSH	Aktiv	3,225,375	-	-
		BV PA TVSH	Aktiv	999,246	1,054,071	1,015,047
		BM	Aktiv	3,037,355	-	-
		BV ME TVSH	Aktiv	3,036,949	-	-
		BV PA TVSH	Kërkesë për Çregjistrim	-	2,421,755	545,732
		BM	Pasiv	-	1,003,808	1,937,971
		BV ME TVSH	Pasiv	-	-	2,927,273
		BV PA TVSH	Aktiv	-	-	2,896,856
		BM	Aktiv	-	1,689,255	1,165,483

		BM	Aktiv	1,064,644	1,772,791	-
		BV PA TVSH	Aktiv	-	-	2,827,144
		BV PA TVSH	Pasiv	-	2,011,390	781,074
		BV ME TVSH	Aktiv	2,782,452	-	-
		BV PA TVSH	Aktiv	1,099,341	-	1,667,100
		BV ME TVSH	Aktiv	1,789,338	-	968,500
		BV PA TVSH	Aktiv	1,249,324	1,489,749	-
		BV PA TVSH	Aktiv	981,141	752,798	830,613
		BV ME TVSH	Aktiv	1,342,754	1,221,636	-
		BV PA TVSH	Aktiv	1,616,283	941,400	-
		BV ME TVSH	Aktiv	2,502,400	-	-
		BV ME TVSH	Aktiv	550,560	1,792,286	-
		BV PA TVSH	Aktiv	891,605	661,767	776,984
TOTAL				78,537,858	90,149,151	81,442,023

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër rezulton një monitorim i dobët për këto biznese, veçanërisht për kategorinë Biznes i madh, i cilësuar me risk të lartë. Nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Vlerësimit nuk dokumentohen shkresa për kalimin/propozimin e kontroleve në Drejtorinë e Kontrollit. *Për asnjë biznes të madh nuk rezulton që nga ana e DRT Korçë të jenë shpallur procedurat e falimentimit sipas përcaktimeve ligjore në Nenin 16 "Kërkesat e kreditorit", Ligji Nr.110/2016 datë 27.10.2016 "Për falimentimin".*

Subjekte që kanë kaluar me vonesë Biznes i Madh.

1. Subjekti "M.G" NIPT L.

Rezulton mungesë monitorimi gjatë vitit 2019, pasi duhet të ishte bërë ndryshimi i përgjegjësisë tatimore nga TFTH në TF nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra. Në sistemin C@ts nuk gjenden bilancet e viteve 2019 dhe 2020 për këtë subjekt, sipas përcaktimeve të nenit 28 të Shkallës Tatimore të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar nga ana e inspektorëve përkatës të merren masa për ndërrimin e përgjegjësisë tatimore dhe të llogariten *diferenca në detyrime të tatim fitimit midis periudhës që ka qenë me TFTH por që duhej të ishte me TF, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.*

2. Subjekti "E.C" NIPT L.

Nëse ky subjekt do të ishte monitoruar në kohë duhej që ndryshimi i përgjegjësisë tatimore nga TFTH në TF të ishte bërë në fillim ose gjatë të vitit 2021.

3. Subjekti "O.S.K" NIPT L.

Nëse ky subjekt do të ishte monitoruar në kohë duhej që ndryshimi i përgjegjësisë tatimore nga TFTH në TF të ishte bërë në fillim ose gjatë të vitit 2020 gjë që nuk është bërë dhe subjekti vazhdon aktivitetin edhe për vitin 2021 me xhiro mbi kufirin e përcaktuar ligjorë për ndërrimin e përgjegjësisë nga TFTH në TF. Nga ana e inspektorëve përkatës të merren masa për ndërrimin e përgjegjësisë tatimore dhe të llogariten *diferenca në detyrime të tatim fitimit midis periudhës që ka qenë me TFTH por që duhej të ishte me TF, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.*

Auditimi i shitjeve të deklaruar në FDP dhe në Deklaratën e Tatim Fitimit.

Me emailin e datës 16.09.2021 grupi i auditimit ka kërkuar të dhëna në lidhje me TVSH shumatore sipas NIPT-eve për periudhën objekt auditimi. Gjithashtu dhe deklaratat e Tatimit mbi Fitimin dhe Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin. Nga kryqëzimi i xhiros sipas situatës financiare të TVSH me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e Tatim Fitimit janë konstatuar diferenca në të dy kahet:

- *Xhiroja sipas shitjeve në vlerë më të madhe se në deklaratën e Tatim Fitimit (diferencë në vlerë pozitive)*
- *Xhiroja sipas shitjeve në vlerë më të vogël se në deklaratën e Tatim Fitimit (diferencë në vlerë negative)*

Gjatë fazës së auditimit në terren dhe në ballafaqimet me Inspektorët e kontrollit dhe vlerësimit nga zyra rezultojnë të pavlerësuara diferencat e subjekteve si në vijim:

Viti 2020:

Nga komunikimi elektronik në datën 13.10.2021 me Drejtorin e Kontrollit, janë paraqitur shpjegime dhe dokumente justifikues nga inspektorët e kontrollit nga zyra mbi diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit, ku rezultoi se 1 subjekt është i pa monitoruar nga inspektorët e kontrollit nga zyra dhe nuk rezulton të jenë kryer verifikimet e nevojshme për diferencat e konstatuara për këto subjekte ku vlera e deklaruar në TVSH është 4,663,145 lekë, ndërsa të ardhurat e deklaruara të tatim fitimit janë 4,666,445 lekë, me një diferencë prej 3,300 lekësh.

Analiza e diferencave ndërmjet deklaratës së TVSH deklaruar në Tatime dhe deklaratës së TVSH deklaruar ne Doganë për vitin 2019.

Për diferencat midis TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në tatime dhe TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në Doganë për vitin 2019, dhe sipas të dhënave vënë në dispozicion nga DRT Korçë, u konstatuan vlera negative ose e thënë ndryshe: Subjektet Biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, kanë deklaruar TVSH në tatime vlerë më të vogël se TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit.

Konstatohen 12 subjekte me vlerën e TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në tatime në shumën 5,019,817 lekë dhe vlerës së tatueshme në Doganë për vitin 2019 në shumën 5,795,612 lekë, me një diferencë negative prej 775,795 lekë.

Nisur nga periudha të cilën trajtojmë (2019), nga sektori i kontrollit nga zyra duhet të ishin sistemuar dhe vlerësuar këto mospërputhje situatash. Aktualisht deri në 13 tetor 2021, (periudhë në të cilën është marrë raporti i fundit nga DRT Korçë), ky subjekt rezulton me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore.

Tabela nr. 63 Për diferencat në minus midis TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në tatime dhe TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në Doganë për vitin 2019". (në lekë)

Vlera e tatueshme Tatime	TVSH Tatime	Vlera e tatueshme Dogana	TVSH Dogane	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH diferenca
-	-	634,972	126,994	-634,972	-126,994
-	-	32,746	6,549	-32,746	-6,549
-	-	848,664	193,262	-848,664	-169,733
-	-	244,877	48,975	-244,877	-48,975
-	-	190,232	38,175	-190,232	-38,046
-	-	1,170,491	257,507	-1,170,491	-234,098
-	-	413,620	82,720	-413,620	-82,724
25,099,081	5,019,817	24,112,223	4,857,605	986,858	197,372
-	-	44,570	9,469	-44,570	-8,914
-	-	493,053	98,612	-493,053	-98,611
-	-	353,413	70,681	-353,413	-70,683
-	-	22,018	5,063	-22,018	-4,404

25,099,081	5,019,817	28,560,878	5,795,612	-3,461,797	-692,360
------------	-----------	------------	-----------	------------	----------

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Analiza e diferencave ndërmjet deklaratës së TVSH deklaruar në Tatime dhe deklaratës së TVSH deklaruar në Doganë për vitin 2020.

Konstatohen 4 subjekte me vlerën e TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në tatime në shumën 7,783,034 lekë dhe vlerës së tatueshme në Doganë për vitin 2020 në shumën 8,914,683 lekë, me një diferencë negative prej 1,131,649 lekë.

Nga sektori i kontrollit nga zyra duhet të ishin sistemuar dhe vlerësuar këto mospërputhje situatash deri më 13 tetor 2021, (periudhë në të cilën është marrë raporti i fundit nga DRT Korçë), këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore.

Tabela nr. 64 Për diferencat në minus midis TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në tatime dhe TVSH së deklaruar sipas vlerës së tatueshme në Doganë për vitin 2020". (në lekë)

Vlera e tatueshme tatime	TVSH Tatime	Vlera e tatueshme Dogana	TVSH Dogane	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH diferenca	Inspektori
38,915,169	7,783,034	38,920,123	7,791,512	-4,954	-991	Subjekt i ri
-	-	168,283	33,657	-168,283	-33,657	
-	-	2,364,168	472,834	-2,364,168	-472,834	
-	-	3,060,213	616,680	-3,060,213	-612,043	Subjekt i ri
38,915,169	7,783,034	44,512,787	8,914,683	-5,597,618	-1,119,524	

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Këto veprime dhe mosveprime të administratës tatimore janë në kundërshtim me nenin 25, të Rregullores së Brendshme miratuar me urdhër nr.19, datë 22.02.2017, "Detyrat e përgjegjës të kontrollit nga zyra", ku përcaktohet se:

P/Kontrollit nga zyra mban në ndjekje dhe mbikëqyrje ecurinë e pagesave dhe treguesve të tatimpaguesve dhe bën analiza të situatës së tyre sipas rasteve që paraqiten.

Si dhe nenin 26, pika 2, pika 7, e pika 9, "Detyrat e inspektorit të kontrollit nga Zyra", ku përcaktohet se:

2. Bën vlerësimin e deklaratave të tatimpaguesit kur ka mospërputhje. 7. Njofton me letër kujtesë, tatimpagues që nuk kanë paraqitur deklaratën vjetore të TF dhe pasqyrave financiare. 9. Mban në mbikëqyrje dhe analizon situatat e tatimpaguesve mbi treguesit financiarë të realizuar dhe ecurinë e tyre.

Vlerësimi total nga grupi i auditimit për të dy vitet e marrë në shqyrtim paraqitet si më poshtë në tabelë:

Tabela nr. 65 Rivlerësim

(në lekë)

Të ardhura të munguara nga TVSH	3,461,797	20%	692,359
Gjobë në masën 100%	692,359	100%	692,359
Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts			
Të ardhura të munguara nga TF	3,461,797	15%	519,270
Gjobë në masën 100%	519,270	100%	519,270
Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts			
Total			2,423,258 + Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, Inspektori i Kontrollit nga Zyra Z. A.P, Përgjegjësit i Sektorit të Kontrollit nga Zyra I.C, Ish- Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra Z. P.B, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Z. K.C si dhe Ish-Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Z. E.M.

Kasat fiskale

Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat e marra nga IT në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet në kasave. Grupi i auditimit përpunoi të dhënat dhe për të nxjerrë xhiron e korrektuar të subjekteve. U konstatua si në vijim:

Tabela nr. 66 Kasat fiskale

(në lekë)

Vitet	Totali i Xhiros nga Kasa	Gabime Kasa	Xhiro e Korrektuar
2018	20,468,454,550	680,103,260	19,788,351,290
2019	20,930,822,450	370,075,800	20,560,746,650
2020	18,738,583,533	383,289,636	18,355,293,897
31.08.2021	12,305,566,447	49,493,804	12,256,072,643

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Në vijim për bizneset e vogla pa TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF-s ku u konstatuan diferenca si në vijim:

Tabela nr. 67 qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF-s 2019

në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFFH	DIF (+)
295	239,268,517	170,606,322	68,662,195

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Tabela nr. 68 qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF-s 2020

Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFFH	DIF (+)
430	353,009,761	267,699,535	85,310,226

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër konstatohen parregullësi në të ardhurat e deklaruara për vitin 2019-2020 për 725 subjekte në vlerën 153,972,421 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Në vijim për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-s ku u konstatuan diferenca si në vijim:

Tabela nr.69 Diferencat sipas qarkullimit viti 2019

Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFTH	DIF (+)
23	34,712,198	30,592,903	4,119,295

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Efekt i financiar në të ardhura të munguara:

Vlera e tatueshme (4,119,295 lekë/120%) = 3,432,745 lekë

TVSH për tu paguar detyrim (3,432,745 lekë *20%) = 686,549 lekë

Gjoha (686,549 * 100%) = 686,549 lekë

Tabela nr.70 Diferencat sipas qarkullimit viti 2020

Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFTH	DIF (+)
31	53,131,709	46,422,991	6,708,718

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Efekt i financiar:

Vlera e tatueshme (6,708,718 lekë/120%) = 5,590,598 lekë

TVSH për tu paguar detyrim (5,590,598 lekë *20%) = 1,118,120 lekë

Gjoha (1,118,120 * 100%) = 1,118,120 lekë

Në vijim për bizneset e mëdha u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-s. (Shumatore e plotë e kategorive: shitje të përjashtuara nga TVSH, shitje pa TVSH, eksporte mallrash, furnizime me shkallë 0%, shitje të tatueshme me shkallë 20%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me shkallë 20%, shitje të tatueshme me shkallë 10%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me shkallë 10%, shitje të tatueshme me shkallë 6%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me 6%, shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtimit, TVSH e llogaritur sipas agjentit të udhëtimit).

Duke vlerësuar riskun, në testim u morën rastet kur xhiroja sipas kasës rezultonte më e madhe se shitjet sipas deklaratës së TVSH-s ku u konstatuan diferenca si në vijim:

Tabela nr.71 Diferencat sipas qarkullimit viti 2019 BM

Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFTH	DIF (+)
11	198,115,371	196,429,207	1,686,164

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Efekt i financiar:

Vlera e tatueshme (1,686,164 lekë/120%) = 1,405,137 lekë

TVSH për tu paguar detyrim (1,405,137 lekë *20%) = 281,027 lekë

Gjoha (281,027 * 100%) = 281,027 lekë

Tabela nr.72 Diferencat sipas qarkullimit viti 2020 BM

Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFTH	DIF (+)
18	186,255,621	177,040,874	9,214,747

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Efekt i financiar:

Vlera e tatueshme (9,214,747 lekë/120%) = 7,678,956 lekë

TVSH për tu paguar detyrim (7,678,600 lekë * 20%) = 1,535,720 lekë

Gjoha (1,535,720 * 100%) = 1,535,720 lekë

Për diferencat e konstatuara me sipër gjykohet se kanë nevojë për rivlerësim. Risku është vlerësuar për rastet kur shitjet sipas kasës rezultojnë më të larta se qarkullimi sipas deklaratave.

Subjekte që rezultojnë debitorë në TF.

Nisur nga deklarata e TF 2019 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.73 Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2019

Në Lekë

SUBJEKTI 2019	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
<i>Aktiv</i>	5,270,193	1,766,589	200,525	7,237,307
<i>Kërkesë për Çregjistrim</i>	1904772	505041	4,480	2,414,293
<i>Pasiv</i>	1,005,211	800,910	7,381	1,813,502
Grand Total	8,180,176	3,072,540	212,386	11,465,102

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër konstatohen subjekte të cilët kanë kryer deklarinimin e TF 2019 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 11,465,102 lekë (*Sipas zërave përbërës*), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2020. Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i pambledhur nga DRT Korçë.

Nisur nga deklarata e TF 2020 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.74 Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2020

Në lekë

SUBJEKTI 2020	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
<i>Aktiv</i>	17,822,244	3,246,569	355,542	21,424,355
<i>Kërkesë për Çregjistrim</i>	75793	177878	0	253,671
<i>Pasiv</i>	874,319	457,653	0	1,331,972
Grand Total	18,772,356	3,882,100	355,542	23,009,998

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër konstatohen subjekte të cilët kanë kryer deklarinimin e TF 2020 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 23,009,998 lekë (*Sipas zërave përbërës*), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2021. Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i pambledhur nga DRT Korçë.

Procedurat e kontrolleve për rimbursim nga Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit.

Nga auditimi u konstatua se në mbështetje të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.19 datë 28.04.2020 të Komitetit të Reformave në DPT, u miratua Urdhëri nr.19/1 datë 28.04.2020 me nr.7158/1 Prot., datë 28.04.2020 “Për Miratimin e Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së, mbështetur në Analizën e Riskut”.

Gjithashtu Rezulton se nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit ka veprime të cilat nuk respektojnë afatet e rimbursimit të TVSH-së dhe të cilat janë në shkelje të kërkesave ligjore të paracaktuara në nenin 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar-Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme...”

Grupi i auditimit mbasi shqyrtoi dokumentacionin dhe konstatoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer në total 37 praktika rimbursimi të TVSH-së nëpërmjet procedurës së kontrollit nga zyra nga ku arrihet në konkluzionin se, Drejtori i Kontrollit në DRT Korçë dhe Përgjegjësi i Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit në DRT Korçë nuk kanë zbatuar ligjin, udhëzimin, rregulloren dhe kërkesat e Manualit të Kontrollit dhe Menaxhimit të Kontrollit Tatimor në Drejtorinë Rajonale përse është cituar më sipër, ku konkretisht:

- Nuk është kryer në Sistemin C@ts evadimi i procedurave të kontrollit sipas kërkesave dhe afateve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi;
- Datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut, sipas kërkesave të ligjit/ nr. 9920 datë 19.05.2008 neni 81;
- Nuk është bërë përgatitja e dorëzimit të Raportit Përfundimtarë të Kontrollit Tatimor sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore të nenit 84 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ka hequr tatimpaguesit të drejtën të kundërshtojë rezultatet e kontrollit brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, neni 81 .

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

-Z.TH.T në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 05.08.2019-14.08.2020.

-Z. J.S në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën 01.01.2019-19.07.2019.

-Znj. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

-Z. K.C në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit.

-Z. E.M në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit për periudhën 01.01.2019-16.12.2020.

-Z. I.Ç në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

-Z. P.B në cilësinë e ish Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 01.01.2019-24.07.2020.

-Z. I.S në cilësinë e ish Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

1.Titulli i Gjetjes	Monitorim i dobët i treguesve me risk që ndikojnë në mirëfunksionimin e punës së Sektorit të Kontrollit nga zyra dhe Monitorimit duke shkaktuar të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.
Situata:	Nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës si në vijim: - Ky Sektor nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen

	<p>objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme, duke mos vepruar në përputhje me kërkesat Manualit të Kontrollit nga Zyra pika 5, 8 dhe 9;</p> <p>- Në lidhje me ndarjen e NIPT-eve, në organizimin dhe monitorimin e Inspektorëve nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, pika 5, 8 dhe 9</p> <p>- Konstatohen tepricat të larta kreditore të TVSH-s, TF dhe TTHF, pasi rezultojnë 50 subjekte me tepricë kreditore të pandryshuara ose në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim, të cilat rrisin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këta subjekte mbajnë peshën dhe teprica kreditore e tyre ka pasur tendenca rritëse nga viti 2019 në vitin 2021, si dhe nga ana e Inspektorit përkatës nuk është kërkuar informacion apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Duke qenë se ky numër subjektësh (<i>në raport me totalin e tatimpaguesve të DRT Korçë</i>) ka 47% të tepricës kreditore të TVSH-së në shkallë rajoni nuk kanë qenë objekt monitorimi dhe verifikimi në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, <i>pika 5, pika 9.</i></p> <p>-Konstatohen subjekte të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit dhe biznese me Tatim të Thjeshtuar me Humbje Tatimore më të madhe se 500,000 lekë, disa prej të cilëve janë dhe me humbje në 3 vite me radhë, si dhe ka rezultuar se disa prej tyre janë dhe debitorë. Humbja tatimore për top 50 subjekte e vitit 2018 dhe për vitin 2020 është në vlerën gjithsej 341,989,787 lekë. Nga top 50 subjektet që rezultojnë me humbje, 12 prej tyre janë dhe debitorë kundrejt DRT Korçë në vlerën 32,718,023 lekë. Nga administrata tatimore Korçë nuk janë marr masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to.</p> <p>Nga Biznesi i vogël, janë konstatuar gjithsej 98 Biznese me Humbje Tatimore mbi vlerën 500,000 lekë, në vlerën gjithsej 250.129.032 lekë. Për asnjë biznes të madh nuk konstatohet që nga ana e DRT Korçë të jenë shpallur procedurat e falimentimit sipas përcaktimeve ligjore në nenin 16 <i>oKërkesat e kreditoritö, ligji nr.110/2016 datë 27.10.2016 oPër falimentiminö.</i></p> <p>- Konstatohen subjekte që kanë ndryshuar me vonesë përgjegjësinë tatimore për të kaluar në Biznes i Madh, si rezultat i një monitorimi jo efektiv i deklaratave mujore të qarkullimit sipas TVSH-së,. Kjo evidentohet nga kryqëzimi i të dhënave të qarkullimit sipas deklaratave mujore të TVSH-së, me datat e ndërrimit të përgjegjësisë dhe gjithashtu me deklarin vjetor të të ardhurave në deklaratën e TTHF dhe TF.</p>
Kriteri :	Manuali i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi, pikat 5, 8 dhe 9. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, neni 81
Ndikimi/Efekti	Problematika që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës, mosvlerësimin korrekt të veprimtarisë dhe shmangie nga detyrimet tatimore.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore si pasojë e neglizhencës lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit

Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Drejtori rajonal të analizoje situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi të marrë masa për vlerësimin e problematikave të tepricave të larta të TVSH-së, TF dhe TFTH; të vlerësimit subjekteve të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit dhe biznese me TFTH me humbje tatimore mbi 500,000 lekë, si dhe monitorimin efektiv të xhiros së subjekteve me qëllim ndërrimin e përgjegjësisë së tatimpaguesve kur kalohen kufijtë e parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

2. Titulli i gjetjes:	E ardhur e munguar në buxhetin e shtetit në vlerën 34,475,100 lekë.
Situata:	Nga auditimi i sektorit të kontrollit nga zyra për vitet 2019 e 2020, si dhe analizimi i të dhënave të sektorit të informatikës mbi mospërputhjet në deklarim të situatës financiare me të ardhurat në pasqyrat financiare u konstatua se, ka tatimpagues (<i>aktiv, që kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe pasiv</i>) të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019, nuk kanë kryer pagesën e këtij tatim fitimi në vlerën gjithsej 11,465,102 lekë (<i>detyrim principali 8,180,176 lekë, interesa 3,072,540 lekë dhe gjoba 212,386 lekë</i>). Gjithashtu ka tatimpagues (<i>aktiv, që kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe pasiv</i>) të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019, por nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi fitimi që kap vlerën 23,009,998 lekë (<i>detyrim principali 18,772,356 lekë, interesa 3,882,100 lekë dhe gjoba 355,542 lekë</i>) duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total në vlerën 34,475,100 lekë . Ky detyrim duhet të ishte arkëtuar për TF e vitit 2019 brenda datës 31.03.2020 dhe për TF e 2020 brenda datës 31.03.2021.
Kriteri:	- Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, òPër Procedurat Tatimore në RSHò, neni 71, 74 òPagesa e rimbursimit të Tatim fitimitò, 76 Kamatëvonesa, neni 114 Mospagimi në afat, ligji 8438 datë 28.12.1998 per tatimin mbi të ardhurat Neni 30 òParapagimet
Efekti:	Mos realizimin e të ardhurave nga Tatim Fitimi
Shkaku:	Mos kryerja e pagesës së tatim fitimit nga subjektet tatimore në kohë sipas përcaktimeve ligjore dhe mungesa e monitorimit nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtorja Rajonale Tatimore Korçë, të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi, duke nxjerrë përgjegjësitë në çdo rast sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të marrë masa të menjëhershme, duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit në vlerën 34,475,100 lekë për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi në afatet e përcaktuara.

3. Titulli i Gjetjes	Diferenca të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në kasë me të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TVSH-së në situatën financiare për periudhën 2019-2020.
-----------------------------	---

Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, DRT Korçë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e tij nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit në qarkullimin sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTH-së, TVSH-së në kundërshtim me përcaktimet ligjore e proceduriale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-së ku u konstatuan: 23 subjekte për vitin 2019 me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën <i>4,119,295 lekë</i>, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 1,373,098 lekë. (<i>686,549 lekë detyrim dhe 100 % gjobë</i>). Për vitin 2020 u konstatuan 31 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën <i>6,708,718 lekë</i>, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën <i>2,236,240 lekë</i>. (<i>1,118,120 lekë detyrim dhe 100 % gjobë</i>). <i>Pra gjithsej të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për këtë rast 3,609,338 lekë</i></p> <p>b) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-së, ku u konstatuan për vitin 2019, 11 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën <i>1,686,164 lekë</i> duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 562,054 lekë. (<i>281,027 lekë detyrim dhe 100% gjobë</i>). Për vitin 2020 u konstatuan 18 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën <i>9,214,747 lekë</i>, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 3,071,440 lekë (<i>1,535,720 lekë dhe 100% gjobë</i>). <i>Pra gjithsej të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për këtë rast 3,633,494 lekë.</i></p>
Kriteri :	- Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, òPër procedurat tatimore në RSHò, neni 71,
Ndikimi/Efekti	Një situatë e vazhdueshme për periudhën në auditim duke mos u shoqëruar me përmirësime në këtë proces, dhe duke krijuar vlera të munguara në buxhetin e shtetit në shumën e 7,242,832 lekë
Shkaku:	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga Drejtori i Kontrollit dhe përgjegjësat respektive dhe mosnxjerrje përgjegjësish në vazhdimësi për punonjësit sipas detyrave funksionale.
Rëndësia	E lartë.
Rekomandimi	DRT Korçë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH në shumën 7,242,832 lekë dhe të bëjë propozimet përkatëse sektorit të kontrollit operacional në DRT për kryerjen e kontrollit të thelluar në vend për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

4. Titulli i Gjetjes	Diferencave ndërmjet TVSH së deklaruar në Tatime dhe TVSH së deklaruar ne Doganë për periudhën 2019-31.08.2021.
Situata:	Nga auditimi janë konstatuar 12 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit për vitin 2019 në vlerën - 775,795 lekë. Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë. Nga auditimi janë konstatuar 4 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit për vitin 2020 në vlerën - 1,131,649 lekë. Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë. <i>Këto diferenca sjellin një vlerë të munguar të të ardhurave në zërin Tatim Fitimi në total prej 2,423,258 lekë. (Të ardhura të munguara nga TVSH: 692,359 lekë + Gjobë në masën 100% 692,359 lekë & Të ardhura të munguara nga TF 519,270 lekë + Gjobë në masën 100% 519,270 lekë).</i>
Kriteri :	Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, òPër Procedurat Tatimore në RSHò, neni 71, Rregullore e Funkcionimit të DRT-së, miratuar nga MFE me urdhër nr.19, datë 22.02.2017, neni 43
Ndikimi/Efekti	Një situatë e vazhdueshme për periudhën në auditim duke mos u shoqëruar me përmirësime në këtë proces, dhe duke krijuar vlera të munguara në buxhetin e shtetit në shumën e <u>2,423,258 lekë</u> .
Shkaku:	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga Drejtori i Kontrollit dhe përgjegjësat respektivë dhe mosnxjerrje përgjegjësish në vazhdimësi për punonjësit sipas detyrave funksionale.
Rëndësia	E lartë.
Rekomandimi	DRT Korçë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH <i>në shumën 2,423,258 lekë</i> duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse sipas anekseve dhe tabelave përkatëse pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të bëjë propozimet përkatëse sektorit të kontrollit operacional në DRT për kryerjen e kontrollit të thelluar në vend për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

5. Titulli i Gjetjes	Procedurat e kontroleve për rimbursim nga Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit.
Situata:	Janë evaduar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në total 37 praktika rimbursimi të TVSH-së nëpërmjet procedurës së kontrollit nga zyra jo në përputhje me afatet që përcaktohen sipas legjislacionit tatimor.

	<p>Njoftimet e kontrollit të shoqëruar me Programet e kontrollit për Rimbursimin e TVSH-së nga Kontrolli nga Zyra që ju dërgohen tatimpaguesve nuk u përmbahen kërkesave ligjore sipas nenit 81, pika 2, germa òfò e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 <i>òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë</i>”, i ndryshuar duke mos përcaktuar datën, orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të kontrollit nga të dhënat e analizës së riskut.</p> <p>Gjithashtu, rezulton se nga ana e përgjegjësit të sektorit të procedurave të kontrollit dhe monitorimit kemi veprime të cilat nuk respektojmë afateve të rimbursimit të TVSH sipas nenit 75/1 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, duke i hequr në këtë mënyrë tatimpaguesit të drejtën e kundërshtimit të rezultateve të kontrollit brenda 5 ditëve kalendarike.</p>
Kriteri :	Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 <i>“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i> , i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa òf ò, neni 75 pika 1. <i>Miratimin e Rregullores së Rimbursimit e TVSH-së, mbështetur në Analizën e Riskut”</i> .
Ndikimi/Efekti	Procedura rimbursimi të TVSH-së të kryera në kundërshtim dhe mosrespektimi të dispozitave dhe përcaktimeve ligjore dhe nënligjore nga ana Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit në DRT Korçë.
Shkaku:	Mosrespektimi të dispozitave dhe përcaktimeve ligjore dhe nënligjore nga ana Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit në DRT Korçë në kryerjen e procedurave të rimbursimit të TVSH-së.
Rëndësia	E lartë.
Rekomandimi	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa për të unifikuar praktikën e rimbursimit të TVSH-së nga sektori i monitorimit nga zyra.

Titulli i Gjetjes : Diferenca pozitive dhe negative në qarkullimin e të ardhurave të deklaruar në bilanc me të ardhurat e deklaruar me deklaratat e TTHF-së në situatën financiare për periudhën 2019-2020	
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, DRT Korçë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e tij nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit në qarkullimin sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruar në deklaratat e TTH-s, TVSH-s në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Për subjekte të vegjël pa TVSH-së u konstatuan 295 subjekte për vitin 2019 me qarkullim sipas kasës me vlerë 68,662,195 lekë tepër sesa të ardhurat e deklaruar në TTHF dhe 430 subjekte për vitin 2020 me vlerë 85,310,226 lekë më të lartë sesa të ardhurat e deklaruar në TTHF. Për sa më sipër konstatohen parregullsi në të ardhurat e deklaruar për vitin 2019-2020 për 725 subjekte në vlerën 153,972,421 lekë;</p>
Kriteri:	Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, <i>òPër Procedurat Tatimore në RSHò</i> , neni 71, Rregullore e Funkcionimit të DRT-së, miratuar nga MFE me urdhër nr.19, datë 22.02.2017, neni 43.

Shkaku	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga Drejtori i Kontrollit dhe përgjegjësat respektivë dhe mosnxjerrje përgjegjësish në vazhdimësi për punonjësit sipas detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për verifikimin e mospërputhjeve midis deklaratës së qarkullimit sipas kasës dhe deklaratës së të ardhurave sipas TTHF.

2.4 Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara

Në zbatim të kësaj pike nga grupi auditues u shqyrtuan masat e marra për mbledhjen dhe arketimin e borxhit tatimor ~~pranë~~ **Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë për periudhën nga data 01.01.2019 deri në periudhën 31.07.2020** (periudhë në të cilën procedurat e mbledhjes dhe arkëtimin të borxhit tatimor u transferuan pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve).

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit nr. 947.1 prot, datë 14.09.2021, i ndryshuar, u shqyrtua legjislacioni si poshtë:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 7, datë 10.01.2017 për disa shtesa në Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Udhëzues i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë, miratuar me nr. 5731 prot, datë 15.03.2018 nga Zv.Drejtori i Përgjithshëm.
- Udhëzim nr. 23, datë 13.08.2019 Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Manual i mbledhjes me forcë.
- Rregullore e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

Në lidhje me detyrimet tatimore u grumbulluan evidenca për auditimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ~~Ë~~ **Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**, i ndryshuar, Kreu XI ~~Ë~~ **Mbledhja me Forcë e Detyrimit Tatimor të Papaguarë**, bazuar tek neni 88 ~~Ë~~ **Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguarë**, neni 89 ~~Ë~~ **Njoftimi dhe kërkesa për të paguarë**, neni 90 ~~Ë~~ **Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesitë**, neni 91 ~~Ë~~ **Masa e sigurimit të detyrimit tatimorë**, neni 93 ~~Ë~~ **Sekuestrimi i pasurisë** neni 97 ~~Ë~~ **Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë**, neni 98 ~~Ë~~ **E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë** dhe neni 99 ~~Ë~~ **Përgjegjësia e ortakut, aksionerit dhe administratorit** nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara.

Më poshtë të dhënat e marra nga DRT Korçë ku pasqyrohet dinamika e plotë e borxhit për vitin 2019

Konkretisht për vitin 2019

Tabela nr 76 Dinamika borxhit, viti 2019

në 000 lekë

	Gjendja e borxhit 01.01.2019	Detyrimet e shtuara	Detyrime të arkëtuara	Kthyer nga sistemi	Falur Ligji nr. 33.2017	Gjendja e borxhit 31.12.2019	Në proces gjyqësor
Nr. Subjektesh	7,801	9,866	7,355			7,695	57
TOTALI	2,430,808	374,185	440,827	-	-	2,364,166	84,654

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezultojnë se borxhi ka ardhur duke u ulur, pavarësisht rritjes së detyrimeve tatimore në shumë absolute dhe si numër rastesh. Rezultojnë se detyrimi total i borxhit në periudhën e fillimit të vitit është në shumën 2,430,808 mijë lekë dhe në periudhën e fundvitit në shumën 2,364,166 mijë lekë. Detyrimet tatimore të arkëtuara rezultojnë në shifrën prej 440,827 mijë lekë ose me një kalkulim prej 15,7% arketim nga totali progresiv deri në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2019. Gjithashtu, rezultojnë edhe 57 raste subjektsh të referuar me status borxhi të cilët janë në proces gjyqësor me një vlerë prej 84,654 mijë lekë ose sa 3% e totalit të borxhit të akumuluar deri në datën 31.12.2019.

Më poshtë të dhënat e marra nga DRT Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas zërave të debitorëve në periudhën e celjes dhe të fundvitit 2019 sipas llojit të tatimit.

Tabela nr 77 Debitorët sipas llojit të tatimit, viti 2019

në 000 lekë

	Tatim Fitimi		TVSH		Sigurime Shoqërore e Shëndetësore		Tatim mbi të ardhurën personale		Të tjera	Total		
	Nr. rastesh	Shuma	Nr. rastesh	Shuma	Nr. rastesh	Shuma	Nr. rastesh	Shuma	Nr. rastesh	Shuma	Nr. rastesh	Shuma
01.01.2019	11,493	585,401	9,177	1,065,557	19,330	454,976	1,892	100,076	20,393	224,798	62,285	2,430,808
31.12.2019	11,807	570,023	9,336	1,089,069	29,510	384,389	1,987	99,069	22,179	221,616	74,819	2,364,166

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezultojnë se detyrimet e papaguara për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në fund të vitit janë në shumën 1,089,069 mijë lekë ose 46% e totalit të detyrimeve të papaguara. Krahasuar me vitin e mëparshëm këto detyrime janë shtuar në shumën 23,512 mijë lekë.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezultojnë se detyrimet e papaguara për Tatimin mbi Fitimin janë në shumën 570,023 mijë lekë ose 24.1% totalit të detyrimeve të papaguara. Krahasuar me vitin e mëparshëm janë pakësuar në shumën 15,378 mijë lekë.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezultojnë se detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 1,876,800 mijë lekë ose 23.9% e totalit të detyrimeve të papaguara, krahasuar me vitin e mëparshëm janë shtuar në shumën 1,460,520 mijë lekë, e cila mund të shkaktojë edhe pasoja sociale në vijim në të punësuarit e këtyre subjekteve.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezultojnë se detyrimet e papaguara të tjera ku përfshihen Taksat, Tarifat dhe Gjoha të ndryshme janë në shumën 221,179 mijë lekë ose 9.3% e totalit të detyrimeve të papaguara, krahasuar me vitin e mëparshëm këto detyrimet janë ulur në shumën 3,182 mijë lekë.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezultojnë se detyrimet e papaguara për tatimin mbi të ardhurat Personale janë në shumën 99,069 mijë lekë ose 4.1% e totalit të detyrimeve të papaguara, krahasuar me vitin e mëparshëm janë pakësuar në shumën 1,000 mijë lekë.

Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-le Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas Zërave të Debitorëve sipas moshës deri në fund të vitit 2019.

Tabela nr 78 Debitorët sipas vjetërsisë, viti 2019

në 000 lekë

	BORXHI TATIMOR									
	Tatim mbi të Ardhurën Personale		Tatim Fitimi		TVSH		Sigurime Shoqërore Shëndetësore		Të tjera	
	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma
<i>borxhi deri - 6 muaj</i>	144	3,492	95	1,746	610	32,666	3,884	37,485	1,225	8,431
<i>Borxhi nga 1-2 vjet</i>	689	11,050	2,491	100,211	1,602	73,340	9,083	74,683	2,453	24,574
<i>Borxhi nga 2-5 vjet</i>	362	23,856	4,425	293,275	2,842	451,688	9,755	98,622	4,148	49,501

<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	792	60,661	4,796	174,791	4,282	531,375	6,788	173,599	14,353	139,110
TOTALI	1,987	99,059	11,807	570,023	9,336	1,089,069	29,510	384,389	22,179	221,616

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Borxhi me moshë mbi 5 vjet është në vlerën 1,079,536 mijë lekë dhe përbën 45.6% të totalit të detyrimeve tatimore të papaguara. Pjesa më e madhe e borxhit mbi 5 vjet, në vlerën 531,375 mijë lekë ose në masën 22%, përbëhet nga "TVSH", pjesa e borxhit "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" në vlerën 173,599 mijë lekë zënë 25.9% të borxhit mbi 5 vjet.

Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-le Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas masave shtrenguese që janë marrë ndaj debitorëve të debitorëve deri në periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2019 .

Tabela/ Masat shtrënguese per periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në 000 lekë

Nr	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara	
		Nr. Raste	Shuma	Nr. Raste	Shuma
1	Njoftim për pagesë	1,110	771,786	6,730	141,137
2	Urdhër bllokime të llogarive bankare	697	413,704	9,226	225,781
3	Njoftim të Tatimpaguesit Masave të Sigurisë	312	277,648	86	3,579
4	Njoftim për vendosje të barrës hipotekore	312	264,322	52	856
5	Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore	310	263,987	711	34,439
6	Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese	314	264,759	877	14,995
7	Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë	70	147,871	60	2,180
8	Njoftim për vendosje Urdhër Bllokimi në Doganë	75	66,453	293	14,288
9	Njoftim për vendosjen e sigurimit tatimor në QKB	259	225,536	51	3,384
10	Konfiskim i 50% të xhiros ditore	17	235	20	188
TOTALI		3,470		18,106	440,827

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Pas vendosjes së masave shtrënguese, gjatë vitit 2019 janë arkëtuar 440,827 mijë lekë. Nga shqyrtimi i evidencave të mësipërme rezulton se masa më efektive është urdhri i bllokimit të llogarive bankare, prej të cilit janë arkëtuar 225,781 mijë lekë. Efektiviteti i masave shtrënguese paraqitet i ulët për sa i përket nivelit të arkëtimeve në nivelin prej 440,827 mijë lekë ose në nivelin prej 8% krahasuar me totalin e borxhit të paarkëtuar. Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-ja Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas lloji të debitorëve për subjektet aktiv dhe pasiv sipas numrit të rasteve dhe shumës së detyrimeve tatimore deri në fund të vitit 2019.

Tabela nr 80 Lloji i debitorëve, viti 2019

ne 000 lekë

DRT	Subjekte AKTIV	VLERA E BORXHIT PER SUBJEKTET AKTIV	Subjekte PASIV	VLERA E BORXHIT PER SUBJEKTET PASIV	Borxhi deri me 31.12.2019	
					Nr. Sub	Vlera Borxhit
Korçë	2,401	364,752	5,294	1,999,414	7,695	2,364,166

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Sipas statusit të tatimpaguesit, nga të dhënat e DRT Korçë rezulton se në fund të vitit 2020, janë 2401 subjekte me status Aktiv të cilët kanë detyrime të papaguara në shumën 364,752 mijë lekë

dhe zënë 15.4% të totalit të borxhit tatimor, ndërsa 5,294 subjekte me status *Pasiv* kanë detyrime të papaguara në shumën 1,999,414 mijë lekë dhe zënë 84,5% të totalit të borxhit tatimor.

Konkretisht për vitin 2020.

Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-le Korçë ku pasqyrohet dinamika e plotë e borxhit për vitin 2020

Tabela nr 81- Dinamika borxhit, viti 2020

në 000 lekë

	<i>Gjendja e borxhit 01.01.2020</i>	<i>Detyrimet e shtuara</i>	<i>Detyrime të arkëtuara</i>	<i>Kthyer nga sistemi</i>	<i>Falur Ligji nr. 33.2017</i>	<i>Gjendja e detyrimeve 30.06.2020</i>	<i>Në proces gjyqësor</i>
Nr. Subjektsh	7,695	6,551	3,599	-	-	8,122	62
Shuma	2,364,166	315,101	189,657	-	-	2,489,610	96,823

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Nga analiza e të dhenavë të mësipërme rezulton se borxhi ka ardhur duke u rritur pavarësisht rritjes së detyrimeve tatimore në shumë absolute dhe si numër rastesh. Rezulton se detyrimi total i borxhit në periudhën e fillim vitit është në shumën 2,364,166 mijë lekë dhe në periudhën e delegimit të borxhit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve më datën 30.07.2020 është në shumën 2,489,610 mijë lekë. Gjithashtu edhe detyrimet tatimore të arkëtuara rezultojnë në shifrën prej 189,657 mije lekë ndërsa detyrimet e shtuara janë në masën 315,101 lekë. Gjithashtu rezultojnë edhe 62 raste subjektsh të referuar me status borxhi të cilët janë në proces gjyqësor me një vlerë prej 96,823 mijë lekë ose sa 3,8% e totalit të borxhit të akumuluar deri në datën 31.09.2020. Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-ne Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas zërave të debitorëve në periudhën e celjes deri në fund të periushes 31.09.2020 sipas llojit të Tatimit.

Tabela nr 82- Debitorët sipas lloji të tatimit, viti 2020

në 000 lekë

	<i>Tatim Fitimi</i>		<i>TVSH</i>		<i>Sigurime Shoqërore e Shëndetësore</i>		<i>Tatim mbi të ardhurën personale</i>		<i>Të tjera</i>		<i>Total</i>	
	<i>Nr. rastesh</i>	<i>Shuma</i>	<i>Nr. rastesh</i>	<i>Shuma</i>	<i>Nr. rastesh</i>	<i>Shuma</i>	<i>Nr. rastesh</i>	<i>Shuma</i>	<i>Nr. rastesh</i>	<i>Shuma</i>	<i>Nr. rastesh</i>	<i>Shuma</i>
01.01.2020	11,807	570,023	9,336	1,089,069	29,510	384,389	1,987	99,069	22,179	221,616	74,819	2,364,166
31.09.2020	13,618	632,626	9,844	1,081,763	38,503	428,302	2,183	100,016	23,807	246,903	87,955	2,489,610

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezulton se detyrimet e papaguara për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar deri më 31.09.2020 janë në shumën 1,081,763 mijë lekë ose 43.4% e totalit të detyrimeve të papaguara. Krahasuar me vitin e mëparshëm këto detyrime janë shtuar në shumën 7,306 mijë lekë.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezulton se detyrimet e papaguara për Tatimin mbi Fitimin janë në shumën 632,726 mijë lekë ose 25,4% totalit të detyrimeve të papaguara. Krahasuar me vitin e mëparshëm janë rritur në shumën 62,603 mijë lekë.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezulton se detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 428,302 mijë lekë ose 23.9% e totalit të detyrimeve të papaguara, krahasuar me vitin e mëparshëm janë shtuar në shumën 43,913 mijë lekë, gjë që duhet parë me shqetësim të dyfishtë, pasi krahas mungesës së të ardhurave shkakton në të ardhmen dhe probleme sociale.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezulton se detyrimet e papaguara të tjera ku përfshihen Taksat, Tarifat dhe Gjoha të ndryshme janë në shumën 246,903 mijë lekë ose 9.9% e totalit të detyrimeve të papaguara, krahasuar me vitin e mëparshëm këto detyrimet janë ulur në shumën 25,287 mijë lekë.

Nga analiza e të dhenave të mësipërme rezulton se detyrimet e papaguara Për tatimin mbi të ardhurat Personale janë në shumën 100,016 mijë lekë ose 4% e totalit të detyrimeve të papaguara, krahasuar me vitin e mëparshëm janë rritur në shumën 947 mijë lekë.

Më poshtë të dhënat e marra nga DRT Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas zërave të debitorëve sipas vjetërsisë deri ne periudhen 30.06.2020 .

Tabela nr 83- Debitorët sipas vjetërsisë, viti 2020

në 000 lekë

	BORXHI TATIMOR										
	Tatim mbi të		Tatim		TVSH			Sigurime		Të	
	Ardhurën Personale		Fitimi					Shoqërore		Tjera	
								Shëndetësore			
	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	Nr rast	Shuma	
borxhi deri - 6 muaj	392	4,328	1,644	61,673	664	28,983	10,711	81,836	2,648	28,102	
Borxhi nga 1-2 vjet	619	9,298	2,788	102,294	1,818	70,600	11,237	74,257	2,536	29,253	
Borxhi nga 2-5 vjet	386	25,375	4,457	292,815	2,931	451,078	9,624	98,785	4,261	50,794	
borxhi mbi 5 vjet	786	61,015	4,729	175,844	4,431	531,102	6,931	173,424	14,362	138,754	
TOTALI	2,183	100,016	13,618	632,626	9,844	1,081,763	38,503	428,302	23,807	246,903	

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Borxhi me moshë mbi 5 vjet është në vlerën 1,080,139 mijë lekë dhe përbën 43,3.% të totalit të detyrimeve tatimore te papaguara. Borxhi deri në 6 muaj është në vlerën 204,922 mijë lekë dhe përbën 8,2 % të totalit të borxhit. Borxhi deri në 1-2 vjet është në vlerën 285,702 mijë lekë dhe përbën 11,4% të totalit të borxhit. Borxhi deri në 2-5 vjet është në vlerën 918,847 mijë lekë dhe përbën 36.9 % të totalit të borxhit. Pjesa më e madhe e borxhit mbi 5 vjet, në vlerën 531,102 mijë lekë ose në masën 49%, përbëhet nga “TVSH”, pjesa e borxhit “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në vlerën 173,424 mijë lekë zënë 16 % të borxhit mbi 5 vjet, pjesa e borxhit “Tatim Fitimi” në vlerën 175,844 mijë lekë zë 16.2%, detyrime “Të tjera”, në vlerën 138.753 mijë lekë zënë 12.8 %, ndërsa Tatimi mbi të ardhurën personale” në vlerën 60,661 mijë lekë zë 2.5% të totalit të borxhit mbi 5 vjet. Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-le Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas masave shtrenguese që janë marrë ndaj debitorëve të debitorëve deri ne fund te vitit ushtrimor 2019. Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-le Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas masave shtrenguese që janë marrë ndaj debitorëve të debitorëve deri ne fund te datë **30.06.2020**

Tabela nr 84- Masat shtrënguese, viti 2020

në 000 lekë

Nr	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara	
		Nr. Raste	Shuma	Nr. Raste	Shuma
1	Njoftim për pagesë	330	2,860,097	3,980	76,288
2	Urdhër bllokime të llogarive bankare	235	872,852	3,827	92,748
3	Njoftim të Tatimpaguesit për vendosjen e Masave të Sigurisë	61	2,024,696	207	4,840
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosje të barrës hipotekore e siguruese	59	2,008,571	0	0
5	Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore	61	2,024,696	327	6,950
6	Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese	61	2,024,696	108	2,091
7	Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë	3	1,782	0	0
8	Njoftim për vendosje Urdhër Bllokimi në Doganë	4	5,285	83	2,690
9	Njoftim për vendosjen e sigurimit tatimor në QKB	53	860,658	0	0
10	Konfiskim i 50% të xhiros ditore	0	0	100	4,050
TOTALI		867		8,632	189,657

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Pas vendosjes së masave shtrënguese, gjatë vitit 2020 janë arkëtuar 189,657 mijë lekë. Nga evidencat e mësipërme rezultojnë se masa më efektive është urdhri i bllokimit të llogarive bankare, prej të cilit janë arkëtuar 92,748 mijë lekë. Efektiviteti i masave shtrënguese paraqitet i ulët për sa i përket nivelit të arkëtimit në nivelin prej 189,657 mijë lekë ose në nivelin prej 8% krahasuar me totalin e borxhit të paarkëtuar. Më poshtë të dhënat e marra nga DTR-le Korçë ku pasqyrohen të dhëna sipas lloji të debitorëve për subjektet aktiv dhe pasiv sipas numrit të rasteve dhe shumës së detyrimeve tatimore deri në fund të vitit 30.06.2020.

Tabela nr 85- Debitorët sipas rasteve, viti 2020 në 000 lekë

DRT	Subjekte AKTIV	Vlera e Borxhit	Subjekte PASIV	Vlera e Borxhit	Borxhi deri me 30.06.2020	
					Nr. Sub	Vler Borxhi
KORÇË	2,661	437,656	5,461	2,051,954	8,122	2,489,610

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Sipas statusit të tatimpaguesit, nga të dhënat e DRT Korçë rezultojnë se në fund të periudhës së vitit 2020 rezultojnë 2661 subjekte me status *Aktiv të cilët kanë detyrime tatimore të papaguara* në shumën 437,656 mijë lekë dhe zënë rreth 17.5 % të totalit të borxhit tatimor, ndërsa 5461 subjekte me status *Pasiv* kanë detyrime të papaguara në shumën 2,051,954 mijë lekë dhe zënë 82.4% të totalit të borxhit tatimor.

Në lidhje me Akt Marrëveshjet e nënshkruara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë bazuar në përcaktimet e pikës 10 të Udhëzimit **“Për procedurat e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor”** dalë me urdhërin nr. 5731.prot datë 15.03.2018

Tabela nr 86 Akt-marrëveshjet e lidhura sipas numrit dhe vlerës për periudhën 01.01.2019-30.09.2020 000 lekë

Viti	Nr. Subjekteve të cilët lidhën A-M	Vlera totale e debisë për të cilët janë lidhur A-M	Paguar në lidhjen e A-M	Nr. A-M të anuluar	Vlera e A-M të anuluar
2019	90	55,063	17,137	42	6,760
01.01.2020-30.09.2020	32	24,876	5,993	18	386

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Tabela nr 87 Akt-marrëveshjet e lidhura sipas llojit të detyrimit për periudhën 01.01.2019-30.09.2020.

000 lekë

Viti	Vlera e AM të lidhura për TVSH	Vlera e AM të lidhura për TF	Vlera e AM të lidhura për sigurime shoq. & shëndetësore	Vlera e AM të lidhura për TAP	Vlera e AM të lidhura për detyrime të tjera	Totali
2019	11,287	26,610	7,595	373	9,198	55,063
01.01.2020-30.09.2020	11,042	9,528	3,497	0	809	24876

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Tabela nr 88 Akt-Marrëveshje të anuluar, për të cilat janë paguar 0 këste

Nr	Subjekti	NIPTi	Detyrimi total për të cilët lidhet A-M	Paguar në fillim të A-M	Data e anulimit të A-M	Arsyeja e anulimit të A-M	Nr. total i kesteve	Këste të paguara	Vlera e mbetur pa paguar
	C.Z	K.	239	48		Mospagim I Kestevë	4	0	191

Nga ana e grupit auditues u përzgjedhen për auditim edhe dosje të subjekteve respektive me status debitorë trajtuar sa më poshtë vijon :

Mbi masat shtrënguese të 9 tatimpaguesit të përzgjedhur të cilët rezultojnë me situata borxhi me detyrime tatimore të papaguara

- Statusin e tatimpaguesit (aktiv. pasiv)
- Borxhin e secilit prej tatimpaguesve për periudhën objekt auditimi,
- Masat shtrënguese të zbatuara gjatë periudhës nën auditim,
- Arkëtimet pas çdo mase shtrënguese,

Përcjelljen e rasteve DHT-së dhe përgjigjet përkatëse nga kjo Drejtori

Në lidhje me subjektin debitor **õM.Kõ** me **NIPT J** rezulton se rezulton debitor në shumën 13,271,660 lekë deri në periudhën 31.07.2020 datë kur mbledhja e borxhit tatimor është transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si zyrë juridikonale mbikëqyrëse. Sa më poshtë edhe veprimet administrative të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar

Njoftim Pagese		U. B./Ilog/bank.		Nj./mase sigurie		Nj/P/Mase sigurie		Nj./Barre hipot		Nj./Barre Sig		Sekuest/pasurie	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
7005	03.05.2019	7907	21.05.2019	9390	17.06.2019	9381	17.06.2019	9391	17.06.2019	9380	17.06.2019	11780	26.07.2019
12661	20.08.2019	1033	24.01.2020	1165	30.01.2020	1139	30.01.2020					11781	26.07.2019
16272	18.10.2019												
18531	05.02.2019												

Në lidhje me subjektin debitor **õM.Nõ** me **NIPT L.** rezulton se rezulton debitor në shumën 5,750,271 lekë deri në periudhën 31.07.2020.

Nj.Pagese		U.Bilok.Ilog.b.		Nj.mase sigurie		Nj..P.M. sigurie		Nj..Barre hipotek		Nj..B.Siguruese	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
3341	17.02.2016	1989	26.01.2012	17623	10.08.2012	9011	21.05.2018	17624	10.08.2012	17625	10.08.2012
12908	18.04.2016	20992	12.11.2014	10162	01.03.2016	10114	01.03.2016	10106	01.03.2016	10118	01.03.2016
3868	28.02.2018	9930	29.02.2016	9013	21.05.2018	17623	10.08.2018	9014	21.05.2018	9010	21.05.2018
		5986	05.04.2018							17625	10.08.2018

Në lidhje me subjektin debitor **õS.IVTõ** me **NIPT J.** rezulton se rezulton debitor në shumën 168,454,289 lekë deri në periudhën 31.07.2020. Tatimore Korçë për mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar

Nj. Pagese		U.Bilok.Ilog.bank		Nj..mase sigurie		Nj..P.Mase sigurie		Nj..Barre hipotek		Nj..B.Siguruese		U.Seku.pasurie		D..Hetimit	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
14978	23.09.2015	15464	15.10.2015	15680	05.10.2015	15681	06.10.2015	15683	06.10.2015	15682	06.10.2015	26738	22.11.2016	4515	23.02.2016
1272	03.02.2020	9930	29.02.2016	10162	01.03.2016	10114	01.03.2016	10106	01.03.2016	10118	01.03.2016				
		9501	29.05.2018	1274	03.02.2020	1286	03.02.2020	1295	03.02.2020	1307	03.02.2020				
		1707	11.02.2020												

Në lidhje me subjektin debitor **õX.B.Põ** me **NIPT K** rezulton se rezulton debitor në shumën 49,022,820 lekë deri në periudhën 31.07.2020 Tatimore Korçë për mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar

Nj.Pag		U.Bilok.Ilog.ba		Nj..m.sigurie		Nj..P.M.sigurie		Nj..Barre. hip		Nj..B. Siguruese		U.Seku.pasurie		Nj..U.bilok.dogane		D..Hetimit	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
16406	10.09.2014	13893	24.10.2009	2840	09.02.2011	3278	17.02.2016	4717	08.03.2011	3276	17.02.2016	23587	28.09.2016	24146	06.10.2016	1472	28.01.2015
3283	16.02.2016	2837	09.02.2011	11372	08.08.2017	11374	08.08.2017	1398	19.01.2012	11373	08.08.2017	9497.4	29.06.2018				
		18321	02.10.2014					16029	26.09.2013								
		3253	16.02.2016					3267	17.02.2016								
		11371	08.08.2017					11375	08.08.2017								

Në lidhje me subjektin debitor **õKõ** me **NIPT K.** rezulton se rezulton debitor në shumën 7,464,377 lekë deri në periudhën 31.07.2020.

Nj.pagese		U.Bil.Ilog.bank		Nj..m.sigurie		Nj..P.M.sigurie		Nj..B.hipot		Nj..B.Sigur		U.Sek.pasurie		Nj..U.bilok.dogane		D..Hetimit	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
16229	26.05.2016	855	22.01.2016	8883	12.06.2017	8886	12.06.2017	856	22.01.2016	8884	12.06.2017	14107	18.09.2019	e-mail Dpt-se	12.06.2017	3948	06.03.2019
21322	16.08.2016	17278	09.06.2016	13215	29.08.2019	13190	28.08.2019	8885	12.06.2017	13193	28.08.2019						
4642	29.03.2017	25266	27.10.2016					13186	28.08.2019								
20023	04.12.2018	5276	11.04.2017														
		21163	14.12.2018														
		13206	28.08.2019														

Në lidhje me subjektin debitor **õJõ** me **NIPT J** rezulton se rezulton debitor në shumën 27,344,677 lekë deri në periudhën 31.07.2020 datë kur mbledhja e borxhit tatimor është transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si zyrë juridikonale mbikëqyrëse. Sa më poshtë edhe veprimet administrative të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për

mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar. Gjithashtu rezulton se mungon edhe Akti i Njoftimit të Pageses që duhej të kishte nxjerrë administrata tatimore

U.B..Ilog.bankare		Nj.m.sigurie		Nj..P.M.sigurie		Nj..B.hipotek		Nj..B.Sigur		U.Seku.pasurie		Nj.blok.dogane		D..Hetimit	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
1346	25.01.2019	1181	23.01.2019	1221	24.01.2019	1241	24.01.2019	1231	24.01.2019	3115	21.02.2019	e-mail Dpt-se	08.10.2018	8569	30.05.2019

Në lidhje me subjektin debitor **AL-AN** me **NIPT K** rezulton se rezulton debitor në shumën 58,414614 lekë deri në periudhën 31.07.2020 datë kur mbledhja e borxhit tatimor është transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si zyrë juridiksionale mbikëqyrëse. Sa më poshtë edhe veprimet administrative të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar.

Nj.pagese		U.B..Ilog.bankare		Nj.m.sigurie		Nj..P.M.sigurie		Nj..B.hipotek		Nj..B.Sigur		U.Seku.pasue		Nj.blok.dog.		D..Hetimit	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
4243	02.03.2011	4709	08.03.2011	2768	09.02.2016	2733	08.02.2016	5970	08.02.2016	5971	10.04.2013	14915	12.08.2014	24147		14949	13.08.2014
2774	08.02.2016	5320	12.03.2012	11704	16.08.2017	11705	16.08.2017	10903	02.07.2014	2734	08.02.2016	4161.1	07.04.2016				
		8040	17.04.2012	1889	02.02.2018	1932	02.02.2018	2740	08.02.2016	11706	16.08.2017						
		5997	12.04.2013					11707	16.08.2017	1906	02.02.2018						
		7583	20.05.2014					1919	02.02.2018								
		2721	08.02.2016														
		11682	15.08.2017														

Në lidhje me subjektin debitor **TÖ** me **NIPT L** rezulton se rezulton debitor në shumën 211,927,359 lekë deri në periudhën 31.07.2020 datë kur mbledhja e borxhit tatimor është transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si zyrë juridiksionale mbikëqyrëse. Sa më poshtë edhe veprimet administrative të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar. Gjithashtu rezulton se mungon edhe Akti i Njoftimit të Pageses që duhej të kishte nxjerrë administrata tatimore.

U.B..Ilog.bankare		Nj.m.sigurie		Nj..P.M.sigurie		Nj..B.hipotek		Nj..B.Sigur	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
4106	26.03.2014	11424	21.03.2016	5058	14.04.2014	5056	14.04.2014	5057	14.04.2014
4798	08.04.2014			11420	21.03.2016	11422	23.03.2016	11418	21.03.2016
9931	29.02.2016								

Në lidhje me subjektin debitor **A.Sö** me **NIPT J** rezulton se rezulton debitor në shumën 211,927,359 lekë deri në periudhën 31.07.2020 datë kur mbledhja e borxhit tatimor është transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si zyrë juridiksionale mbikëqyrëse. Sa më poshtë edhe veprimet administrative të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për mbledhjen dhe rikuperimin e borxhit tatimor të akumuluar. Gjithashtu rezulton se mungon edhe Akti i Njoftimit të Pageses që duhej të kishte nxjerrë administrata tatimore.

Nj.pagese		U.B..Ilog.bankare		Nj.m.sigurie		Nj..P.M.sigurie		Nj..B.hipotek		Nj..B.Sigur		U.Seku.pasurie		Nj.blok.dogane	
Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë	Prot.	Datë
25008	16.11.2012	25020	16.11.2012	2E+05	22.09.2014	17301	22.09.2014	25019	16.11.2012	17299	22.09.2014	14168	31.07.2018	4992	10.04.2015
16620	10.09.2014	17297	22.09.2014	10887	09.03.2016	10939	10.03.2016	17300	22.09.2014	10942	10.03.2016			18392	23.06.2016
10881	09.03.2016	7565	20.05.2015	14048	29.04.2016	14041	29.04.2016	4987	10.04.2015	14036	29.04.2016				
14090	03.05.2016	10820	09.03.2016	11713	16.08.2017	11714	16.08.2017	10935	10.03.2016	11711	16.08.2017				
4803	31.03.2017	13988	29.04.2016	4764	12.03.2018	4768	12.03.2018	14031	29.04.2016	4785	12.03.2018				
1278	22.01.2018	5390	14.04.2017	10028	07.06.2018	10058	07.06.2018	11712	16.08.2017	10062	07.06.2018				
11433	25.05.2018	2797	14.02.2018	2180	07.02.2019	2188	07.02.2019	4801	12.03.2018	2171	07.02.2019				
20744	18.12.2018	2608	31.05.2018	1136	30.01.2020	1164	30.01.2020	10041	07.06.2018	1155	30.01.2020				
1137	30.01.2020	2238	07.02.2019					2175	07.02.2019						
		906	23.01.2020					1172	30.01.2020						

Në përfundim rezulton se nga administrata e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk rezulton të jetë i mbuluar borxhi me masa shtrënguese të plota, me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e të gjithë borxhit tatimor. Masat shtrënguese kanë vijuar deri te masa Urdhër Sekuestro. Konstatohen se nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Rezulton se nuk është marrë asnjë masë *ñNjoftim transferimi detyrimi palës së tretë, ñNjoftim për transferimin e detyrimit. ortakut, aksionarit, administratorit, ndonëse në fund të vitit 2019 rezultojnë gjendje borxhi shuma prej 2,364,166 mijë lekë për një numër prej 7,695 subjektsh. Më datë 31.07.2020 rezulton një vlerë borxhi prej 2,489,610 mijë lekë për 8,122 subjekte- Nga Drejtoria e Mbledhjes*

së Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk ka zbatuar Nenin 88 kreu XI **“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” si dhe neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.**

Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar

4. Administrata tatimore, pasi ka ezauruar procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar, sipas këtij kreu, mund të mbledhë detyrimin tatimor të mbetur të papaguar edhe nëpërmjet një personi juridik publik, i cili përfiton komision mbi shumën e mbledhur, në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9 Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit

1. Nëse edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, atëherë detyrimi tatimor i mbetur transferohet për llogari te Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ortakut, aksionarit dhe administratorit përgjegjës për shlyerjen e detyrimit tatimor, në përputhje me nenin 16 të ligjit “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Administratori, ortakët apo aksionarët janë solidarisht përgjegjës për detyrimin tatimor të papaguar të personit juridik.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni vlejnë edhe për rastet kur në përfundim të procesit të likuidimit apo falimentimit të tatimpaguesit, shoqëri tregtare, ka mbetur ende i pashlyer detyrimi tatimor.

4. Ministri i Financave miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni.

Neni 99 Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, **administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.**

2. Ekzekutimi i masës së sigurimit nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë sipas këtij kreu, është objekt i dispozitave të ligjit “Për kundërvajtjet administrative” dhe realizohet nga administrata tatimore.

3. Urdhri për sekuestrimin e pasurisë bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore. Urdhri duhet të identifikojë tatimpaguesin, pasuria e të cilit është objekt i sekuestrimit, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e tatimit, për të cilin vihet sekuestroja. Urdhri i dërgohet tatimpaguesit me postë rekomande.

4. **Administrata tatimore mund ta sekuestrojë pasurinë sipas detyrimit vetëm pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, në përputhje me nenin 91 të këtij ligji dhe vetëm 30 ditë kalendarike pas datës, kur urdhri i sekuestrimit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi, në formën e parashikuar në nenin 94 të këtij ligji.**

5. Nëse administrata tatimore vëren se mbledhja e tatimit është në rrezik, mund të dërgojë njoftim dhe kërkesë për pagesën e menjëhershme të këtij tatimi dhe nëse detyrimi tatimor nuk paguhet plotësisht, administrata tatimore ka kompetencë të bëjë sekuestrimin, pavarësisht nga afatet e parashikuara në këtë nen.

Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë neni 97

1. Në rastet kur shuma e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar nuk mbulon të gjithë shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të nxjerrë një njoftim për palët e treta, me të cilin urdhëron shlyerjen e drejtpërdrejtë të pagesës, brenda 14 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit ose që vlerësohet të jetë marrë, në një shumë të barabartë me vlerën e pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi te pala e tretë, kur ky transferim është kryer pas nxjerrjes së njoftimit të administratës tatimore për sekuestrimin e pasurisë.

2. Përgjegjësia e palës së tretë kufizohet në vlerën e tregut të pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi.

3. Në rastet kur detyrimi tatimor i tatimpaguesit, personi juridik, mbetet i pashlyer edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar, personi që, gjatë tre vjetëve përpara nxjerrjes së njoftimit të sekuestrimit, ka marrë nga ky tatimpagues të drejtat mbi pasurinë, nëpërmjet një transaksioni të kryer me vlerë dukshëm më të vogël se vlera e tregut, është në radhë të dytë përgjegjës për detyrimin e pashlyer. Kjo përgjegjësi shkon deri në vlerën e të drejtave të transferuara, duke zbritur shumën e paguar nga personi për këtë pasuri.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2- RRregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020 neni

3-Manuali i Kontrollit Tatimor

4-Udhëzimin nr. 5731.prot datë 15.03.2018 “Per Procedurat e Mbledhjes se Borxhit”

5-Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH”

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

1- z. I.C në cilësinë e ish Drejtorit te Drejtorise te mbledhjes me force te Borxhit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

2- z. TH.LL në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes .Borxhit pranë DRT Korçë.

3- z. F.D në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes .Borxhit pranë DRT Korçë.

4- z. G.K në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes .Borxhit pranë DRT Korçë.

5- z. R.M në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit pranë DRT Korçë.

6- z. A.M cilësinë e ish inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes Borxhit pranë DRT Korçë.

7- z. S.B në cilësinë e ish inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes Borxhit pranë DRT Korçë.

8- z. E.SH në cilësinë e ish inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes Borxhit pranë DRT Korçë.

9- znj. L.M në cilësinë e ish inspektorit të Drejtorisë së Mbledhjes Borxhit pranë DRT Korçë.

Për sa më sipër është mbajtur edhe Akt-Konstatimi nr. 5 datë 19.11.2021 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Titulli i gjetjes :	Procedura administrative jo në përputhje Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, dhe me me Udhëzimin nr. 5731 prot datë 15.03.2018 òPër procedurat e mbledhjes së borxhit”
Situata:	Nga auditimi u konstatua se nga drejtuesit e njësisë përgjegjëse të Drejtorisë se Mbledhjes së Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë janë kryer veprimet procedurale për njoftime pagese detyrimesh tatimore, urdhër bllokim llogarie bankare, njoftime masë sigurie për barrë hipotekore dhe barrë siguroese, urdhër sekuestrim pasurie dhe urdhër bllokim në doganë konform legjislacionit tatimor në fuqi si dhe nëpërmjet një personi juridik publik, i cili përfiton komision mbi shumën e mbledhur ndonëse në fund të vitit 2019 ka pasur 7695 raste debitorë në shumën 2,364,166 mijë lekë, dhe në fund të periudhës 31.07.2021 (periudhë në të cilën mbledhja e borxhit tatimor ka kaluar ne Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit në DPT) ka pasur 8,122 raste në shumën 2,489,601 mijë lekë për të cilët ka kaluar më shumë se një vit nga lindja e pagesës së detyrimeve tatimore.
Kriteri:	1-Neni 88, 89, pika 3 neni 93, 96, 97, 98, 99 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. 2-Neni 28 deri 36 i Kapitullit IV te Rregullores se Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr. 192 datë 12.08.2020. 3-Neni 24 deri 34 e Rregullores se Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhërin nr. 1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave 4-Pika 7, 8 dhe 9 e Udhëzimit nr. 5731 prot datë 15.03.2018 “Për procedurat e mbledhjes së borxhit”

Ndikimi.Efekti:	Mos arkëtim i borxhit tatimor me pasoja te drejtpërdrejta ne mbledhjen edhe rikuperimin te ardhurave tatimore ne buxhetin e shtetit
Shkaku:	Mosrespektim i përcaktimeve ligjore sipas nenit 88, 89, 93, 96, 97, 98, 99 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ne lidhje me ezaurimin e te gjitha procedurave administrative per mbledhjen e borxhit tatimor per shkak të mosnjohjes së plotë të legjislacionit të fushës dhe për shkak të ndërprerjes së procedurave administrative të ndjekes së borxhit për shkak të transferimit të detyrave funksionale pas datës 31.07.2021 ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë gjatë procedurave administrative të ndjekjes së arkëtimit të borxhit tatimor të bashkëpunojë dhe të marrin në konsideratë kryerjen e të gjitha veprimeve administrative në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit tatimor për maksimizimin e veprimeve procedurale, me qëllim mbledhjen e të ardhurave tatimore nga borxhi i paarkëtuar, si dhe uljen e numrit të subjekteve tatimpagues debitorë.

2.5 Vlerësimi i Përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi:

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT është e organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale miratuar me Urdhërin nr.19, datë 22.02.2017 deri në vitin 2020 dhe më pas është e organizuar dhe funksionon në zbatim të Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale miratuar me urdhërin nr 192 datë 12.08.2020 të ministrit të financave.

Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Korçë në zbatim të detyrave funksionale për vitet 2019-2021 është fokusuar kryesisht në përpunimin e kërkesave për vërtetime, dhënien e asistencës, dhënien e fjalëkalimeve, dërgimin e njoftimeve subjekteve të ndryshme, edukimin dhe informimin e subjekteve me bazën ligjore.

Sipas të dhënave të ofruara nga DSHT, në zbatim të neneve 5, 6, 7, dhe 8 të Rregullores së brendshme për funksionimin e Zbatimit të Rregullores për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit të tatimpaguesve në DRT, Sektori i Shërbimit dhe Asistencës ka qënë i fokusuar kryesisht në Informimin e shpejtë dhe të saktë të tatimpaguesve, administrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Shërbimi dhe asistenca në këtë drejtori është dhënë kryesisht nëpërmjet email-it zyrtar, në adresën e dsht_Korçë@tatime.gov.al, nëpërmjet telefonit, si dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me tatimpaguesit në ambientet e Drejtorisë Shërbimit, janë bërë nëpërmjet sqarimeve verbale apo shpërndarjes së broshurave informuese mbi mënyrën e deklarimit, përpilimit të librave të shitblerjes etj., si dhe janë dhënë sqarime të nevojshme në lidhje me paqartësitë e tatimpaguesve rreth situatave të tyre financiare në sistemin tatimor.

Struktura e DSHT ka funksionuar me Urdhërin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, me Urdhërin e ri nr.49, datë 27.02.2019 për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126

datë 2.08.2016 të Kryeministrit, òPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore Qëndroreò, me Urdhër nr.86, datë 03.05.2019 òPër Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të AdministratësTatimore Qëndroreò, të ndryshuar si dhe me Urdhrin Nr. 33 date 12.02.2019, dhe më pas është e organizuar dhe funksionon në zbatim òRregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonaleò miratuar më urdhërin nr 192 datë 12.08.2020

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT ka të miratuar në strukturë aktualisht 14 punonjës: *1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjëgjës sektori, 11 specialistë.*

Funksionimi i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

Përgjatë periudhës nën auditim Drejtoria e Shërbimit tatimpagues Korçë ka pasur një strukturë të miratuar prej 14 punonjësish, përgjatë vitit 2019 ka pasur vakancë në sektorin e regjistrimit dhe sektorin e asistencës së shërbimit tatimpagues konkretisht në pozicionin e specialistit. Përgjatë vitit 2020 dhe 2021 ka pasur vakancë në sektorin e asistencës së shërbimit tatimpagues në pozicionin e specialistit dhe në sektorin e regjistrimit në pozicionin e përgjegjësit.

Analizat vjetore

Kjo Drejtori ka zhvilluar analizat vjetore për vitet 2019-2021. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës u konstatua si në vijim:

Analiza vjetore e vitit 2019 është bërë me anë të emailit të datë 09.01.2020

Analiza vjetore e vitit 2020 është bërë me shkresën nr.1/2 prot datë 13.01.2021

Analiza 6 mujore Janar-Qershor 2021 është bërë me shkresën 7146 të datës 05.08.2021

Nga analizimi i veprimtarisë për vitet 2019-08.2021 u konstatua aktiviteti i drejtorisë sipas aneksit 8.1

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me veprimtarinë e kësaj Drejtorie paraqiten si në vijim:

Përgjatë vitit 2019 në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 10609 kërkesa, të cilat nuk janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet për kontributet individuale të punonjësve. Numri total i tyre përbëhet nga 5236 kërkesa. Vazhdon me vërtetimet individuale të punonjësve me 4053 të tilla. Pjesa tjetër e kërkesave përbëhet nga vërtetime për formularin e dyfishtë, kontributet dhe sigurimet, xhiron në 3 vitet e fundit për tender, disponimin e mjeteve të transportit, kontributet e sigurimet, disponimin e mjeteve të transportit dhe për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender etj.

Gjatë vitit 2020, në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 8610 kërkesa, të cilat nuk janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet që u janë lëshuar individëve. Numri total i tyre përbëhet nga 4739 kërkesa. Vazhdon me vërtetimet për për vërtetim për kontribut individual me 2784 të tilla. Pjesa tjetër e kërkesave përbëhet nga vërtetime për formularin e dyfishtë, kontributet dhe sigurimet, xhiron në 3 vitet e fundit për tender, disponimin e mjeteve të transportit, kontributet e sigurimet, disponimin e mjeteve të transportit dhe për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender etj.

Përgjatë 8 mujorit të parë të vitit 2021 në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 4508 kërkesa, të cilat nuk janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet që u janë lëshuar individëve me 3077 të tilla. Pjesa tjetër e kërkesave përbëhet nga vërtetime për formularin e dyfishtë, kontributet dhe sigurimet, xhiron në 3 vitet e fundit për tender, disponimin e mjeteve të transportit, kontributet e

sigurimet, disponimin e mjeteve të transportit dhe për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender etj.

Tabela nr 89. Lloji i komunikimit

LLOJI I KOMUNIKIMIT 2019	Numri i rasteve
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre kryera on line në Sistemin C@TS.	1830
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në tvsh.	172
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me tvsh	325
Seminare të hapura	7
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve nëlidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë.	1238
Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve përdeklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre.	1238
Vizitave për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiscal	143
Te tjera	3751
TOTALI	7466

LLOJI I KOMUNIKIMIT 2020	Numri i rasteve
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre kryera on line në Sistemin C@TS.	4260
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në tvsh.	206
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me tvsh	187
Seminare të hapura	25
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve nëlidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë.	33
Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve përdeklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre.	33
Vizitave për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiscal	223
Te tjera	0
TOTALI	4934

LLOJI I KOMUNIKIMIT 2021	Numri i rasteve
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre kryera on line në Sistemin C@TS.	2125
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në tvsh.	47
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me tvsh	26
Seminare të hapura	0
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve nëlidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë. Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve përdeklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre. Vizitave për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiscal	2576
Te tjera	0
TOTALI	4774

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër rezulton se për periudhën objekt auditimi numrin më të lartë në veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues e zënë asistimet kundrejt Tatimpaguesve nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve të kryera online në Sistemin C@TS.

Tabela nr 90 Fjalëkalime për C@TS

Fjalëkalime për C@TS	Nr
Viti 2019	710
Viti 2020	548
Viti 2021	398

Vërtetime Individësh	Drejtoria e Shërbimit Tatimpaguesve (Nr)	Portali E-Albania (Nr)
Viti 2019	4565	6044
Viti 2020	5101	3509
Viti 2021	2305	2203

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë

Për sa më sipër rezulton se numri i vërtetimeve të dhëna nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues ka pësuar një rritje të konsiderueshme në vitin 2020. Ende vijohet të lëshohen vërtetime me vulë

të njomë edhe përpos faktit që Portali E-Albania është konceptuar dhe ofron mundësinë e marrjes së këtij shërbimi.

Nga auditimi rezulton se përgjatë periudhës objekt auditimi numri i vërtetimeve të individëve të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit e tatimpaguesve është shumë i lartë. Ku nga 23.727 vërtetime individësh të lëshuar përgjatë periudhës objekt auditimi (01/2019-08/2021) 11.971 vërtetime janë lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit e tatimpaguesve ose më shumë se 50% e totalit dhe pjesa tjetër është lëshuar nëpërmjet portalit e-albania. Përgjatë vitit 2020 numri i vërtetimeve të lëshuara manualisht nga Drejtoria e Shërbimit e tatimpaguesve është më e lartë se ajo e lëshuar nëpërmjet portalit qeveritar e-albania ku më konkretisht 5.101 nga totali prej 8.610 ose 60% e totalit. Veprime këto në kundërshtim me Urdhërin e ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 101/1 datë 02/10/2017 për lehtësimin e kërkesave dokumentare të shërbimeve të ofruara ndaj biznesit dhe qytetarëve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet në varësi të saj dhe Urdhërit të KM nr 158 datë 25.11.2019 për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 1.1.2020.

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT e tjera në DRT Korçë për vitin 2019 rezultojnë 19 të tilla, për vitin 2020 rezultojnë 11 dhe për vitin 2021 rezultojnë 4 subjekte.

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT Korçë në DRT e tjera për vitin 2019 rezultojnë 16 të tilla, për vitin 2020 rezultojnë 17 dhe për vitin 2021 rezultojnë 11 subjekte.

Nga auditimi i vërtetimeve dhe i praktikave të tërhequra nga Zyra e Protokollit u konstatua si në vijim:

Përsa i përket vërtetime të lëshuara nga ana e drejtorisë së shërbimit të tatimpaguesve për periudhën 01.01.2019-31.08.2021 u audituan muajt Shkurt 2019, Mars 2019, prill 2019, Maj 2020, Shtator, Nëntor 2020

Nga auditimi u konstatua, se tatimpaguesi ME në vijim të kërkesës për vërtetim për detyrim, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues është lëshuar vërtetimi me nr 1/4719 Prot me datë 13.11.2020 me përmbajtjen si në vijim: *...rezulton se për periudhën deri në 13.11.2020, nuk ka detyrime tatimore në:*

Tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, akciza, Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, tatimi në burim, tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi i vogël, dënime pa tatim, detyrime të tjera

Nga auditimi dhe verifikimi në sistemin CATS rezulton se tatimpaguesi ka detyrime të papaguara në shumën 9,880 lekë në kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të periudhës Shtator 2020

Shkresa është lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të tatimpaguesit, firmosur dhe vulosur nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë z.nj..

Për sa më sipër rezulton një mospërputhje me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues me sistemin CATS në paraqitjen e detyrimit për sigurime shoqërore dhe shëndetsore në vlerën 9,880 lekë, detyrim i cili paraqitet 0 në shkresën e Drejtorisë së shërbimit tatimpagues

Nga auditimi i vërtetimeve dhe i praktikave të tërhequra nga Zyra e Protokollit u konstatua si në vijim:

Tatimpaguesi M.E në vijim të kërkesës për vërtetim për detyrim, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues është lëshuar vërtetimi me nr 1/4607 Prot me datë 09.11.2020 me përmbajtjen si në vijim: *...rezulton se për periudhën deri në 09.11.2020, nuk ka detyrime tatimore në: Tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, akciza, Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, tatimin e thjeshtuar mbi*

fitimin,tatimi në burim,tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi i vogël,dënime pa tatim,detyrime të tjera.

Nga auditimi dhe verifikimi në sistemin cats rezulton se tatimpaguesi ka detyrime të papaguara në shumën 140,000 lekë në gjobë inspektori,(dënim për moslëshim biletash të shërbimit me vlerë të parashtypur) të vendosur për periudhën shtator 2019

Shkresa është lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të tatimpaguesit , firmosur dhe vulosur nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

Për sa më sipër rezulton një mospërputhje me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues me sistemin C@ts në paraqitjen e detyrimit për gjobë inspektori në vlerën 140,000 lekë, detyrim i cili paraqitet 0 në shkresën e Drejtorisë së shërbimit tatimpagues.

Nga ana e Drejtorisë së shërbimit tatimpagues ky mosrakordim na u shpjegua se Drejtoria e Kontrollit me anë të shkresës nr 6742/5 Prot të datës 18.05.2020 njofton se subjektit i është kryer kompensim në vlerën 142.219 lekë,ku kompensimi i gjobës për vlerën 140.000 lekë i është kryer në muajin janar por për shkak të procedurës së sistemit për çështjet e apelimit nuk është bërë akoma azhormimi.Nga auditimi rezulton se edhe pse kompensimi është kryer në muajin janar të vitit 2020 nga ana e DRT Korçë një gjë e tillë nuk reflektohet në sistemin C@ts deri në muajin nëntor të vitit 2021

Nga auditimi i vërtetimeve dhe i praktikave të tërhequra nga Zyra e Protokollit u konstatua si në vijim:

Përgjatë vitit 2020 kanë rezultuar 7 vërtetime të lëshuara nga drejtoria e shërbimit tatimpagues pa vulën e insitucionit.

Titulli:	Problematika në lëshimin e vërtetimeve për detyrime nga ana e tatimpaguesve
Situata:	Tatimpaguesi òM.Eò në vijim të kërkesës për vërtetim për detyrim, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues është lëshuar vërtetimi me nr. 1/4607 prot., më datë 09.11.2020, i cili ka një mospërputhje me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues me sistemin C@ts në paraqitjen e detyrimit për gjobë inspektori në vlerën 140,000 lekë, detyrim i cili paraqitet 0 në shkresën e kësaj drejtorie. Gjithashtu, megjithëse kompensimi është kryer në muajin janar të vitit 2020 nga ana e DRT Korçë një gjë e tillë nuk është reflektuar në sistemin C@ts deri në muajin nëntor të vitit 2021. - Edhe për tatimpaguesin òSLò rezulton e njëjta problematikë për vërtetimin për detyrim, me nr. 1/4719 prot., datë 13.11.2020, pasi konstatohet një mospërputhje me sistemin C@ts në paraqitjen e detyrimit për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 9,880 lekë.
Kriteri:	Kreu II i Urdhërit të DPT-së nr 81 datë 22.12.2017 òPër miratimin e manualit të shërbimeve për tatimpaguesit dhe individëtò
Ndikimi/Efekti:	Pasiguri në lëshimin e vërtetimeve dhe mosreflektimi i kompensimeve në sistemin C@ts
Shkaku:	Mos azhormimi i portalit C@ts
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, të marrin masa për përcjelljen e problematikës së konstatuar gjatë auditimit të zhvilluar nga KLSH në strukturat përgjegjëse me qëllim evidentimin dhe garantimin e mos përsëritjes në vijim të rasteve të tilla.

--	--

2.6 Auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.

2.6.1 Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në kryerjen e shpenzimeve korente: pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për udhëtime e dieta, si dhe shpenzime të tjera personeli, etj.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi:

Për përgjegjësitë mbi të metat edhe mangësitë e konstatuara, për punonjësit e larguar nga sistemi tatimor, sipas nenit 58 gërma c, janë në nivelin e masës ÷Largim nga Shërbimi Civil, për të cilët I rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të njoftojë DAP si dhe Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil:

13. Z. A.B, ish Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
14. A.D, ish Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
15. Znj. M.K, Ish Drejtor në Drejtorinë Rajonale Korçë
16. Z. G.K, ish Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
17. Znj. V.A, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
18. Z. P.T, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
19. Z. S.K, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
20. Z. H.S, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
21. Z. S.T, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
22. Z. A.F, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
23. J.D, ish Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

Qëndrimi i subjektit: *Rekomandimi i pranuar dhe zbatuar pjesërisht*

Komenti i subjektit: Rekomandimet e KLSH janë pranuar dhe nga ana e DPT është ngritur Komisioni i Disiplinës në D.P.T për shqyrtimin e propozimeve. Por në përfundim për asnjë punonjës nuk është marrë masë disiplinore, kjo sipas vendimeve të dërguara nga komisioni për secilin punonjës bazuar kjo sipas Shkresës së D.P.T nr. 1427 prot., datë 08.02.2018 protokolluar në DRT Korçë me nr 2629 prot., datë 12.02.2018

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga Drejtoria Rajonale Korçë, rezulton se situata mbetet e pa ndryshuar nga Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë dërguar me shkresën nr. 1151.37 Prot KLSH datë 18.01.2018. Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Titulli i Gjetjes : Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm	
Situata:	<p>Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr.750/25, datë 29.12.2016 “<i>Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, përputhshmëri, statusi i rekomandimeve të lëna për secilën lloj mase paraqitet si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Nuk rezulton të jetë respektuar hartimi i programit brenda afati ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për hartimin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi.- Rezulton të jetë hartuar planit të veprimit, por jo respektimi i afatit ligjor prej 6

	<p>muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, pasi Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë ka paraqitur informacion për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 16956/1 prot, datë 10.11.2017 në tejkalim të afatit 6 mujor nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.</p> <p>Nga 8 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar nga titullari 6 rekomandime, ose 75% e tyre. Nga rekomandimet e pranuar:</p> <p>A- Për masat organizative janë rekomanduar 2 masa të cilat janë pranuar nga D.R.T Korçë dhe nga auditimi i rezultojnë të pa zbatuara.</p> <p>B- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa në shumën 70,292,346 lekë nga të cilat nuk janë pranuar nga DRT Korçë 2 masa në shumën 58,972,346 lekë dhe janë pranuar 3 masa në shumën 11,320,000 lekë dhe nga auditimi rezulton se, janë realizuar pjesërisht 2 masa në shumën 9,698,268 lekë dhe është e pazbatuar 1 masë në shumën 1,035,000 lekë.</p> <p>C- Masa Disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e DRT, rezulton se nga 23 masa disiplinore të rekomanduara, për 11 punonjës të larguar nga shërbimi civil rekomandimi i KLSH nuk është më i zbatueshëm duhet konsideruar i ezauruar. Për pjesën tjetër të punonjësve nuk rezulton i zbatuar plotësisht rekomandimi për shqyrtimin dhe dhënien e masës, sipas nenit 58 germa (b-ç) dhe nenit 59.2 të ligjit 152/2013, <i>ōPër nëpunësin civilō</i>. Rekomandimi rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.</p>
Kriteri:	Ligjin nr. 154.2014, datë 27.11.2014 <i>ōPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartē të Shtetitō</i> .
Rëndësia:	E lartē
Rekomandimi:	Drejtori Rajonal Korçë të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotē të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-sē.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Janë evaduar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në total 37 praktika rimbursimi të TVSH-sē nëpërmjet procedurës së kontrollit nga zyra jo në përputhje me afatet që përcaktohen sipas legjislacionit tatimor.

Njoftimet e kontrollit të shoqëruar me Programet e kontrollit për Rimbursimin e TVSH-sē nga Kontrolli nga Zyra që ju dërgohen tatimpaguesve nuk u përmbahen kërkesave ligjore sipas nenit 81, pika 2, germa *ōfō* e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *ōPër Procedurat Tatimore në Republikēn*

e Shqipërisë”, i ndryshuar duke mos përcaktuar datën, orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të kontrollit nga të dhënat e analizës së riskut.

Gjithashtu, rezulton se nga ana e përgjegjësit të sektorit të procedurave të kontrollit dhe monitorimit kemi veprime të cilat nuk respektojmë afateve të rimbursimit të TVSH sipas nenit 75/1 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, duke i hequr në këtë mënyrë tatimpaguesit të drejtën e kundërshtimit të rezultateve të kontrollit brenda 5 ditëve kalendarike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa për të unifikuar praktikën e rimbursimit të TVSH-së nga sektori i monitorimit nga zyra.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultuan problematikat në vijim:

- Në lidhje me politikën, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet vijuese të dala në zbatim të tij, duke analizuar përmbajtjen dhe pozicionet e rolet e vendosura në rregulloren e funksionimit të DRT-ve mungon një përputhje dhe harmonizim i akteve, dispozitave dhe strukturës së miratuar;

- Nga DRT Korçë nuk janë hartuar pyetësorët e vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar; manualit të MFK, kapitulli III, pika 3.5 *“Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm”*;

- Nga DRT Korçë nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve për arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21 të ligjit nr.10296/2010 i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 30 të Rregullores për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 22-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me problematikat e konstatuara dhe të marrë masa për zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve, njohjen dhe implementimin e detyrimeve duke synuar rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit të audituara nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve.

Nga verifikimi i 5 procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi dhe i 9 procedurave të kësaj natyre nën 100,000 lekë, se nga komisioni i prokurimit nuk është vepruar në përputhje me VKM nr.914, datë 19.12.2014 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar konkretisht me:

- Nenin 59, pika 1 dhe pika 2 shkronjat òaò, òbò dhe òcò, pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është bërë investigim i tregut/nuk është bërë argumentimi dhe dokumentimi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës;

- Nenin 56, pasi në disa praktika prokurimi nga pjesëmarrësit në procedurë nuk janë nënshkruar deklaratat për konfliktin e interesit;

- Nenin 40, pika 5, pasi është përzgjedhur ofertues i renditur pas fituesit, veprime të cilat nuk janë dokumentuar nga komisioni përmes procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim;
- Nenin 68, pasi nga komisioni, nuk është përgatitur raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave që e dërgon për miratim te titullari i AK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 191-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: DRT Korçë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi në kualifikimin e ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i blerjeve me vlerë të vogël, të vlerësojë përgjegjësitë e tij në çdo rast sipas legjislacionit për prokurimin publik dhe të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimit dhe arkivimit e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Tatimpaguesi òM.Eò në vijim të kërkesës për vërtetim për detyrim, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues është lëshuar vërtetimi me nr. 1/4607 prot., më datë 09.11.2020, i cili ka një mospërputhje me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues me sistemin C@ts në paraqitjen e detyrimit për gjobë inspektori në vlerën 140,000 lekë, detyrim i cili paraqitet 0 në shkresën e kësaj drejtorie. Gjithashtu, megjithëse kompensimi është kryer në muajin janar të vitit 2020 nga ana e DRT Korçë një gjë e tillë nuk është reflektuar në sistemin C@ts deri në muajin nëntor të vitit 2021.

- Edhe për tatimpaguesin òM.Mò rezultojnë njëjtat problematikë për vërtetimin për detyrim, me nr. 1/4719 prot., datë 13.11.2020, pasi konstatohet një mospërputhje me sistemin C@ts në paraqitjen e detyrimit për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 9,880 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 161-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, të marrin masa për përcjelljen e problematikës së konstatuar gjatë auditimit të zhvilluar nga KLSH në strukturat përgjegjëse me qëllim evidentimin dhe garantimin e mos përsëritjes në vijim të rasteve të tilla.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Realizimi i të ardhurave për vitin 2019 rezultojnë me një diferencë prej 4%, e cila përfaqëson shumën 221,087 mijë lekë dhe për vitin 2020 mosrealizimi prej 3.6%, në vlerën 194,180 mijë lekë, fakt i cili tregon për performancën e dobët të punës që ka kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në përmbushje të misionit të stafit drejtues dhe nëpunësve zyrtarë të kësaj Drejtorie.

Në periudhën 01.01.2021 deri më datë 30.08.2021 konstatohet një realizim i të ardhurave tatimore në nivelin prej 102%, por me një rezultat të të ardhurave neto të arkëtuara më të vogël se ai i realizuar në vitin 2019 dhe 2020, si pasojë e rishikimit të planit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Zëri më pak i realizuar dhe i arkëtuar në kategoritë e llojit të tatimeve është për *òTaksa kombëtare* i cili është realizuar 55% për 2019, për vitin 2020 është 74.3% dhe në nivelin 60% për vitin 2021, duke treguar për mangësi në veprimtarinë e këtij subjekti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të përmirësojë metodologjinë e punës të strukturave në tërësi dhe në veçanti të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, e cila kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në monitorimin dhe kontrollin e të ardhurave tatimore, bazuar në profilet e riskut, të monitorimit dhe të kontrollit për llojet e tatimeve dhe kategoritë e subjekteve tatimpagues që kryejnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të kësaj Drejtorie.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nëpunësit e njësisë përgjegjëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nuk kanë respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin e fushës në lidhje me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ të njoftim kontrollit, në lidhje me afatet e evadimit të aktit administrative, të raportit paraprak të kontrollit, të raportit përfundimtar të kontrollit si dhe të njoftim vlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* duke krijuar risk të lartë për të mbartur në vijim efekte administrative me pasoja në pavlefshmërinë ligjore të akteve të nxjerra nga kjo njësi (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtuesit e njësisë përgjegjëse dhe nëpunësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë gjatë procedurave administrative të nxjerrjes dhe evadimit të akteve administrative, të respektojnë afatet ligjore të nxjerrjes së akteve me qëllim eliminimin e riskut në mosvlefshmërinë ligjore të akteve administrative të nxjerra nga kjo njësi përgjegjëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: DRT Korçë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit në qarkullimin sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTHF-së, TVSH-së në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore.

Rezultojnë 295 subjekte të vegjël për vitin 2019 me qarkullim sipas kasës me vlerë 68,662,195 lekë tepër sesa të ardhurat e deklaruara në TTHF dhe 430 subjekte për vitin 2020 me vlerë 85,310,226 lekë më të lartë sesa të ardhurat e deklaruara në TTHF, gjithsej parregullsi në të ardhurat e deklaruara për vitin 2019-2020 për 725 subjekte në vlerën 153,972,421 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për verifikimin e mospërputhjeve midis deklaratës së qarkullimit sipas kasës dhe deklaratës së të ardhurave sipas TTHF.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga drejtuesit e njësisë përgjegjëse të Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë janë kryer veprimet procedurale për njoftime pagese detyrimesh tatimore, urdhër bllokim llogarie bankare, njoftime masë sigurie për barrë hipotekore dhe barrë siguruese, urdhër sekuestrim pasurie dhe urdhër bllokim në doganë konform legjislacionit tatimor në fuqi si dhe nëpërmjet një personi juridik publik, i cili përfiton komision mbi shumën e mbledhur ndonëse në fund të vitit 2019 ka pasur 7695 raste debitorë në shumën 2,364,166 mijë lekë, dhe në fund të periudhës 31.07.2021 (periudhë në të cilën mbledhja e borxhit tatimor ka kaluar në Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit në DPT) ka pasur 8,122 raste në shumën 2,489,601 mijë lekë për të cilët ka kaluar më shumë se një vit nga lindja e pagesës së detyrimeve tatimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë gjatë procedurave administrative të ndjekjes së arkëtimit të borxhit tatimor të bashkëpunojë dhe të marrin në konsideratë kryerjen e të gjitha veprimeve administrative në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit tatimor për maksimizimin e veprimeve procedurale, me qëllim mbledhjen e të ardhurave tatimore nga borxhi i paarkëtuar, si dhe uljen e numrit të subjekteve tatimpagues debitorë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr.750/25, datë 29.12.2016 “*Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, përputhshmëri, statusi i rekomandimeve të lëna për secilën lloj mase paraqitet si më poshtë:*

- Nuk rezulton të jetë respektuar hartimi i programit brenda afati ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për hartimin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi.

- Rezulton të jetë hartuar plani të veprimit, por jo respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, pasi Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë ka paraqitur informacion për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 16956/1 prot, datë 10.11.2017 në tejkalim të afatit 6 mujor nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.

Nga 8 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar nga titullari 6 rekomandime, ose 75% e tyre. Nga rekomandimet e pranuar:

A- Për masat organizative janë rekomanduar 2 masa të cilat janë pranuar nga D.R.T Korçë dhe nga auditimi i rezultojnë të pa zbatuara.

B- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa në shumën 70,292,346 lekë nga të cilat nuk janë pranuar nga DRT Korçë 2 masa në shumën 58,972,346 lekë dhe janë pranuar 3 masa në shumën 11,320,000 lekë dhe nga auditimi rezulton se, janë realizuar pjesërisht 2 masa në shumën 9,698,268 lekë dhe është e pazbatuar 1 masë në shumën 1,035,000 lekë.

C- Masa Disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e DRT, rezulton se nga 23 masa disiplinore të rekomanduara, për 11 punonjës të larguar nga shërbimi civil rekomandimi i KLSH nuk është më i zbatueshëm duhet konsideruar i ezauruar. Për pjesën tjetër të punonjësve nuk rezulton i zbatuar plotësisht rekomandimi për shqyrtimin dhe dhënien e masës, sipas nenit 58 germa (b-ç) dhe nenit 59.2 të ligjit 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*. Rekomandimi rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 196-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtori Rajonal Korçë të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa zbatuara, duke marrë masa për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Brenda muajit mars 2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës si në vijim:

- Ky Sektor nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme, duke mos vepruar në përputhje me kërkesat Manualit të Kontrollit nga Zyra pika 5, 8 dhe 9;

- Në lidhje me ndarjen e NIPT-eve, në organizimin dhe monitorimin e Inspektorëve nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, pika 5, 8 dhe 9

- Konstatohen tepricat të larta kreditore të TVSH-s, TF dhe TTHF, pasi rezultojnë 50 subjekte me tepricë kreditore të pandryshuara ose në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim, të cilat rrisin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këta subjekte mbajnë peshën dhe teprica kreditore e tyre ka pasur tendenca rritëse nga viti 2019 në vitin 2021, si dhe nga ana e Inspektorit përkatës nuk është kërkuar informacion apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos

veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Duke qenë se ky numër subjektësh (në raport me totalin e tatimpaguesve të DRT Korçë) ka 47% të tepicës kreditore të TVSH-së në shkallë rajoni nuk kanë qenë objekt monitorimi dhe verifikimi në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, pika 5, pika 9.

-Konstatohen subjekte të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit dhe biznese me Tatim të Thjeshtuar me Humbje Tatimore më të madhe se 500,000 lekë, disa prej të cilëve janë dhe me humbje në 3 vite me radhë, si dhe ka rezultuar se disa prej tyre janë dhe debitorë. Humbja tatimore për top 50 subjekte e vitit 2018 dhe për vitin 2020 është në vlerën gjithsej 341,989,787 lekë. Nga top 50 subjektet që rezultojnë me humbje, 12 prej tyre janë dhe debitorë kundrejt DRT Korçë në vlerën 32,718,023 lekë. Nga administrata tatimore Korçë nuk janë marr masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to.

Nga Biznesi i vogël, janë konstatuar gjithsej 98 Biznese me Humbje Tatimore mbi vlerën 500,000 lekë, në vlerën gjithsej 250.129.032 lekë. Për asnjë biznes të madh nuk konstatohet që nga ana e DRT Korçë të jenë shpallur procedurat e falimentimit sipas përcaktimeve ligjore në nenin 16 të Kërkesat e kreditorit, ligji nr.110/2016 datë 27.10.2016 për falimentimin.

- Konstatohen subjekte që kanë ndryshuar me vonesë përgjegjësinë tatimore për të kaluar në Biznesi i Madh, si rezultat i një monitorimi jo efektiv i deklaratave mujore të qarkullimit sipas TVSH-së., Kjo evidentohet nga kryqëzimi i të dhënave të qarkullimit sipas deklaratave mujore të TVSH-së, me datat e ndërrimit të përgjegjësisë dhe gjithashtu me deklarin vjetor të të ardhurave në deklaratën e TTHF dhe TF.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtori rajonal të analizoje situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi të marrë masa për vlerësimin e problematikave të tepicave të larta të TVSH-së, TF dhe TTFH; të vlerësimin subjekteve të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit dhe biznese me TTFH me humbje tatimore mbi 500,000 lekë, si dhe monitorimin efektiv të xhiros së subjekteve me qëllim ndërrimin e përgjegjësisë së tatimpaguesve kur kalohen kufijtë e parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë òK.Gö SHPK dhe òM.Bö SHPK në periudha të ndryshme kohore janë kryer kreditime nga llogaria e ortakut për llogari të këtyre shoqërive me qëllim rritjen e aktivitetit tregtar. Këto pagesa konfirmohen në raportet e kontrollit tatimor si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Gjatë auditimit u konstatua se për këto hua ose shuma në vlera monetare të dhëna nga llogaria e ortakut në favor të shoqërive òK.Gö SHPK dhe òM.Bö SHPK nuk rezultojnë llogaritje të interesave vjetore në pasqyrat e performancës së këtyre shoqërive, duke sjellë pasojë efekte tatimore të rilogaritura si rikarakterizim të ardhurash dhe me detyrime tatimore në shumën 3,221,952 lekë për TVSH dhe 3,221,952 lekë gjobë 100% TVSH për periudhën 2014-2017, si dhe në shumën 2,416,464 lekë për tatim fitimin dhe 2,416,464 lekë gjobë 100% tatim fitimi për periudhën 2014 deri 2017 për subjektin òK.Gö SHPK. Për subjektin òM.Bö SHPK rezultuan detyrime tatimore nga rikarakterizimi në shumën 715,000 lekë për TVSH dhe 715,000 lekë gjobë 100% TVSH për periudhën 2014-2017, si dhe shumën 536,250 lekë për tatim fitimin dhe 536,250 lekë gjobë 100% tatim fitimi për periudhën 2014-2017. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë me anë të observacioneve ka kundërshtuar rilogaritjen e detyrimeve tatimore për këto raste si një praktikë dhe metodologji që nuk trajtohet nga legjislacioni tatimor i fushës dhe në praktikën e përditshme të raport kontrolleve tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe

shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortakut konsiderohen si *“Palë të lidhura”*, meqenëse ortakut ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në ligjin nr. 42/2014 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.16, datë 18.6.2014 *“Për transferimin e çmimit”*, gjë që sjell se, çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet të përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Armstrong Lengthö). Megjithatë nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rilllogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë, referuar Kodit Civil i miratuar me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, neni 1050 *“Për Huanë”* cilësohet se huamarrësi duhet të paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin veprime administrative me qëllim përcaktimin e një metodologjie të llogaritjes së detyrimeve totale tatimore të trajtuara sa më sipër për subjektet *“shpk dhe dshpk”*.

Gjithashtu Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të përcaktojnë një metodologji të qartë dhe të saktë ligjore dhe një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontroleve tatimore, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë ku ata janë ortakë për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga kundërshtitë ligjore që parashikon kodi i procedurave civile.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raport kontroleve të plota, për subjektin *“dshpk”* rezultoi kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për punime rikonstruksioni në shumën 3,322,940 lekë, ku punimet janë zhvilluar në shkelje të lejes së ndërtimit, situacioni i punimeve është në vlerë më të madhe se preventivi si dhe janë shtuar zëra punimesh shtesë nga ato të parashikuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rilllogaritura për subjektin që ka shmangur pagesën e detyrimeve tatimore **në shumën 3,322,940 lekë**.

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sektorit të kontrollit nga zyra për vitet 2019 e 2020, si dhe analizimi i të dhënave të sektorit të informatikës mbi mospërputhjet në deklarin të situatës financiare me të ardhurat në pasqyrat financiare u konstatua se, ka tatimpagues (*aktiv, që kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe pasiv*) të cilët kanë kryer deklarinin e TF 2019, nuk kanë kryer pagesën e këtij tatim fitimi në vlerën gjithsej 11,465,102 lekë (*detyrimin kryesor 8,180,176 lekë, interesi 3,072,540 lekë dhe gjoha 212,386 lekë*). Gjithashtu ka tatimpagues (*aktiv, që kanë bërë*

kërkesë për çregjistrim dhe pasiv) të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019, por nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi fitimi që kap vlerën 23,009,998 lekë (*detyrim principal 18,772,356 lekë, interesa 3,882,100 lekë dhe gjoha 355,542 lekë*) **duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total në vlerën 34,475,100 lekë**. Ky detyrim duhet të ishte arkëtuar për TF e vitit 2019 brenda datës 31.03.2020 dhe për TF e 2020 brenda datës 31.03.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi, duke nxjerrë përgjegjësitë në çdo rast sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të marrë masa të menjëhershme, duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit në vlerën **34,475,100 lekë** për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi në afatet e përcaktuara.

Brenda muajit mars 2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, DRT Korçë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e tij nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit në qarkullimin sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTH-së, TVSH-së në kundërshtim me përcaktimet ligjore e proceduriale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-së ku u konstatuan: 23 subjekte për vitin 2019 me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 4,119,295 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 1,373,098 lekë. (*686,549 lekë detyrim dhe 100 % gjobë*). Për vitin 2020 u konstatuan 31 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 6,708,718 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 2,236,240 lekë. (*1,118,120 lekë detyrim dhe 100 % gjobë*). **Pra gjithsej të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për këtë rast 3,609,338 lekë**

b) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-së, ku u konstatuan për vitin 2019, 11 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 1,686,164 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 562,054 lekë. (*281,027 lekë detyrim dhe 100% gjobë*). Për vitin 2020 u konstatuan 18 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së në vlerën 9,214,747 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 3,071,440 lekë (*1,535,720 lekë dhe 100% gjobë*). **Pra gjithsej të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për këtë rast 3,633,494 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: DRT Korçë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH **në shumën 7,242,832 lekë** dhe të bëjë propozimet përkatëse sektorit të kontrollit operacional në DRT për kryerjen e kontrollit të thelluar në vend për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Brenda muajit mars 2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar 12 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit për vitin 2019 në vlerën - 775,795 lekë. Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë.

Nga auditimi janë konstatuar 4 raste të subjekteve biznes i madh dhe biznes i vogël me TVSH, që kanë deklaruar TVSH në tatime më të vogël se vlera e TVSH e deklaruar në doganë për mallrat e importit për vitin 2020 në vlerën - 1,131,649 lekë. Këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administrata tatimore Korçë. *Këto diferenca sjellin një vlerë të munguar të të ardhurave në zërin Tatim Fitimi në total prej 2,423,258 lekë. (Të ardhura të munguara nga TVSH: 692,359 lekë + Gjobë në masën 100% 692,359 lekë & Të ardhura të munguara nga TF 519,270 lekë + Gjobë në masën 100% 519,270 lekë).* (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: DRT Korçë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH **në shumën 2,423,258 lekë** duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse sipas anekseve dhe tabelave përkatëse pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të bëjë propozimet përkatëse sektorit të kontrollit operacional në DRT për kryerjen e kontrollit të thelluar në vend për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raport kontrolleve të plota dhe rimbursimit të TVSH-së, u konstatuan parregullësi në veprimet e inspektorëve të kontrollit si më poshtë:

- Është identifikuar një rast ku nuk është aplikuar *öLlogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së* për subjektet me aktivitet të përzier veprim në kundërshtim me nenin 72 pika 2 të ligjit nr. 92/2014 *öPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*; nenin 56 pika 3 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 *öPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë* me efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 456,019 lekë;
- Janë konstatuar 3 raste të cilat kanë pasur gabim në llogaritjen e kostos së mallrave të shitur veprime këto në kundërshtim me nenin 115 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 *öPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* dhe që kanë sjellë një efekt financiar në mungesën e të ardhurave në vlerën 386,394 lekë;
- Në një rast është konstatuar kreditim dhe rimbursim i pa drejtë i TVSH për ndërtim hidrocentrali sepse punimet janë zhvilluar në tejkalim të afatit të lejes kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit Nr.6 *öPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, me efekte financiare në arkëtimin e të ardhurave në shumën 42,150,598 lekë;
- Në 11 raste janë konstatuar mos kryerja e veprimeve të duhura në lidhje me njohjen e shpenzimeve të amortizimit në pasqyrën e performancës veprime në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 *öPër tatimin mbi të ardhurat*, i ndryshuar, me efekt financiar mungesën e të ardhurave buxhetore në total prej 115,135,079 lekë;
- Në një rast është konstatuar shitje nën kosto të produkteve, veprime në kundërshtim me nenin 115, pika 1 të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008 *öPër procedurat tatimore*;
- Në një rast ka dyshime të arsyeshme për evazion fiskal sipas përcaktimeve të nenit 116 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 *öPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, me efekte financiare në mungesën e të ardhurave në vlerën 16,158,369 lekë;
- Nga auditimi u konstatua në një rast diferencë midis njoftim vlerësimit të gjeneruar nga sistemi c@ts dhe detyrimeve sipas raport kontrollit duke shkaktuar të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit në total në shumën 139,458 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogarituar për subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve tatimore sipas aneksit 5.1 në shumën 174,316,112 lekë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga analiza e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor në bazë të programit nr. 17344/4 prot., datë 19.02.2020 duke nxjerrë peshën dhe sasinë e *ogranulatit* që është futur në proces prodhimi për të prodhuar produktin *ambalazh* të llojeve të ndryshme nga subjekti *SHPK* me NIPT nuk është kryer pagesa e plotë për sasinë e mallit të prodhuar ambalazh plastik në sasinë prej 12 031 kg për detyrimin tatimor gjithsej prej **2,406,200 lekë** penalitet bazuar dhe në nenin 5 *Agjentët e taksave* të ligjit nr. 178/2013 *Për disa shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare*. Gjithashtu konstatohet se për një periudhë kohore 5 mujore (qershor-tetor) të vitit 2017, aktiviteti subjekti *SHPK* sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka prodhuar një sasi prej 12 031 kg ambalazh plastik fakt i cili nuk është kontestuar në asnjë rast nga Drejtoria Tatimore Korçë, ndërsa për një periudhë kohore prej 12 mujore (janar-dhjetor) të vitit 2017, aktiviteti i këtij subjekti ka prodhuar dhe shitur një sasi prej 13,265 kg ambalazh plastik, fakt i vënë në dispozicion gjatë fazës audituese të Projekt-Raportit të Auditimit. Nuk rezulton një analizë e plotë e bilancit material për sasinë e prodhuara dhe të shitura për vitin ushtrimor 2017 për aktivitetin e subjektit *SHPK* mbështetur në treguesit e importit, eksportit, kartës teknologjike, firove, humbjeve me qëllim dokumentimin e provës se vërtetësisë se pagesës plotë të taksës TAM për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, nisur edhe nga analiza korrekte e kryer nga grupi auditues për një periudhë të pjesshme kohore prej 40% periudhës së aktivitetit të këtij subjekti tatimpagues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 32-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë të marrë në shqyrtim të plotë mos pagesat e Taksës Kombëtare TAM dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të kërkojë kontroll të thelluar tatimor për deklaratimet e kryera nga subjekti *SHPK* në lidhje me sasinë e prodhuar të ambalazhit plastik dhe pagesën e kryer dhe të papaguar në shumën **2,406,200 lekë** për taksën kombëtare të ambalazhit TAM për vitin 2017 që përbën të ardhur të munguar në Buxhetin e Shtetit dhe në vijim për detyrime tatimore që do të rezultojnë bazuar në legjislacionin tatimor sipas nenit nr. 85 "Ri kontrolli Tatimor sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar. Në përfundim të kontrollit të kryer të vihet në dijeni Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me rezultatet e arritura nga administrata tatimore në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues *SHPK* me nipt për mospagesat e taksës së ambalazhit plastik për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2022.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

E. MASA DISIPLINORE

E.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

E.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

I. Bazuar në Ligjin nr.154/2014 *Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit* i ndryshuar neni 15, germa *ö*cö; ligjin nr.153/2013 *Për nëpunësin civil*, i ndryshuar,

nenet 57, 58 dhe 59; VKM nr.115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, kërkojmë përcjelljen e tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në cilësinë e organit epror për të filluar procedurat për dhënien e masës disiplinore, pasi të ketë analizuar përgjegjësitë e personave përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara në praktikën e kontrollit operacional të trajtuara gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”* deri në *“Largim nga shërbimi civil”*, për nëpunësit e mëposhtëm:

1. Për **Z. E.S.**, me detyrë inspektor në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë,
2. Për **Z. K.XH** me detyrë inspektor në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë
3. Për **Z. K.B** me detyrë inxhinier në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë,
4. Për **Z. I.M** me detyrë inxhinier në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë,
5. Për **Z. P.T** me detyrë përgjegjës i sektorit të kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë,
6. Për **Z.** me detyrë Drejtor i kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë,
7. Për **Z. J.S.**, në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, me detyrë aktuale Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë,
7. Për **Znj.** me detyrë Drejtor Rajonal, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë,
8. Për **Z. E.M.**, në cilësinë e ish Drejtorit të Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë, me detyrë aktuale në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

E.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm, nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte: *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”* deri në *“Largim nga shërbimi civil”* për:

1. **Z. Th.T** me detyrë ish Drejtor Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë, për periudhën 05.08.2019 deri në 14.10.2020.
2. **Z. Sh.Xh.**, me detyrë ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë.

F. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasi të zbatohet procedurat e

nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, **të ndërmerren veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 *ËPër nëpunësin civil*, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 *ËPër nëpunësin civil*, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.